



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 DHE 22 NËNTOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. I 22. NOVEMBRA 2018. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar sipas kërkesës së 42 deputetëve lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava na zahtev 42. poslanika u vezi neuspeha i skandala spoljne politike Republike Kosovo

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj që aktualisht në sallë janë të pranishëm 43 deputetë.

Do të procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës

Meqë në sallë jemi vetëm 43 deputetë dhe nuk ka asnjë përfaqësues të Qeverisë, lus shefat e grupeve parlamentare që të vijnë për një konsultë të shkurtër.

Atëherë, pas konsultës me shefat e grupeve parlamentare, u pajtuam që të marrim qëndrimet e grupeve parlamentare sipas radhës. Së pari Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Kjo është seancë e jashtëzakonshme me 42 nënshkrime. Është obligim kushtetues i Qeverisë dhe shumicës, i koalicionit qeverisës, jo i shumicës parlamentare tani, sepse nuk janë shumicë parlamentare, që të jenë prezentë në seancë.

Ne e kuptojmë plotësisht ndjeshmërinë e temës dhe qëllimi i kësaj seance ka qenë që duke qenë se edhe kryesojmë Komisionin e Politikës së Jashtme që të qartësojmë më mirë politikën e jashtme karshi arritjes së objektivave që ka Republika e Kosovës. Por, në mungesë të plotë të deputetëve të koalicionit qeverisës dhe të Qeverisë, kabinetit qeverisës, ne propozojmë që data e mbajtjes së kësaj seance të caktohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë së Kuvendit.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit. Partia Demokratike e Kosovës, deputeti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne, siç e dini, kemi marrë me kohë edhe një shkresë nga ana e kryeministrit dhe të zëvendëskryeministrit, njëherësh ministër i Jashtëm, të cilët do të duhej të ishin prezentë për të diskutuar çështjet e ngritura si temë në këtë seancë të jashtëzakonshme dhe, meqenëse është situata kështu, nuk i kemi prezentë, besoj që është e rrugës ta caktojmë në një datë tjetër. Po

ashtu është e rëndësishme që kjo seancë, meqenëse trajton temën e politikës së jashtme, të caktohet pas votimit për pranimin e Kosovës në Interpol, që duhet të ndodhë më datën 20. Andaj në emër të grupit parlamentar, ne mbështesim propozimin që Kryesia të vendosë për një datë tjetër të kësaj seance kurdo qoftë javën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ky debat është ftuar më 6 nëntor, diku para dhjetë ditëve dhe kryeministri Haradinaj, por edhe ministri i Punëve të Jashtme, zoti Pacolli, kanë qenë në dijeni se do të mbahet ky debat qysh para dhjetë ditësh. Kanë qenë pra në dijeni se opozita ka ftuar debat apo seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar lidhur me skandalet në politikën e jashtme.

Ne si Lëvizje Vetëvendosje jemi të brengosur me kahun që ka marrë politika e jashtme, për shkak të mungesës së një strategjie të unifikuar dhe jemi të brengosur me atë se kush është në krye të dikastereve që merren me politikën e jashtme. Pra, deputetët e Kuvendit, por po ashtu edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, duhet ta dinë se sa është numri i njohjeve, pra sa është numri i shteteve që e kanë njohur Kosovën, a ka ndonjë shtet që e ka tërhequr njohjen, siç ka ndodhur me deklaratën apo siç theksoi ambasadori britanik. Pse kanë ngecur njohjet? Duhet të flasim për partizimin e misionëve diplomatike, duhet të flasim për shfrytëzimin e postit të ministrit të Punëve të Jashtme për çështje biznesore, siç po bën zoti Pacolli. Duhet të flasim për deklaratat po ashtu të ministrit Pacolli që ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk duhet të ekzistojë kufi. Pastaj duhet të flasim për takimin skandaloz Thaçi-Putin. Tendencën për ta zëvendësuar Gjermaninë me Rusinë, marrëdhënien e re që ai dëshiron ta ndërtojë me Rusinë dhe Serbinë.

Duhet të flasim po ashtu edhe për mungesën apo mashtrimin me liberalizimin e vizave që u është bërë qytetarëve tash e dhjetë vjet.

Pra, për këto dhe shumë çështje të tjera është urgjente që ta mbajmë një debat parlamentar.

KRYESUESI: Albulena, ju lutem, qëndrimin për seancën, sepse ashtu do të fillonin pastaj debatin, dhe nuk jemi në atë pikë.

ALBULENA HAXHIU: Vetëm po e theksoj rëndësinë e këtij debati. Po mundohem që ta theksoj rëndësinë e këtij debati, të kësaj seance të jashtëzakonshme.

Tash, para se të vinim në këtë seancë, unë pashë në disa portale që kryeministri sot ka takim me Këshillin Ndërmnistror. Pse qenka takimi me Këshillin Ndërmnistror më i rëndësishëm se kjo seancë? Pra, ai është këtu, sipas disa portaleve, sepse nuk mund ta di, natyrisht.

Madje zoti Pacolli që gjashtë muaj mungon në Komisionin për Punë të Jashtme, me gjithë ftesat që i bëhen, prandaj kjo është një papërgjegjësi e Qeverisë kundrejt Kuvendit. Ata e kanë obligim kushtetues që të jenë këtu dhe meqë nuk ka kuorum për të vendosur për një seancë, datë të saktë të seancës se kur do të mbahet ky debat, ne jemi të pajtimit që Kryesia në mbledhjen e ardhshme ta caktojë të njëjtën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit. Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate. Kush e do fjalën? Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues, faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Është evidente nga kërkesa që kemi të bëjmë me një çështje, të cilën propozuesi i seancës e konsideron si të jashtëzakonshme dhe proceduralisht të gjithë hapat për seancë të jashtëzakonshme janë përmbushur, data është caktuar dhe për mua është për keqardhje sesi Qeveria sot këtu nuk është në seancë. Pra, nuk ka asnjë arsytim që së paku të mos respektohet ftesa për seancë të jashtëzakonshme.

Për hir të së vërtetës, kjo na është bërë me dije edhe në mbledhje të Kryesisë që gjasat për të qenë prezentë në këtë seancë për Qeverinë janë minimale, pothuajse inekzistente. Por, ja që këtu më duhet të pajtohem me parafolësit Hoti dhe Haxhiu që nëse kryeministrin e kemi në vend, atëherë vendi në të cilin duhet të jetë ai është salla e Kuvendit, në seancë të jashtëzakonshme.

Propozuesi e dha opsionin për të ecur përpara, pra në mbledhje të Kryesisë të definohet data e radhë, por gjithsesi mbledhjet e Kryesisë duhet t'i përdorim që të dakordohemi për data, gjithashtu. Pra, thjesht, të mos jemi kështu të ngurtë sa i përket datës së propozuar, por të shohim mundësinë që të kemi Qeverinë këtu.

Përsëris, ne jemi dakord me propozimin e zotit Hoti dhe është për keqardhje që është hera e dytë që vijmë në seanca dhe Qeveria mungon, për tema të cilat unë besoj janë edhe të rëndësishme, edhe të domosdoshme për t'u diskutuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për hir të korrektësisë më duhet të them që në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit është kërkuar që të shtyhet kjo seancë, meqë ministri i Punëve të Jashtme përmes një letre i është drejtuar Kuvendit se është jashtë vendit, ndërkohë që kryeministri, për shkak përsëri të korrektësisë ka

dërguar letër në Kryesinë e Kuvendit, edhe pse nuk ka qenë i ftuar në këtë seancë të jashtëzakonshme si kryeministër i vendit.

Nuk është dëgjuar arsyetimi pse kemi kërkuar që të mos mbahet seanca këtë ditë, të shtyhet për një ditë tjetër dhe po ashtu prej javës tjetër e tutje kurdo që Kryesia vendos për seancë të jashtëzakonshme lidhur me debatin e kërkuar, duhet të jemi të gatshëm të jemi prezentë, qysh do të jetë e gatshme edhe Qeveria të jetë këtu. Prandaj, nuk është mirë të jemi kapricioz dhe patjetër ta mbajmë vetëm sot, por është dashur të shihet e arsyeshme në bazë të kërkesave që janë bërë me shkrim në Kuvendin e Kosovës nga ana e Qeverisë, dhe komunikimi Kuvend e Qeveri, pozitë e opozitë, gjithmonë duhet të jetë i rregulluar në kuptimin që sipas njoftimit të arsyetohen edhe veprimet, e jo të bëhen veprime të cilat, në fakt, e bëjnë të dështuar seancën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, s'ka kërkuar askush fjalën. Nga Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate, deputeti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Së pari, ashtu siç u morëm vesh në konsultë, ne e mbështesim shtyrjen e kësaj seance për një datë tjetër, siç u dakorduam do të vendosë Kryesia në mbledhjen e radhës. Mirëpo, më lejoni të them edhe unë disa fjalë, meqë dolëm nga rendi i ditës, nga marrëveshja që e arritëm aty.

Së pari, kjo është seanca e parë e jashtëzakonshme e thirrur dhjetë ditë më herët. Zakonisht seancat e jashtëzakonshme janë thirrur brenda 48 orëve, 24 ose 48. Kjo është thirrur, edhe pse e jashtëzakonshme, diku një javë, tetë ditë, dhjetë ditë më herët dhe është përcaktuar pikërisht të 16-in nga propozuesit e kësaj seance, nga ata që e kanë thirrur, përkundër lutjes, kërkesës së partive të mazhorancës, sidomos të Qeverisë që të mos mbahet më datën 16, me të vetmin arsyetim: jo se jemi kundër këtij debati, sepse debati është i domosdoshëm, dhe debati thirret për të debatuar të gjitha temat që e preokupojnë vendin, qoftë nga këndvështrimi i opozitës, qoftë nga këndvështrimi i pozitës.

Nuk ka pasur gatishmëri të shtyhet, jo për shkak të urgjencës, sepse po të kishte qenë për shkak të urgjencës, do të ishte mbajtur 24 orë pas ftesës, jo 10 ditë pas kërkesës, për qëllime strategjike, taktike të opozitës. Krejt në rregull, të jemi korrektë. Po edhe pozita ka të drejtë të veprojë konform strategjisë së saj, të politikave të saj, që ishte si kërkesë që të mos debatohet së paku para se të vendoset për çështjen e Interpolit. Nuk ka pasur arsye tjetër.

Nisma, edhe pse e ka mbështetur propozimin e Qeverisë në mbledhjen e Kryesisë, sërish jemi këtu, kemi treguar gatishmëri që të vijmë të debatojmë për të gjitha të mirat dhe të këqijat e kësaj politike të jashtme. Për defektet. Për skandalet. Për gabimet. Për aspekte pozitive, cilado qofshin ato.

Pra, le të themi që gatishmëria për të debatuar nuk është mirë të keqpërdoret. Askush nuk ka qenë kundër debatit për politikën e jashtme. Mungesa e dakordimit ka qenë për kohën se kur do të duhej të mbahet. Sa të përfundojë kjo drama rreth Interpolit, shpresoj do të përfundojë në favor të Kosovës, ne do të jemi serish këtu dhe do të hyjmë në debatin për politikën e jashtme dhe jo vetëm për atë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Pa dashur t'i përsëris ato që i thanë kolegët e mi të nderuar, ne e mbështesim marrëveshjen e cila u arrit pak më parë, që duke i pasur arsyet e cekura dhe mospraninë e ministrit të Jashtëm këtu, ne përkrahim këtë propozim dhe jemi që në mbledhjen e radhës të Kryesisë të caktohet dita dhe data se kur do të mbahet kjo seancë e jashtëzakonshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë ne e kemi një mocion procedural, për të cilin, meqë kemi kuorum, në sallë janë 68 deputetë, duhet të deklarohe mi nëpërmjet votimit.

Domethënë, mocioni procedural thotë që, apo kërkesa është që Kryesia e Kuvendit të vendosë për datën e mbajtjes së kësaj seancë, në mbledhjen e parë të radhës.

Atëherë i lus kolegët deputetë dhe regjinë që të bëhen gati për votim dhe votojmë tash.

Faleminderit! Në votim kanë marrë pjesë 62 deputetë, për janë 57, 5 kundër dhe asnjë abstenim, edhe një me dorë është për, 58.

Atëherë Kuvendi e miratoi mocionin procedural.

Kështu që unë e ndërpres seancën. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 16 nëntor 2018
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme sipas kërkesës së 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, seancë e cila ka filluar më 16 nëntor 2018, por sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës, me pëlqimin ose përkrahjen e grupeve parlamentare dhe me votën e deputetëve, kjo seancë i ka ndërprerë punimet. Kështu që ne do të vazhdojmë punën sot.

Në momentin kur janë ndërprerë punimet në sallë kanë qenë 68 deputetë, do të thotë që seanca ka pasur kuorum, ndërkaq për vazhdimin e saj nuk kërkohet kuorumi i tillë.

Atëherë procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës

Në ndërkohë deputetët kanë marrë një letër nga zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Jashtëm i Republikës së Kosovës, me të cilën ai ka njoftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës se nuk do të jetë i pranishëm në këtë seancë dhe ka kërkuar shtyrjen e saj për një ditë tjetër gjatë javës së ardhshme. Këtë e jap në dijeni, meqë ju e dini që një kërkesë e tillë nuk përbën obligim për Kuvendin e Republikës së Kosovës, po në këtë situatë ne na duhet një qëndrim, kështu që unë së pari do të ftoj shefat e grupeve parlamentare për një konsultë të shkurtër ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

(Konsultë me shefat e grupeve parlamentare)

Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Meqë kryeministri është në sallë, ne mund të vazhdojmë punën.

Të nderuar deputetë,

42 deputetë të Kuvendit të Kosovës nga grupet parlamentare të LDK-së dhe të Lëvizjes Vetëvendosje kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.

Mbi këtë bazë, unë ftoj kërkuesin e këtij debati që të paraqesë fjalën e parë.

Kush e do fjalën, deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në këta pesë minutat e parë si bashkëpropozues me Lëvizjen Vetëvendosje do të flas vetëm si hyrje, për t'i elaboruar më vonë në fjalimin tim pesë dështimet më të mëdha të politikës së jashtme të Kosovës.

Dhjetë vjet pas pavarësisë, bartësit e politikës së jashtme të Republikës sonë në vend se të shkrinin gjithë energjinë në konsolidimin e shtetësisë, kanë arritur që nëpërmjet hapjes së temës së ndryshimit të kufijve, po ashtu të rihapin çështjen e statusit të Kosovës, duke atakuar drejtpërdrejt qenësinë e shtetit tonë.

Në tërë këtë maskaradë e aventurë të rrezikshme, presidenti i vendit, i cili po dështon të marrë përkrahjen e partive kryesore parlamentare për idenë ruso-serbe për ndryshim kufijsh, ka gjetur një aleat në skenën politike kosovare, ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Pra, dy figurat kryesore të politikës së jashtme të Kosovës, shefi i shtetit dhe shefi i diplomacisë, sot, 10 vjet pas përcaktimit të statusit final të Kosovës si shtet sovran e i pavarur, kanë marrë përsipër ta hapin edhe një herë këtë temë dhe atë jo me përkrahjen e Gjermanisë, por me përkrahjen e Ruisë.

Tema e dytë, të cilën do ta trajtojmë gjatë me kolegët deputetë, është vënia në diskutim e orientimit strategjik të Republikës së Kosovës.

Qeveria dhe presidenti i papërgjegjshëm dhe i rrezikshëm kanë arritur që brenda një viti e pak ta shkatërrojnë orientimin tonë gjeostrategjik që kemi mbajtur për 30 vjet të bazuar në vlera dhe integritet euro-atlantike dhe miqësi të përhershme me SHBA-në, duke rrezikuar miqësitë e krijuara me mund që nga fillimvitet e '90-ta, nga liderët e atëhershëm institucionalë.

Pra, sot po e përsëris, nga presidenti i vendit kur kërkohet të mos nënshkruajë asgjë në raport me shtetet e tjera pa bekimin e Gjermanisë, ai mburret se përkundër mungesës së bekimit të Gjermanisë, e ka atë të Ruisë.

Tema e tretë ka të bëjë me anëtarësimet dhe njohjet e Republikës sonë.

Si rrjedhojë e gjithë këtyre që i thashë më herët, që kanë rihapur temën e statusit, Kosova ka shënuar vetëm një njohje ndërkombëtare dhe atë nga Barbadosi gjatë këtij viti dhe asnjë anëtarësim përmbajtjesor në ndonjë organizatë të rëndësishme, ka dështuar, pra, të kapitalizojë ndonjë sukses të vetëm në fushën e politikës së jashtme dhe dështimi më eklatant ishte ky i para disa ditëve sa i përket anëtarësimit në Interpol.

Katër, ka të bëjë me çështjen e izolimit, sepse sot Kosova është e çorientuar në fushën e politikës së jashtme dhe e izoluar jo vetëm fizikisht, si rrjedhojë e mosliberalizimit të vizave, por izoluar edhe politikisht dhe në aspektin diplomatik.

Dhe, e fundit, është politizimi i skajshëm i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, se për skandalet dhe partizimin e këtij politizimi gjatë kësaj qeverisje nuk do të mjaftonin as 10 orë për t'i listuar, por mjafton të theksohen shqetësimet e Sindikatës së Shërbimit të Jashtëm, e cila ka listuar shkelje të rënda ligjore në procesin e regrutimit, në procesin e gradimit të karrierës dhe rotacionit, të gjithë me një emërues të përbashkët, ndikimin e skajshëm politik në secilin proces të vendimmarrjes.

Përfundimisht, ne si deputetë do të kemi kohë që t'i sqarojmë dhe t'i japim argumentet tona për të gjitha këto tema, por propozojmë që në fund të debatit të miratohet kjo rezolutë me një pikë të vetme.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, pas debatit parlamentar të mbajtur në seancën e jashtëzakonshme lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës, me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Grupit Parlamentar të VV-së miraton këtë:

REZOLUTË

1. Me qëllim të ndërprerjes së çdo përpjekjeje që konteston shtetësinë, subjektivitetin ndërkombëtar dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës të dorëhiqet për t'i hapur rrugë formimit të institucioneve të reja, të cilat duhet ta konsolidojnë dhe ta forcojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, në përputhje me orientimet e saj gjeopolitike për integritime euroatlantike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë kërkesa është bërë në emër të deputetëve të dy grupeve parlamentare, edhe përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Albin Kurti, do t'i ketë pesë minuta.

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikë,
Deputetë të Kuvendit,
Kryeministër,
Kabinet i Qeverisë,

Kosova praktikisht nuk është duke funksionuar. Presidenti e ka hedhur në gjyq edhe kryeministrin, edhe Kuvendin. E ka pyetur Gjykatën Kushtetuese se a e ka shkelur Qeveria

Kushtetutën kur pronat shoqërore ua ka bartur komunave dhe e ka pyetur Gjykatën Kushtetuese se a mund të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare e ta anashkalojë Kuvendin.

Por, edhe Kuvendi e ka në dy gjyqe presidentin, janë dy komisione hetimore parlamentare që po merren me presidentin, njëri për depërtimin e gjashtë shtetasve nga Turqia dhe tjetri për shpenzimet e tij të lobimit.

Kësisoj, institucionet e shtetit tonë janë edhe të pandehura, edhe prokurorë.

Më e rënda është pyetja e presidentit për Gjykatën Kushtetuese se a ka të drejtë ai të anashkalojë Kuvendin, gjë që paraqet intencë për grusht shtet ndaj Republikës parlamentare, çfarë është Kosova e pavarur.

Kur njeriu kryesor i politikës së jashtme ka këso intence, nuk mund të ketë përgjegjësi dhe kredibilitet më.

Ose kemi një president që flet për kompromise të dhimbshme me fqinjën që nuk na njeh, për korrigjim kufiri me të, për marrëveshje finale dhe për pajtim historik, teksa, për shembull, e merr kufirin Holandë-Belgjikë, kur dihet se aty janë tre gadishuj të vegjël të pabanuar në lumin Meza, e ku për 24 hektarë kanë biseduar plot 30 vjet.

Përfaqësues të politikës së jashtme të Kosovës nuk kanë autoritet e kredibilitet jashtë vendit. Këdo që e takon Thaçi a Pacolli, është kundërproduktive. Sa më shumë që llobojnë këta, aq më keq bëjnë.

Shkeljet e shumta të rregullave elementare, protokollare, i karakterizojnë institucionet e Kosovës. Për shembull, udhëtimet edhe vizitat e përbashkëta nga 2 e nga 3 të presidentit, të kryeministrit, të ministrit të Jashtëm edhe të kryeparlamentarit janë të turpshme. Askush nuk të merr seriozisht kur të sheh ashtu. Çfarë kanë bërë këta në politikën e jashtme? Qysh moti na kanë premtuar njohjen nga Serbia, anëtarësim në Këshill të Evropës, në NATO, në UNESCO e në Interpol dhe askund s'jemi. Pse ndodh kjo? Sepse, pikë së pari, politika e jashtme është politikë e brendshme. Ajo nuk bëhet për Kosovën në arenën ndërkombëtare, por për ndonjë votë për zgjedhjet e brendshme të radhës.

Premtimet për Kosovën jashtë e kanë edhe një synim tjetër brenda: amortizimin e pakënaqësisë së qytetarëve. Për shembull, shqiptarët në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc nuk e kritikojnë më, e nuk e kundërshtojnë aq Serbinë te Brukseli për kapitujt 23 dhe 24, sepse janë duke pritur që presidenti i Kosovës një mëngjes të bukur do t'i bëjë pjesë të Republikës së Kosovës. Jo vetëm që politika e jashtme është politikë e brendshme në Kosovë, por vlen edhe e kundërta, politika e brendshme është politikë e jashtme. Aq shumë veprime e mosveprime bëhen duke imagjinuar

shikimin e ambasadave të ndërkombëtarëve në përgjithësi, jo nevojat e qytetarëve të Kosovës, të drejtat dhe interesat e tyre, jo qëllimin për shtetndërtim demokratik, drejtësi ligjore, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje sociale. Ta zëmë lobimi të ndërkombëtarët. Miliona janë dhënë për lobim, për anëtarësime të dështuara, kur paga mesatare në sektorin publik nuk është as 500 euro, paga mesatare në sektorin privat nuk është as 350 euro, kur shporta elementare mujore llogaritet 115 euro, ndërkaq tash e shumë vjet paga minimale është vetëm 130 euro për ata që janë nën moshën 35-vjeçare dhe për ata mbi këtë moshë 170 euro.

Përfaqësuesit tanë në politikën e jashtme shkojnë të papërgatitur në takime, kanë dije dhe kulturë modeste e njohuri të pakta. Mandej, llojnë si t'ua marrë mendja personave të veçantë, pa udhëzime paraprake dhe llojnë njësoj, si për UNESCO, si për Interpol, me një qasje që lë shijen e tregtisë dhe të reklamës, por nuk mund të lobosh me mënyrë biznesmeni për Interpol, ajo është çështje e sigurisë jetike, jo e përfitimeve financiare. Skandalet me kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin serb të ministrit tonë të Jashtëm dhe deklarata e tij se duhet hequr kufiri me Serbinë, gjë që do të ishte në përputhje me Kushtetutën e Serbisë, e kanë diskredituar para çdo qytetari të Republikës së Kosovës. Përgjigjja e Tunizisë dhe e Marokut kanë treguar se nuk bëhet më fjalë për skandale, sepse ato janë të rralla, këto janë aq të shpeshta sa që s'kemi fjalë në gjuhën shqipe se çfarë po bëjnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurti! Keni kaluar kohën, tani është radha e kryetarëve ose e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Doruntinë Maloku.

DORUNTINË MALOKU: Të nderuar deputetë!

Të nderuar qytetarë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e konsideron si alarmante gjendjen në të cilën ndodhet Kosova, si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në aspektin diplomatik dhe të marrëdhënieve tona me jashtë.

Degradimi i politikës sonë të jashtme ka ardhur si pasojë e keqqeverisjes dhe skandaleve të njëpasnjëshme që po ndodhin çdo ditë. Abuzimet me institucionet shtetërore, niveli i lartë i krimit dhe i korrupsionit, një Kabinet gjigant, ku gjysma e ministrave janë me akuza dhe aktakuza, vendime skandaloze me kosto të miliona eurove, emërimet në pozita të larta drejtuese të njerëzve jokompetentë, kidnapimet e njerëzve pa procedurë, shpenzimet e miliona eurove për lobime, të cilat përfundojnë në lobime biografish personale, e kanë bërë shtetin e Kosovës një vend që ka luhatur besimin e partnerëve tanë euro-atlantikë dhe humbjen e shpresës së të rinjve për të ardhmen e vendit tonë. Lidhja Demokratike e Kosovës, si parti me traditë në ruajtjen e shtetit dhe respektimin e vlerave demokratike, ka bërë gjithçka që është e mundur për të ruajtur

balancat e pushteteve dhe për të kultivuar raportet miqësore me partnerët tanë evropianë dhe amerikanë.

LDK-ja asnjëherë nuk i ka vendosur interesat politike para atyre të qytetarëve të Kosovës dhe kjo është dëshmuar edhe gjatë kësaj legjislature, kur ne i kemi përkrahur të gjitha vendimet e Kuvendit që kanë pasur të bëjnë me relacionet tona me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara, marrëveshjet për iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare, e pastaj marrëveshjet me institucionet financiare ndërkombëtare, e të tjera. Fatkeqësisht kjo politikë e ruajtjes dhe e kultivimit të shtetit është abuzuar nga koalicioni qeverisës dhe presidenti i shtetit me pasoja afatgjate. Presidenti i shtetit, në vend se të jetë garant i integritetit territorial dhe i funksionimit të institucioneve demokratike, ai po e bën të kundërtën, e ka futur në pazar territorin e shtetit, gjoja në emër të njohjes nga Serbia.

Hapja e temës së kufijve të Kosovës, herë si shkëmbim e herë si korrigjim, është hapje e pavarësisë së shpallur më 17 shkurt dhe kjo e ka rrënuar politikën tonë të jashtme. Presidenti i vendit, duke u rreshtuar në anën e atyre që dëshirojnë ndarjen e Kosovës në shkëmbim të njohjes së asaj cope të mbetur, ka dërguar sinjale jashtëzakonisht negative tek aleatët tanë, por edhe te vendet e tjera se çështja e Kosovës nuk qenka e përfunduar. Përfaqësimi diplomatik i Kosovës nuk ndërton imazhin i një vendi serioz që meriton respekt, e të mos flasim për njohje të reja. Prioritet e politikës së jashtme në vend se të jenë afatgjate, ato ndryshohen brenda ditës, në mungesë të një strategjie të mirëfilltë dhe kjo ka sjellë si pasojë rënien përtokë të kredibilitetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo është një fatkeqësi e madhe për shtetin, por edhe për qytetarët. Si mund të pretendohet që policia jonë të pranohet në Interpol, ku vetëm pak muaj më parë në vendin tonë u kidnapuan persona dhe u ekstraduan pa asnjë procedurë, ndërsa llogaridhënia ka mbetur instrument joekzistent i institucioneve karshi Kuvendit. Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se kjo nuk është logjikë demokratike e funksionimit të institucioneve shtetërore.

Të nderuar qytetarë,

Aq shumë zhvillime negative kanë ndodhur sa që zgjidhja e vetme për përmirësimin e qeverisjes së brendshme dhe përfaqësimin dinjitoz jashtë vendit janë zgjedhjet e reja demokratike dhe krijimi i një shumice parlamentare, ku politika e brendshme dhe e jashtme drejtohen nga personalitetet të respektuara brenda dhe jashtë vendit që krijojnë kohezion nacional për shtimin e njohjeve dhe anëtarësime të reja në organizata dhe institucione ndërkombëtare dhe i ruajnë aleancat me miqtë tanë tradicionalë. Lidhja Demokratike konsideron se fuqizimi i Kosovës nga brenda është lobimi më i mirë jashtë. Një ekonomi funksionale, arsim dhe shëndetësi cilësorë, funksionimi i rendit dhe i ligjit, kujdes i shtuar ndaj mjedisit, nxitja e prodhimit të brendshëm,

administrata efikase, e të tjera, janë sinjali më i mirë që do të dërgojë shteti i Kosovës pas zgjedhjeve të reja kur vendi të qeveriset nga LDK-ja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Evgjëni Thaçi-Drăgusha.

EVGJËNI THAÇI-DRĂGUSHA: Faleminderit, i nderuar kryesues Shala!

I nderuar kryeministër Haradinaj,

Të nderuar kolegë deputetë,

Republika e Kosovës po përballet me një sërë sfidash, të cilat po e rrezikojnë çdo gjë që me aq mund e kemi ndërtuar. Shtetësia jonë po sfidohet çdo ditë fuqishëm dhe brutalisht nga Serbia, duke mos kursyer asgjë për të na penguar në çdo hap që bëjmë. Kosova përballet me procesin e bisedimeve me Serbinë, me vendimin për liberalizim të vizave nga Bashkimi Evropian, me ngecje në njohje nga vendet e tjera dhe me shumë sfida të tjera, të cilat tregojnë se vendi ynë është në një etapë të tillë, ku secili duhet të mendojë mirë për veprimet e veta, sepse hapat në vijim do të jenë vendimtarë për të gjitha zhvillimet që do të ndodhin më vonë. Nga ana tjetër, e që mund të jetë sfida më e rëndë, faktori shqiptar në Kosovë rrallëherë ka qenë më i përçarë.

Përkundër thirrjeve të vazhdueshme të Partisë Demokratike të Kosovës për unifikim të qëndrimeve kur bëhet fjalë për interesa vitale, nacionale, ne nuk mund të biem dakord as për një platformë të bisedimeve me Serbinë, e cila është bazë për përballjen me një kundërshtar të përbetuar. Përkundër të gjitha pengesave dhe vështirësive, përkundër fushatës së egër nga Serbia dhe situatës së brendshme, Republika e Kosovës arriti që me dinjitet të përfaqësohet në disa ngjarje shumë të mëdha dhe të rëndësishme botërore. Sigurisht se prezantimi i Kosovës në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork ishte një nga ngjarjet më të shënuara të vitit. Takimet e nivelit të lartë, që nga Departamenti i Shtetit e deri te ekzekutivi amerikan, por edhe shumë takime të tjera me delegacione nga e gjithë bota bëri që Kosova të marrë mbështetje për proceset në të cilat po kalon, siç është shndërrimi i FSK-së në ushtri, bisedimet me Serbinë lidhur me arritjen e marrëveshjes finale mes dy shteteve, e shumë çështje të tjera.

Samiti i Frankofonisë, i mbajtur në Jerevan të Armenisë, ishte një sukses i pakontestueshëm për Kosovën, me ç'rast nga vëzhguese, Kosova u bë anëtare e asociuar e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, e cila vlerësohet të jetë një organizatë shumë e fuqishme në botë që promovon paqen, zhvillimin e qëndrueshëm dhe tolerancën kulturore në botë.

Lufta e Parë Botërore apo Lufta e madhe ishte lufta më e përgjakshme në historinë e njerëzimit, e cila më vonë kalohet vetëm nga Lufta e Dytë Botërore. 100-vjetori i armëpushimit, i cili u kremtua në mënyrë madhështore në Paris, mblodhi krerët e fuqive kryesore të botës. Respekti i madh, i cili iu bë delegacionit nga Kosova, ishte mbresëlënëse dhe për t'u përshëndetur. Në

takimet që u mbajtën aty u rikonfirmua mbështetja për të ardhmen dhe zhvillimin e sigurt të Kosovës. Përderisa para 100 vjetëve Kosova nuk njihej as si koncept gjeografik, atë ditë Kosova u respektua njësoj sikur të gjitha shtetet e tjera pjesëmarrëse, e po ashtu u respektua si shtet edhe nga ato vende që akoma nuk na kanë pranuar si të tillë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse Kosova arriti të bëhej protagoniste në takimet më të rëndësishme botërore, është e qartë se procesi i njohjeve të shtetit tonë nga vendet e tjera ka pasur ngecje. Gjatë këtij mandati të kësaj qeverie ne kemi pranuar 2 njohje, për të cilat jemi falënderues ndaj atyre shteteve. Nga ana tjetër, kemi pasur raportime mediale, kundërthënëse, ku është raportuar për tërheqje të njohjeve nga ana e disa shteteve. Edhe pse Ministria e Punëve të Jashtme ka hedhur poshtë këtë lajm disa herë, ne kërkojmë që ministri Pacolli të japë sqarime se cila është e vërteta lidhur me këtë çështje mjaft shqetësuese. Është e kuptueshme që diplomacia e jashtme kosovare, e sidomos aspekti lobues ka dimension të gjerë. Në këtë drejtim një vend shumë të rëndësishëm zë edhe lobimi për liberalizim të vizave, apo vendimi që do ta marrë BE-ja për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Ne e përshëndesim dhe e vlerësojmë rolin që Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka marrë në këtë proces lobues. Kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli, së bashku me përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, përveç Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili publikisht e ka bojkotuar, kanë zhvilluar diplomacinë parlamentare dhe kanë zhvilluar takime dhe vazhdojnë të zhvillojnë takime lobuese në të gjitha shtetet evropiane, në mënyrë që të sigurojnë mbështetje edhe në këtë fazë të fundit të vendimmarrjes në procesin e heqjes së vizave nga Bashkimi Evropian. Kosova e rikonfirmon edhe një herë që i ka plotësuar të gjitha kriteret e vëna nga Bashkimi Evropian dhe zotohet të vazhdojë të punojë në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Prandaj, nuk kemi arsye të jemi pesimistë, megjithatë është evidente që kemi një vonesë të paarsyeshme të vendimmarrjes nga BE-ja, e cila ka bërë që qytetarët e Kosovës të mbeten të izoluar në këtë pjesë të rajonit dhe të ndjehen mosbesues dhe të lënë anash.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që mossa e Kosovës për anëtarësim në Interpol ishte një lajm dëshpërues për të gjithë. Në lidhje me këtë fajësuar majtas e djathtas, por një gjë është e sigurt: mbi të gjitha ky ishte një dështim për drejtësinë në gjithë botën. Në Dubai atë ditë fitoi krimi mbi drejtësinë, ndërkohë që Serbia festoi. Kjo në botën e civilizuar e demokratike është absurde, mirëpo ne që e njohim Serbinë mirë, nuk çuditemi. Ne nuk mund ta kthejmë faqen tjetër pas kjo goditjeje nga Serbia, prandaj PDK-ja ka mbështetur masat ekonomike që Qeveria e Kosovës i ka ndërmarrë ndaj mallrave me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina si reagim për pengesat e vazhdueshme të këtyre vendeve ndaj rrugëtimit integruar dhe zhvillimor të Kosovës.

Sigurisht që këto masa duhet të jenë në pajtim me të gjitha ligjet në fuqi, me marrëveshjet ndërkombëtare, duke mos e cenuar mirëqenien e qytetarëve, duke mos i cenuar raportet e mira me vendet e tjera, dhe sidomos duke i ruajtur si sytë e ballit raportet me vendet mike, të cilat i kemi ndërtuar me vite të tëra.

Në të njëjtën kohë, PDK-ja u bën thirrje Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe të gjitha vendeve perëndimore si vende mike dhe me ndikim të madh në rajon që t'i kërkojnë Serbisë t'i pezullojë të gjitha veprimet diplomatike të saj, të cilat në cilëndo mënyrë e pengojnë Kosovën.

Këto veprime të Serbisë, jo vetëm që po e pengojnë Kosovën dhe shtetësinë e saj, por janë kontribut edhe për ngecje dhe destabilizim në rajon dhe më gjerë. Sa i përket Interpolit, edhe një herë, ne duhet të bëjmë analiza të thukëta lidhur me këtë dhe të marrim mësim dhe të përgatitemi më mirë për herën tjetër, kurdo që do të aplikojmë.

Në anën tjetër, ne jemi shumë krenarë për të gjitha të arriturat e Policisë sonë, e cila duhet të inkurajohet edhe më tej që ta vazhdojë punën e mirë që po bën në luftimin e krimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të saj. Ne jemi falënderues ndaj të gjitha atyre shteteve të cilat me votën e tyre e mbështetën anëtarësimin e vendit tonë në Interpol.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në agjendën legjislative për këtë vit është paraparë gjithashtu që Ministria e Punëve të Jashtme do të sjellë në Kuvend disa projektligje të cilat i përkasin këtij resori, pasi ligjet aktuale kanë shumë mangësi dhe nuk u përgjigjen rrethanave të reja të krijuara. Deri më tani, kjo ministri nuk ka sjellë asnjë projektligj për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës. Konsiderojmë se kjo vonesë në sjelljen e ligjeve dhe në mospërbushjen e agjendës legjislative po çon në degradimin e mëtejshëm të Shërbimit të Jashtëm dhe të vetë organizimit të MPJ-së. Prandaj, ne kërkojmë nga Ministria e Punëve të Jashtme që urgjentisht të procedojë me këto projektligje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Siç e dini, në këtë legjislaturë të Kuvendit, Komisionin për Punë të Jashtme e udhëheq pikërisht njëra nga partitë iniciuese të këtij debati, pra Lidhja Demokratike e Kosovës. Dhe, funksion kryesor i këtij komisioni është mbikëqyrja e punës e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës.

Por çfarë ka bërë ky komision në këtë drejtim? Tash e 15 muaj, ky komision nuk ka arritur të monitorojë as edhe një ligj të vetëm në bazë të të cilëve funksionon Ministria e Punëve të Jashtme. Ky komision që në mbledhjet e para e ka formuar grupin punues për hartimin e strategjisë për diplomacinë parlamentare, asnjëherë të vetme nuk është mbledhur dhe nuk është

funksionalizuar si grup. Prandaj, ne e kuptojmë shprehjen e shqetësimeve dhe dëshirën për të debatuar për çdo gjë, mundësi kjo që i jepet edhe për të bërë më shumë reklamë dhe për të qenë protagonist sesa për të zgjidhur problem, megjithatë para se të kritikohen të tjerët duhet që në radhë të parë të bëhet autokritikë.

Krejt në fund...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Kush e do fjalën? Deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndoshta zonja Osmani e ka kërkuar replikën dhe është udhës që të jetë aktuale, mirëpo ju ma dhatë fjalën dhe unë po e mbaj ashtu. Faleminderit!

Ne sot po flasim në terma të përgjithshëm për marrëdhëniet me botën e jashtme kryesisht, dhe sidomos me një theks të veçantë për dështimin e Kosovës në politikën e jashtme. Unë e dëgjova edhe kolegen parafolëse që foli për një sukses të jashtëzakonshëm të Kosovës në këta muaj të fundit, ku Kosova është bërë anëtare e asociuar e një OJQ-je të Asociacionit të vendeve të Frankofonisë, që në thelb nuk është institucion ndërkombëtar, por është një OJQ. Kështu që nuk ka ndonjë vlerë, edhe asociimi në vendet e Frankofonisë është i mirë, por nuk e zëvendëson institucionin e Interpolit, që ka të bëjë me marrëdhënie konkrete në lidhje me çështje të caktuara. Por, edhe Frankofonia është mirë, po nuk bën ta rrisim aq shumë sa të përpiqemi ta mbulojmë dështimin e Qeverisë, sidomos Ministrisë së Punëve të Jashtme në anëtarësimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare që kanë vlera konkrete dhe veprime konkrete, siç janë UNESCO dhe Interpoli.

Në të vërtetë, marrëdhëniet ndërkombëtare nuk janë asgjë tjetër përveçse pasqyrim i saktë dhe njëra anë e medaljes së politikës së brendshme të një vendi. Por, çka është duke ngjarë në Kosovë? Në Kosovë, në të vërtetë ne e kemi një kaos të vërtetë sa i përket politikës së jashtme të Kosovës, marrëdhënieve me jashtë, me botën. Së pari, në aspektin e ndërtimit të strukturës institucionale, ne e kemi një kaos sa u përket dikastereve të ndryshme që përfaqësojnë Kosovën, por nuk janë fare të koordinuara. Ta marrim për shembull, ne e kemi një president që e përfaqëson politikën e jashtme, mirëpo që ka vënë në pikëpyetje me nismat e tij që nuk i dinë si t'i quajmë të marra, apo tradhtarë, integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit. Ajo është pika kulmore e marrëdhënieve me botën e jashtme, meqë vendi që vetë presidenti e refuzon d.m.th. integritetin territorial dhe sovranitetin natyrisht që nuk ka ndonjë perspektivë në marrëdhëniet me botën e jashtme, sepse askush nuk është i sigurt me kë ka të bëjë.

Mandej e kemi një Ministri të Punëve të Jashtme dhe një ministër të Punëve të Jashtme që gjithë veprimtarinë e tij e mbështet vetëm në dijen e dyshimtë biznesore që e ka. Ai nuk ka lidhje as me politikën e jashtme, as me marrëdhëniet diplomatike, as me diplomacinë. Ai ka lidhje të forta dhe dije të fortë në pazaret dhe në lidhjet biznesore që i ka. Edhe unë jam i bindur se në çdo grumbullim diplomatik ku paraqitet zoti Pacolli, Kosova vetëm do të ketë armiq, nuk do të ketë miq, sepse jo vetëm ai që nuk e ka dijen, por edhe personat që e përcjellin, edhe krejt establishmenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme është shndërruar në biznes.

Në anën tjetër, e kemi po ashtu Ministrinë e Integritimit Evropian që po ashtu merret me diplomaci dhe merret kryesisht me Bashkimin Evropian. Sa më shumë angazhohet Ministria e Integritimit Evropian, Kosova aq më larg e ka Bashkimin Evropian. Çdo hap që e bën kjo ministri, Bashkimi Evropian i largohet Kosovës.

Ka këtu ndonjë arsye, arsyet e vërteta nuk po i dimë, por një po e dimë, sa herë politikanët e establishmentit qeveritar e gënjejnë popullin se e kemi afër liberalizimin, liberalizimi ikën edhe më larg nga Kosova dhe nga qytetarët e Kosovës.

Po ashtu, në marrëdhëniet ndërkombëtare përzihet edhe kryetari i Kuvendit, bën lobim - thuhet parlamentar, bën lobim diplomatik. Në njërin anë e ka shndërruar Kuvendin në një institucion të pavlerë, që nuk mund ta marrë asnjë vendim, që nuk ka kuorum, nuk dihet kur vendos kur nuk vendos, kur mbahet seancë, kur nuk mbahet seancë, në anën tjetër, me enturazhin e tij ka dalë në Evropë dhe lobon për liberalizimin e vizave, sikur të ishte liberalizimi i vizave synimi i vetëm kryesor i krejt Kosovës, i politikës së jashtme dhe sidomos i Kuvendit të Kosovës.

Po ashtu, ne e kemi edhe një ministri tjetër, një institucion tjetër që merret me çështje diplomatike. Pak ose shumë, e di ose s'e di, ajo është Ministria e Diasporës. Në të vërtetë askush nuk e di saktësisht me çka merret, po sigurisht në veprimtarinë e vet e ka edhe çështjen e lobimit.

Ne, në të vërtetë, e kemi një spektër politik qeveritar që për doktrinë në politikën e jashtme e ka vetëm kaosin, e ka krijimin e mjegullës sikur ujçit dhe sa më shumë mjegull, aq më shumë gjah. Por, nuk ka doktrinë për të cilën mund të flitet. Ne vetëm mund ta shohim kaosin ligjor që është në të ashtuquajturin spektër të marrëdhënieve të jashtme të Kosovës me botën. Veç t'i shohim çfarë ligjesh kanë bërë, dhe e dimë ku është gjendja e Kosovës.

Ne e kemi një establishment qeveritar që e udhëheq Kosovën edhe në marrëdhëniet me botën që për strategji nuk ka asgjë tjetër përveçse kapjes personale dhe materiale të vendeve që quhen përfaqësim në botën e jashtme, qoftë në diplomaci, qoftë në Shërbimin e Jashtëm, qoftë në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Nuk është e rastësishme që kryeministri i vendit para një kohe i quajti në një tubim diplomatët "qyqanë". Edhe unë mendoj se ka qenë ndoshta ka qenë një përgjithësim shumë i madh dhe i rëndë, mirëpo, në anën tjetër, këta e dinë kë e kanë çuar jashtë.

Vërtet ndoshta ata nuk janë qyqanë, por e dinë që kanë çuar njerëz të padijshëm që nuk kanë lidhje me politikën e jashtme, me diplomacinë, madje nuk e njohin as gjuhën e vendit ku kanë shkuar. Për herë të parë kanë dëgjuar për fjalën diplomaci kur u ka thënë shefi “ti ke për të shkuar në X apo Y vend”. Qyqanë janë vërtet ata që pyesin, por ata që pyesin megjithatë e kanë një interesim për vendin, sepse diplomati duhet të marrë udhëzime nga Qeveria, se diplomati përfaqëson, nuk krijon politika, prandaj merr udhëzime për politikën si duhet t’i përfaqësojë. Por, i kemi të tjerët që nuk janë qyqanë, që nuk pyesin fare hiç çka duhet bërë. Ata nuk pyesin as kryeministrin, as Qeverinë dhe askënd, se ata e dinë se janë më të fortë se kryeministri, më të fortë se Qeveria dhe janë shefa të shefave në vendin e tyre ku janë caktuar. Veç merreni një listë të mbimrave, shikojeni kë e kemi diplomat dhe do ta shihni si është puna.

Ne e kemi ministër të Punëve të Jashtme një njeri që ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare në kundërshtim me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare. Unë e kam bërë një pyetje, së cilës ky ministër i Jashtëm ka denjuar t’i përgjigjet për katër muaj rresht, dhe përgjigjja e tij ka qenë katastrofale. Ka nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare me Italinë në kundërshtim me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare, sepse e ka nënshkruar vetëm në dy gjuhë, në gjuhën italiane, domethënë në gjuhën e njërit nga vendet, dhe në gjuhën angleze, por në asnjërën gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet ndërkombëtare natyrisht që janë përfaqësim, por në thelb e kanë anën bilaterale, e kanë qytetarin e vendit me të cilin nënshkruan Kosova dhe qytetarin e Kosovës. Ato duhet të jenë të kuptueshme, duhet të jenë në gjuhën e vendeve të cilat nënshkruajnë. Ky ministër i Jashtëm, me nënshkrimet në dokumentet ndërkombëtare në të vërtetë e mohon sovranitetin e Republikës së Kosovës dhe nuk gërzhitet aspak, siç thotë populli ynë, për ato që i bën. Sa më shpejt që të shkojë ky ministër i Punëve të Jashtme, edhe shumë ministra të tjerë dhe njerëz të tjerë që e përfaqësojnë Kosovën në botë, aq më mirë do t’i ketë punët Kosova. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, fjalën e ka deputeti Dukagjin Gorani.

DUKAGJIN GORANI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Sot besoj që do të flitet mjaftueshëm për dështimet tona të jashtme, për turpërimin tonë në Dubai, për debaklin në UNESCO, për njohjet që po tërhiqen, përkundër blerjeve dhe premtimeve dhe për mjerimin e izolimit tonë ndërkombëtar.

Andaj do të përpiqem në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së, këtë talljen që e quajmë politikë të jashtme shtetërore ta vështroj nga një kënd tjetër. Nga këndi i vetëm, nga i cili besoj duhet të vlerësohet, e ai është nga këndi i politikave të brendshme.

Nga këndvështrimi i menaxhimit kriminal të shoqërisë tash e gati 20 vjet, ku qeverisja e populli dhe administrimi publik gjithnjë mbeti vetëm emërim tjetër për dominim partiak, zhvatje familjare dhe dhunim klanor të rendit shoqëror.

Nuk besoj se kalon një ditë e vetme, e që nuk e dëgjoj frazën; orientimi strategjik i Kosovës është properëndimor, proevropian, demokratik e bashkëkohor, se Kosova ka miq e aleatë të fuqishëm që e respektojnë shtetësinë, historinë e popullit të saj, se diplomacia jonë po shënon suksese të mëdha në skenën ndërkombëtare.

Nëse kjo është e vërtetë, pse atëherë vazhdojmë të mbahemi të izoluar nga po këta miq e aleatë? Pse përkundër orientimit tonë properëndimor e proevropian jemi shoqëria e fundit në Ballkan, e cila vazhdon të jetojë në ankthin primitiv të viteve të '90-ta, e pambrojtur e pafuqishme, e pasigurt dhe e mbyllur.

Nëse ky vërtet është orientimi ynë, pse atëherë nuk e kuptojmë se po këta miq e aleatë na vlerësojnë, jo sipas frazave që i llomotitim sa herë që jemi jashtë, por sipas ngatërresave dhe papërgjegjësive që i shkaktojmë brenda.

Askund më shumë sesa në këtë shakanë që e quajmë diplomaci nuk hetohet kotësia e përpjekjes sonë që ta detyrojmë dikë të na vlerësojë për atë që e themi, e jo për atë që e bëjmë. Asnjëherë për këto dhjetë vjet, asnjë nga qeveritë, asnjë nga ministrat e Jashtëm, e as presidentët nuk e kuptuan kurrë që politika e jashtme është gjithçka tjetër përveç përsëritjes së frazave boshe, se jemi një shtet i ri dhe na duhet përkrahje.

Se është gjithçka tjetër përveç fotografimeve elektorale nëpër korridore hotelesh e nëpër margjina të konferencave. Asnjëherë për gati 20 vjet me marrëdhënie bilaterale nuk u kuptua gjë tjetër, veçse mënyrë përfitimi e ndonjë bande partiake duke e vënë në shitje vendin nëpër tenderë miliardësh e nëpër privatizimi kriminale të implementuara nëpërmjet zhvatjeve klanore.

Gjatë gjithë këtyre viteve, kjo kulturë e qeverisjes ia doli ta shtrembërojë tërësisht edhe kuptimin e nocioneve; diplomaci, lobim, marrëdhënie ndërkombëtare e integritet evropiane.

Kësisoj sot, në të folmen tonë të përditshme, me diplomaci nënkuptohen vetëm vizitat e kota nëpër qeveritë e botës për të raportuar për sukseset e paqena shoqërore dhe ekonomike dhe për të përsëritur fraza boshe se shteti i ri ka vuajtur shumë dhe ka nevojë për ndihmën tuaj.

Sot lobimi për njohje nënkupton vetëm mënyrë të zhvlerësimit të shtetësisë sate deri në nivel të një transaksioni financiar të ndonjë shitblerjeje, gjithnjë duke shpresuar në efektin e miqësive të trilluara private e personale.

Sot, me marrëdhënie bilaterale nënkuptohet kryesisht shndërrimi i resurseve tua në një aplikacion për tenderë ndërkombëtarë që do të fitohet nga ndonjë koncorcium aleat e miqësor, e do të paguhet me dekada nga paratë e shoqërisë më të varfër të kontinentit.

Pikërisht sot, më shumë se kurrë, deficitit tregtar i këtij shteti karshi fqinjësisë dhe mbarë botës flet më së miri për politikën e jashtme të tij. Raftet e vetëshërbimeve tona me mish nga Brazili e gullash nga Kroacia, me miell nga Serbia e ajvar nga Maqedonia, flasin më së miri për dokrrat tona mbi diplomacinë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Fakti që jemi shndërruar në shoqëri, e cila me ekonomi e nënkupton vetëm importin, ku buxheti varet nga doganat, ku tregtari mban dërs për zhvillim ekonomik, ku edhe një shitës karburantesh e quan vetën naftëtar, flet më së miri për logjikën e bastarduar qeveritare, ekonomike, e sidomos diplomatike.

Kolegë të nderuar,

Ajo botë perëndimore që ne e synojmë, e cila e mundësoi çlirimin, lirim dhe shtetësinë tonë, na vlerëson vetëm për nga politikat tona të brendshme. As atë, e askënd tjetër nuk ia dolëm kurrë ta bindim që të na shohë ashti siç duam ne.

Të gjitha njohjet e deritashme që i kemi, pa dallim, ishin dhe janë rezultat i vullnetit të atyre shteteve, veç e veç. Ishin shenjë aleance dhe inkurajimi për një shoqëri të re, por asnjëherë në asnjë rast rezultat i lobimit dhe diplomacisë sonë patetike.

Ndoshta për një numë të vogël të këtyre njohjeve të shtrira diku nëpër arkipelagët e Karaibeve edhe u tregtua në ndonjë resor turistik, mirëpo lajmet skandaloze që po dëgjojmë përditë për tërheqjen e tyre, kam frikë se do të na dëshmojnë se ishin jetëshkurtra, se ishin të improvizuara, e mbase edhe të falsifikuara.

Përndryshe, ajo që tek ne e sheh bota perëndimore dhe evropiane, të cilën aq shumë e synojmë, është një shoqëri e pafuqishme karshi një qeverisjeje që nuk e do e as nuk e mbron as atë, e as shtetësinë e vet.

Duke qenë pjesëmarrëse aktive në ndërtimin e këtij realitetit tonë qeverisës e parlamentar, po del se kjo botë mike dhe aleate nuk u paska besuar as për një çast të vetëm llomotitjeve tona lobuese e diplomatike. Për të sistemi i kriminalizuar i drejtësisë që kemi ishte dhe mbetet njësi e vetme matëse e krejt suksesit tonë ndërkombëtar.

Për të, shkalla imbecile e arsimit tonë shihet si brengë e madhe për çfarëdo bashkëpunimi ndërkombëtar. Për të, cilësia e shëndetësisë sonë publike është tregues i indiferencës sonë ndaj njëri-tjetrit, i mosbesimit në vete dhe i mungesës totale të konsideratës për shoqëri.

Kultura e korrupsionit, jeta në padrejtësi, egoizmi klanor që tashmë është normë mbarëshoqërore, pamëshirësia ndaj resurseve, ndaj ambientit e buxhetit, ndaj familjes e gruas, të gjitha këta janë dhe do të mbeten e vetmja pasqyrë vlerësuese e jona edhe për shumë vjet që do të vijjnë.

Andaj, përderisa nuk avancojmë si shoqëri e suksesshme përbrenda, politika jonë e jashtme dhe diplomacia jonë s'do të jenë kurrëgjë tjetër, pos një objekt i talljes nëpër zyrat e qeverive të botës dhe material për shpotitje nëpër mediat ndërkombëtare. Kjo për faktin se kurrë nuk deshëm ta kuptojmë se politika e jashtme përbëhet vetëm nga ajo që je në gjendje t'i ofrosh tregut të madh të shoqërive të këtij planeti.

T'i ofrosh botës punën dhe prodhimin tënd, shkathtësinë dhe ekspertizën e qytetarëve tuaj, sukseset e sportistëve tuaj, e jo vazhdimisht të kërkosh e të ankohesh, e në fund të detyrohesh të tregtosh me resurset e tua, me pronat e shoqërisë, me kufijtë e shtetit dhe me të mirën publike.

Kurrë s'e kuptuam ,e as që duam ta kuptojmë se të gjitha politikat, e më shumti ajo e jashtme, janë pasqyrë e gjendjes sonë të brendshme.

Andaj gjithë këto vite të shpenzuara në gënjime të kota elektorale të vetvetes po na hakmerren sot një nga një.

Jemi më të izoluar se kurrë, përkundër të gjitha sukseseve tona diplomatike. Jemi më të mospërfillur se kurrë, përkundër gjithë fotografimeve me liderët botërorë. Jemi më të vetmuar se kurrë, edhe pse tash e sa muaj i kemi vënë në shitje edhe kufijtë e shtetit edhe tokat e popullit. Faleminderit!

KRYESUSI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kjo seancë e thirrur për të dytën herë veç nënkupton që nuk kemi përgjegjësi të mjaftueshme institucionale në vendin tonë, e madje nuk e di sesa do të ketë rezultat kjo seancë, meqë nuk është këtu i pranishëm kryeprogonisti për të cilin është thirrur seanca për t'i dhënë sqarimet e duhura rreth politikës së jashtme.

Po ashtu, ne nuk duhet të bazohemi vetëm në momentet kur ndodhin ngjarjet, por paraprakisht duhet të reflektojmë dhe duhet të përgatitemi për momentet e caktuara që Kosova të fitojë, e jo të

ketë një arenë të diskurseve, të cilat mund ta acarojnë politikën e brendshme, e në këtë rast fitojnë kundërshtarët.

Në saje të kësaj politike, e cila është zhvilluar deri më tani, po shihet se nuk ka një dakordim të mjaftueshëm në politikën e jashtme, sepse edhe Qeveria, edhe Parlamenti nëpërmjet komisioneve të saj të politikës, qoftë të integrimi, qoftë të politikës së jashtme, mund të ketë një qasje më aktive dhe më kuptimplote që ajo të fitojë si shtet.

Pikërisht disa vendime që janë marrë në Kosovë, e që kanë të bëjnë me politikën zhvillimore të brendshme janë nga Qeveria e Kosovës, e treguesi më i mirë e nuk u tha asnjë moment deri tani, që Qeverisë së Serbisë duhet t'i kundërvihemi me politika të cilat e favorizojnë Kosovën në të gjitha planet, e në këtë rast po e përmendi edhe taksën e vënë për 100% në produktet e Serbisë.

Ky është normalisht një vendim që e favorizon Kosovën, favorizon prodhuesit vendor, favorizon konsumatorin e Kosovës dhe favorizon shtetin e Kosovës. Po ashtu duhet të bëhen veprime edhe më tutje, në mënyrë që Serbia ta kuptojë se Kosova është shtet sovran dhe i pavarur dhe funksionon si i tillë. Dhe, absolutisht reciprociteti duhet të vihet si mënyrë e sjelljes ndaj një fqinji, i cili as nuk i zbaton marrëveshjet e arritura në Bruksel, por po ashtu e ka një politikë shumë agresive ndaj Kosovës edhe në planin ndërkombëtar, e që faktikisht është zotuar se nuk do ta pengojë atë në proceset integruese.

Meqë kemi të bëjmë me një shtet, i cili edhe më tutje e ka në politikën e saj shovinizëm dhe veprime anti-Kosovë, atëherë dialogu duhet të ndërpritet. Duhet të kërkohen të gjitha dëmshpërblimet nga Serbia për dëmet që i janë bërë Kosovës dhe qytetarëve të saj. Dhe, po ashtu të vijë në shprehje reciprociteti, po e përsëris edhe një herë, në mënyrë që Kosova vërtetë ta tregojë vitalitetin e vet, zhvillimin e vet si shtet.

Prandaj, konsideroj se për ngjarjen që ndodhi, e që ishte Interpoli, që Kosova nuk ka arriti të bëhet pjesëtare e këtij mekanizmi jashtëzakonisht të rëndësishëm të sigurisë ndërkombëtare, konsideroj që duhet të mbledhim mend dhe të fokusohemi në një politikë, e cila vërtet është frytdhënëse, duke u pozicionuar opozitë e pozitë njëjtë kur është në pyetje interesi i shtetit të Kosovës.

Duhet të bëhen të gjitha veprimet të cilat ia pamundësojnë Serbisë që të ndërhyjë në territorin e Kosovës, në manipulimin e qytetarëve të Kosovës, e sidomos atyre serbë, në mënyrë që shteti i Kosovës të funksionojë ashtu siç duhet. Prandaj, edhe Qeveria kur thirret në interpelanca, në seanca të jashtëzakonshme, në debate, duhet të jetë e pranishme në Parlament, në mënyrë që të mos vazhdojë edhe më tutje mjegull, por përkundrazi të bëhen sqarime të duhura pa tendenca dhe pa ikje nga përgjegjësitë që i kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të Listës serbe. Nuk është paraqitur askush dhe askush nuk është në sallë nga ai grup. Nga Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate, kush e do e fjalën? Deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Sot po diskutojmë për një çështje bukur me rëndësi për vendin, e cila ndoshta është pak me vonesë, por megjithatë më mirë vonë se hiç. Natyrisht, nga momenti i thirrjes së seancës së jashtëzakonshme nga partitë opozitare, situata natyrisht në raport me politikën e jashtme është ashpërsuar dhe kanë nxjerrë tema, të cilave megjithatë asnjëri prej deputetëve nuk mund t'u ikën.

Si do që të jetë, unë mendoj se Kosova që nga shpallja e pavarësisë ka ngecur në prezantimin e duhur në raport me politikën e jashtme dhe kjo është si rezultat i mosunifikimit të faktorit institucional që lidhet me diplomacinë e vendit.

Kur kem parasysh se presidenti, Ministria e Jashtme, por edhe Kuvendi nuk kanë koordinim për angazhimet e tyre lidhur me prezantimin e shtetit të Kosovës karshi ndërkombëtarëve dhe karshi mekanizmave, të cilët janë të domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie normale, siç është Kosova dhe rajoni.

Gjithë këtë gamë të mjegullnajës në raport me politikën e jashtme kohët e fundit e ka rritur edhe ideja e presidentit, i cili, me vetëdije apo pa vetëdije, lidhur me korrigjimin e kufijve është futur në agjendën e logjikës politike ruso-sllave.

Bisedimet me Serbinë pa ndonjë strategji të duhur këtë të fundit e kanë lazdruar së tepërmi, sa që ajo ta rrisë luftën politike dhe diplomatike e speciale kundër Kosovës, luftë e cila thjesht i ka dhënë rezultatet e veta në dëm të Kosovës, për të cilën unë po mendoj se të gjitha forcat politike, e veçanërisht ne deputetët duhet të mendojmë pak më ndryshe në situatën e re që jemi.

Këtij dështimi të politikës së jashtme natyrisht se i bashkëngjitet edhe trupi diplomatik i politizuar skajshmërisht, të cilët nuk janë si rezultat vetëm i kësaj legjislature, por edhe i legjislaturave të kaluara. Unë vetë jam deputet në Komisionin për Politikë të Jashtme, edhe në legjislaturën e kaluar kam qenë dhe e di se të gjitha subjektet, të cilat sot, me përjashtime, kuptohet, mund të thirren në politizim të trupit diplomatik, e kanë hisen e vet të politizimit.

Ne kemi diplomatë të Kosovës, ndaj të cilëve ndihemi shumë keq kur jemi jashtë Kosovës, por kemi edhe të tillë që vërtet të bëjnë të ndihesh mirë dhe në këtë drejtim po mendoj se duhet hequr dorë nga militantizmi në politikë, veçanërisht kur është në pyetje politika e jashtme, sepse po e

shohim se shumëçka varet edhe nga diplomatët, veçanërisht ambasadorët në vendet e caktuara, ku janë të kryqëzuara interesat e fuqive botërore.

Dështimi i Kosovës për t'u bërë pjesë e Interpolit mendoj se duhet të shikohet si dështim i të gjithëve, sepse këtu ka dështuar Kosova dhe jo vetëm Pacolli.

Kuptohet, Pacolli është ministër i Jashtëm, por në përpjekjet dhe në angazhimet e përbashkëta për t'u bërë Kosova pjesë e Interpolit, d.m.th. ka një angazhim më gjatë se Pacolli që është në krye të ministrisë dhe unë po mendoj si të tillë duhet ta shikojmë, sepse duke e shikuar si të tillë, duhet të mendojmë se si tash të përballemi me Serbinë, e cila është në një luftë të ashpër politike e diplomatike ndaj Kosovës.

Si rezultat i situatës së fundit me Interpolin, Qeveria ka marrë disa masa, të cilat natyrisht i mbështesim, por unë po mendoj se masat ndaj Serbisë duhet të ashpërsohen dhe të jenë në shumë dimensione, që Serbia një herë e përgjithmonë duhet ta kuptojë se ka të bëjë me shtetin e Kosovës dhe jo me provincën e saj, e cila ide për provincë rrjedh nga bisedimet e fundit që ka ndodhur në Bruksel, siç thashë pa ndonjë strategji të duhur, ku Serbinë natyrisht e kanë privilegjuar deri në atë shkallë sa që thjesht avazin e vjetër të logjikës milosheviqiane ta vazhdojë edhe 20 vjet pas luftës në raport me shqiptarët dhe Kosovën.

Natyrisht, kur jemi te masat, unë mendoj se kryeministri dhe Qeveria, po edhe të gjithë ne duhet të mendojmë edhe diçka tjetër. Masat ndaj produkteve të Serbisë duhet të përcillen me kujdes, për shkak se ne, ta zëmë, 10 minuta pas vendimit të Qeverisë kemi operatorë ekonomikë që e furnizojnë Kosovën me mallra të Serbisë, të cilët i kanë njoftuar bashkëpunëtorët e tyre se çmimi i produkteve, veçanërisht i miellit prej 37 bëhet 50 dhe unë mendoj se Qeveria jo për t'i ndëshkuar tregtarët dhe bashkëpunëtorët e biznesit me Serbinë, por duhet të mendojë që këta individë të cilët po donë ta shfrytëzojnë situatën e shtetit të Kosovës në raport me Serbinë duhet pasur parasysh, dhe disa nga projektet kapitale milionëshe të Kosovës të ngrihen në kuptim e asaj që Kosova të ketë buxhet të mjaftueshëm të përballlet me një anarki që mund të ndodhë në fushën e biznesit sa u përket mallrave të Serbisë, për të mos ngarkuar shportën e qytetarëve.

Përpjekja për bërjen e shtetit siç duam të gjithë nuk është mirë të minohet për llogari të politikës ditore apo të interesave të ndonjë vote. Kur është në pyetje Kosova, unë si qytetar dhe si deputet, por edhe Nisma për Kosovën mendojmë se partia duhet të jetë në rend të dytë.

Po e them këtë, sepse nganjëherë po dëgjoj zëra që nuk përkojnë me gjendjen në të cilën është Kosova, me situatën të cilën duhet të përballemi të gjithë, edhe si qytetarë, edhe si pjesë e politikës.

Serbia vazhdon të jetë ajo që ka qenë para luftës dhe gjatë luftës. Logjika e asaj politike vazhdon të jetë edhe sot në krye të politikës së Beogradit dhe vetëm duke qenë unikë si forca politike, si qytetarë, jo vetëm mund t'i dalim përball, por edhe të triumfojmë, sepse e drejta është në anën e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+, nuk ka asnjë përfaqësues në sallë.

Para se t'i jap fjalën kryeministrit, deputetja Vjosa Osmani ka kërkuar të replikojë. Regjia, fjalën Vjosës, ju lutem!

VJOSA OSMANI: Po përgjigjem shkurt, pasi e mora fjalën.

Përfaqësuesja e PDK-së tha të pavërtetat sa i përket punës së Komisionit për Punë të Jashtme. Nuk mund të dish ti a është a nuk është, kur as nuk je aty, as nuk e kupton këtë fushë. Këtu po flasim për një person, e cila sa herë ne si komision tentojmë të merremi me punën tonë themelore, që është çështja e dialogut me Serbinë, pra që ka të bëjë me raportet me një shtet fqinj, për ta mbrojtur një familjar të saj çohet nga mbledhja e komisionit dhe e prish kuorumin e komisionit.

Tash për përgjegjësi po na flet dikush që nuk e lë komisionin të punojë dhe dikush që e udhëheq grupin punues për diasporë e s'i intereson asnjë dëgjim publik që mbahet me diasporën.

Sa i përket punës së Komisionit për Punë të Jashtme, në qoftë se krahasohet me mandatet e kaluara, nga fillimi i punës së këtij Kuvendi e deri më sot ky komision e ka trefishuar punën, e ka rritur seriozitetin e temave që trajtohen aty, duke u shndërruar nga një komision që merret vetëm me çështje teknike në një komision që tenton të përcaktojë orientimet e politikës së jashtme, e të mos flasim tani për bllokadën që e kanë bërë partitë e pushtetit, të cilat kur ne tentuam që ta shqyrtojmë raportin e vetë Qeverisë, të hartuar nga vetë zoti Avni Arifi, i caktuar nga kryeministri Haradinaj, deputetët e pushtetit e bllokuan, sepse thoshin që ajo temë nuk është fare me rëndësi.

Tani nuk mund të presim ne seriozitet, as vlerësime serioze nga persona që çdo herë kur nuk u pëlqejnë temat, e çdo herë kur donë t'i mbrojnë idetë ruso-serbe, në vend se të rrinë në komision aty ku e kanë vendin, qoftë edhe të votojnë kundër çohen edhe e bllokojnë kuorumin e atij komisioni.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri, të paraqesë qëndrimin e Qeverisë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Shala,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Media e qytetarë,

Ne kemi marrë një ftesë për seancë para një jave, kemi kërkuar të shtyhet, e sot e kam për nder që jam me ju.

E vërteta është se politika jonë e jashtme i ka të metat e veta, i ka disa të çara dhe ka vend për kritikë, besoj që kjo është e drejtë të pranohet dhe ta themi të gjithë ne.

Dëshira ime është që sot në seancë të nxjerrim nga diskutimet tuaja ato detyra ose obligimet më me rëndësi që i sheh Parlamenti, qysh e ka përcjellë Parlamenti politikën tonë të jashtme, se nuk ndahet prej të brendshmes, po megjithatë po flasim për të jashtmen dhe të na jepni rekomandime sa më të qarta ose konkluzione sa më të qarta.

Sa i përket temës së sotme, e kam ndarë në disa pjesë, është Kosova vetë, pra vetë Kosova, çka ndodh në Kosovë, është Kosovë-Seri, Kosova me Serbinë, pra si zhvillohen këto marrëdhënie, është Kosova me rajonin dhe Kosova me botën, pra çka bëhet në planin global.

Sa i përket Kosovës në 10 vjetët pas pavarësisë, ne e kemi festuar 10-vjetorin, është një kohë e reflektimit, ndoshta e rishqyrtimit të krejt atyre përvojave, informatave, argumenteve që janë akumuluar gjatë këtyre 10 vjetëve shtet për ne, të nxjerrim pastaj një konkluzion si ndoshta të bëhemi gati për 10 vjet të tjera, e çka do të jenë këto 10 vjet për Kosovën.

Pra, në planin e brendshëm, si Kosovë ajo që kam hetuar, për shembull, si Qeveri që është e rëndësishë së parë është përmbyllja e infrastrukturës së sigurisë në vend. Një shtet duhet ta përmbyllë infrastrukturën e vet të sigurisë, përndryshe është jo i plotë dhe do të ketë hendikepe të vazhdueshme që t'u takojë familjeve të shteteve ose të marrë pozicionin e vet sot si në rajon, si në botë, kur dihet se tema e sigurisë, pra nëse i marrim cilat produkte priten prej shteteve, njëri nga produktet shumë i çmuar është vetë siguria. Nëse absorbon në siguri, pra je barrë për botën, nëse ofron siguri, atëherë ke një produkt.

Gjendja jonë e Kosovës ka qenë në atë fazën kur ne kemi mbërritur ta ndihmojmë veten në siguri, por ende jemi importues të sigurisë, në masë të madhe dhe ka qenë një moment i rëndësishëm pas 10 vjetësh të vendosim që më në fund të japim garanci për veten, për sigurinë, po edhe ta ndihmojmë botën, sidomos atyre që u takojmë, pra botës së aleatëve tanë në siguri.

Kuptohet siguria është e lidhur edhe me qeverisjen, kualitetin qeverisës, me shkallën e lartë të korrupsionit, me dobësitë si në gjyqësi, si në sektorë të tjerë të jetës, përfshirë edhe arsimin, e shëndetësinë, se siguri janë.

Mirëpo në plan të parë kanë dalë ato detyra që i dalin Qeverisë ta përmbyllë, pra po e them ashtu, kornizën ose infrastrukturën e sigurisë.

Unë ju falënderoj që nga ne, pra, edhe nga Parlamenti, është dhënë përkrahje e duhur që Kosova ta përmbyllë dhe të ndërmarrë edhe veprimin e mbetur, pra mandatimin e ushtrisë së vet.

Mendoj që kjo është një e arritur si në planin e brendshëm, po mos harroni, është një e arritur edhe në planin e jashtëm, e ka peshën e vet, sidomos besimi i shprehur në Kosovën, jo në njërin nga ne, po në Kosovën për këtë temë nga aleatët kryesorë të sigurisë.

Ka plot veprime qeverisëse që duhet të përmirësohen, që duhet të jenë më të mira, që duhet të jenë më të sakta, për atë çdo herë jemi këtu për kritikë, e pranojmë kritikën se na ndihmon.

Sa i përket Kosovës dhe Serbisë, mendoj se koha e 10-vjetëshit të pavarësisë sonë e deri tash na mëson shumë. Çka na mëson kjo kohë? Na mëson se vetëm përshtatja e Kosovës në agjenda e në procese nuk mjafton, pra nuk jep rezultate në fund. Nëse ne vetëm e vazhdojmë përshtatjen, e vazhdojmë respektimin e çdo tavoline, e çdo agjende, e çdo nikoqiri, do të konsumohemi, do të harxhohemi.

Është e rëndësishme, edhe me kushtin e keqkuptimeve, edhe me kushtin e ballafaqimeve ndoshta jo aq të këndshme që Kosova të vazhdojë të mbesë vetvetja, Kosova në radhë të parë duhet ta shohë veten. Sidomos në marrëdhëniet me Serbinë dhe në dialog, mendoj se si në Kosovë kemi marrë mësim.

Nuk janë shfrytëzuar këto 10 vjet që të demokratizohet Serbia, që të ndryshojë mendimi i opinionit në Serbi, nuk janë shfrytëzuar këto 10 vjet që të përgatitet populli serb i Serbisë me të vërtetën që Kosova është shtet i pavarur, sovran dhe që duhet të njihet nga Serbia.

Ju e shihni, ne jemi të zënë me sfida tona të brendshme, është e kuptueshme kjo po gjithë keni kohë nga pak të shihni çka ndodh te fqinji ynë. Pa një konsolidim të pushtetit aktual në masën më të madhe të mundshme, një konsolidim i instrumenteve të këtij pushteti, ju siguroj që në konsolidimin e atij pushteti e të këtyre zyrtarëve në Serbi edhe ne po e paguajmë një çmim.

Çështja e Kosovës është monedhë për një pjesë të politikës në Serbi të konsolidohet më shumë, ushqimi i nacionalizmi, ushqimi i urrejtjes dhe ajo e shpjegon angazhimin e tyre kundër nesh.

Pra, buron nga brenda, e tha zoti Gorani, se politika e jashtme buron nga brenda, e vërtetë është, pra buron nga ajo që kanë krijuar.

Ne duhet të jemi më të qartë në raport me Serbinë, nuk duhet të fshihemi në qartësinë tonë para aleatëve tanë, para Brukselit. Brukseli është aleati ynë, para kryeqyteteve, para Uashingtonit, pra s'kemi pse të fshihemi në të drejtën tonë, në qëndrimet tona, në atë kush është Kosova.

Është shumë transparente, e kemi shpallur shtet po këtu ku jemi sot, kemi Kushtetutën, kemi terror, kem kufij, jemi vetvetja.

Në kapacitetin veprues që kemi si Kosovë do t'i shfrytëzojmë ato të drejta që i kemi, që ta respektojmë veten dhe nëse ka gatishmëri të na respektojë shteti fqinj, jemi për. Por unë mendoj që masat që janë vendosur në produktet që vinë nga Serbia duhet të jenë të përhershme deri në njohjen, derisa Serbia nuk e njeh Kosovën shtet të pavarur e sovran, nuk duhet të hiqen.

Do të kemi këshilla të mira, do të kemi lutje, do të kemi përkrahje, do të na jepet edhe ndonjë çmim si kundërvlerë për këto masa, por nuk është mirë Kosova më t'i heqë derisa nuk njihet pavarësia e Kosovës.

Pse e them këtë? Jo se e kemi zbuluar ne Amerikën, po ju siguroj që pa një qasje të tillë është e pamundshme të arrihet një marrëveshje ndërkombëtare ligjërisht obliguese e njohjes së ndërsjellë. Nëse nuk e kemi këtë qëndrueshmëri, nëse nuk dimë të qëndrojmë, atëherë ne vetë po heqim dorë nga vetvetja, e pse të na pranojë tjetri, harroni këtë.

Kërkoj prej juve, të nderuar deputetë, që në këtë temë, të këtillë çfarë jemi, të gjitha partitë politike, si ishim për ushtrinë, të qëndroni bashkë.

U tha më herët që dalja nga gjendja e keqe në politikën e jashtme dhe të brendshme është shkuarja e Qeveria. Çdo Qeveri, kjo që është, ajo që vjen, disa tema do t'i ketë në tavolinë, çdo e arritur e sotme nuk është e një qeverie, as produkt i një brezi të njerëzve, por është e arritur e të gjithë neve, do ta kemi aty për qeveritë e tjera. Kështu që ju lus të mos tregojmë lëkundje në disa detyra që janë vërtet interes nacional. Ishte te taksa, jo veç të lavdërohem i të mbulojmë ndonjë defekt në politikën e jashtme me këtë taksën, se nuk është ai qëllim, po te taksa i lus sipërmarrësit tonë të na kuptojnë, nuk e kemi bërë këtë si kundërmasë ndaj sipërmarrësve tonë ose ndaj atyre që ushqejnë mijëra familje, se kanë njerëz në punë, nuk e kemi bërë veç për hatër të produkteve vendore, se nuk është ashtu, e kemi bërë prej zorit. Zori na ka sjellë në këtë pikë ku jemi, mirëpo pa u hequr ky zor, nuk është mirë kurrkush ta keqpërdorë këtë situatë, qoftë t'i rrisë çmimet, qoftë të kujtojë që bëjnë presion mbi Qeverinë me çmime, nuk është ashtu. Pra, të mos e mendojmë kështu, të mos marrin ndonjë këshillë prej vendit fqinj: rritni ju çmimet se Qeveria lëshon pe! Mos ashtu, se nuk është rruga e duhur, i shkaktoni telashe vetes dhe neve, por nuk dilet nga kjo gjendje ashtu. I lus afaristët ta kuptojnë këtë, e di pse po u them, nuk është rruga ajo. Të rrimë bashkë, se do të dalim bashkë.

Kosova e bota, shikoni sa i përket rajonit, e falënderoj Maqedoninë, Malin e Zi, Shqipërinë nuk duhet ta falënderojmë, se ne jemi në ndjenja bashkë e jemi një dhe vërtet duhet të mbesim ashtu, po është mirë t'u shprehim një falënderim këtyre dy vendeve, dy popujve, Maqedonisë dhe Malit të Zi, për një qasje korrekte ndaj nesh. Mund ta vazhdojmë këtë falënderim për shumë popuj të

tjerë, edhe për kroatët, bullgarët, sllovenët, që jemi në rajon, mund t'i lusim edhe të tjerët që të lëvizin për Kosovën në votë. Nuk ka politikë as të painkuadruarve më, është gabim të mendojë dikush që ka politikë të të painkuadruarve, ka shkuar ajo kohë, nuk ka politikë të dy karrigeve, është gabim ajo, në të dy anët, e ka pasur ajo punë në botë, s'ka më ashtu. Ka politikë të përkatësisë, me kënd je, jo për ta marrë me të mirë Amerikën, sot është Dita e falënderimeve, edhe ne i falënderojmë, por ne i takojmë një bote, të cilën e udhëheq Amerika. S'është marre të thuhet, nuk është gabim në planin global, në planin e sigurisë, asaj bote i takojmë. Për fatin tonë të mirë, në këtë botën tonë është edhe Anglia, Gjermania, Franca, Italia, janë plot vende të tjera, po ne i takojmë kësaj bote.

Nëse nuk dimë, po ashtu, të jemi të saktë të pranojmë edhe çmim ndonjëherë, e po dua të dal pak te ajo që ka ndodhur në Interpol, sa herë që ka çmim të botës që i takojmë, nuk mund të ikim. Nesër mund të kërkohet që ushtria jonë të shërbejë jashtë vendit, e djali im ose djali i dikujt këtu të shkojë të luftojë krah për krah me amerikanin, gjermanin, me ushtarin e NATO-s, është çmim për paqen në botë e për lirinë, na takon, duhet ta marrim, s'mund të ikim. Kam dëgjuar mendime që jemi tërhequr gabimisht vitin që shkoi prej kandidaturës, nuk ka qenë gabim, mos u ngutni ashtu, po dëgjoj vlerësime tash se është dështim total kjo që ka ndodhur për Interpolin. Është e vërteta kush jemi dhe në çfarë bote jemi, është pak edhe gjeopolitikë, mos e harroni këtë, kemi mundur të bëjmë më shumë, sigurisht që po, po është edhe gjeopolitikë, edhe në etapat që i kemi para vetes, të nderuar kolegë, duhet ta dimë edhe një gjë. Ndonjëherë kur kryhen punët Kosovë-Serbi, do të jetojmë si fqinjë, si jeton Gjermania e Franca, edhe ata kanë qenë dikur keq, edhe ne jemi të gatshëm, Kosova është e gatshme të falë dhimbjen e të kaluarës, por jo ta harrojë, por nuk jemi të gatshëm të japim kurrë nga ajo që jemi vetvetja dhe s'do të japim. Nuk ka si të japë Kosova, por të njëjtën gjë Kosova mund të jetë ashtu si e kemi Majlinda Kelmendin e si i kemi sportistët e zotë, kishte qenë mirë të jemi kampion në respektimin e të drejtave të komuniteteve.

Pra, nuk ndoshta nuk mundemi në çdo gjë të bëhemi kampion, se jemi vend i vogël, por në respektim të drejtave të komuniteteve, e veçanërisht e kam fjalën për serbët e Kosovës, ia vlen të dalim kampion, ia vlen të jemi të vendosur, jo për shkak të Listës serbe e 10 votave tyre, e ata kolegë deputetë në Parlament, por për shkak të një populli që jeton me ne, të njerëzve dhe të argumenteve historike afatgjate. Edhe te ata ndryshon politika, sot janë ata, nesër mund të jenë të tjerë. Kushdo që i përfaqëson, kushdo që është këtu, mirë është t'i ruajmë, e ruajmë edhe të drejtën tonë pastaj në tërësinë tonë. Unë të gjitha kritikën sot, ose vërejtjet, ose ato që keni për t'i thënë nuk i marr si qëllimkëqija, por i marr si diçka që duhet të na ndihmojnë, edhe mua, edhe Qeverisë, edhe ministrit të Jashtëm, edhe presidentit, sa jemi ne. Kur ndodhin zgjedhjet, kur ka të tjerë, shpresoj që këto të gjeturat e sotme edhe ata i ndihmojnë, e të arriturat e sotme e të nesërme do t'i ndihmojnë të gjithë ata që marrin përgjegjësi pas nesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve individualisht, ashtu siç e kanë kërkuar fjalën, deputeti i parë që ka kërkuar fjalën është Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Po diskutojmë për një temë që reflekton imazh për Kosovën, që thjesht Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta trajtojë si temë të rëndësishme, si temë prioritare, sepse vërtet politika e jashtme e një vendi në trendët bashkëkohorë dhe në zhvillimet integruese që janë kaq të nevojshme për vendin tonë do të thotë shumë. Por, politika e jashtme e një vendi do të respektohet varësisht nga prodhimi i politikave të brendshme që i bën ai vend, nga respektimi i ligjit, nga zhvillimi ekonomik, nga zhvillimi i segmenteve kryesore që një shtet e bëjnë dinjitoz dhe pastaj ajo reflekton te politika e jashtme e një shteti.

Mund të themi me shqetësim që këtë vitin e fundit politika e jashtme e Kosovës nuk ka qenë kreative, efikase dhe nuk ka sjellë rezultatet e pritura për nevojat e popullit dhe shtetit të Kosovës. Në fakt, muajve të fundit ka çakordim total edhe të artikullimit politik të interesit shtetëror të Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, qofshin ato bilaterale me vende të caktuara, apo edhe multilaterale me organizata rajonale dhe ato ndërkombëtare. Ka qenë dhe besoj fuqishëm që është orientim gjeostrategjik i vendit tonë në vijën Prishtinë-Bruksel-Uashington dhe ky orientim nacional nuk do të duhej të guxonim askush nga liderët politikë dhe institucionalë ta devijojë, sepse do të ishte fatal për perspektivën dhe të ardhmen e Kosovës. Frikësohem se ka tendenca të ndryshohet ky orientim politik, strategjik dhe nacional në adresa të tjera, për të cilat jam i bindur që as nuk ekziston vullneti i popullit, po as nuk ka vullnet të mazhorancës politike në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Besoj fuqishëm që vullneti i popullit, por edhe i përfaqësuesve të tyre shumicë në Kosovë është orientimi Prishtinë-Bruksel-Uashington. Çdo orientim tjetër, çdo tendencë që ky orientim të ndryshohet, do të jetë me përmasa të paparashikueshme dhe me dëme enorme për perspektivën e shtetit tonë.

Kemi pasur premtime publike të zyrtarëve institucionalë që janë përgjegjës për politikën e jashtme të Republikës së Kosovës: liberalizim të vizave, anëtarësim në Interpol, anëtarësim në UNESCO, kanë shkuar aq larg sa që e kanë bërë goxha të lehtë edhe fitimin e ulëses së Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Do të doja që këto të ishin të vërteta, por fatkeqësisht realiteti është krejt tjetër. Është normale që një shtet në transicion që po e përmbyll etapën e fundit të shtetndërtimit, të bëjë lobim të caktuar për tema të caktuara, por edhe për çështje të caktuara, si ka qenë ky për Interpolin. Nuk është shumë e madhe 1 milion e 200 mijë euro, mbase do të duhej të ndahej edhe më shumë sikur të kishte një strategji, ekipe profesionale, politike, të cilat do ta kishin objektivin e qartë për lobim për anëtarësim në Interpol. Por fatkeqësisht votimi në Interpol tregon më së miri për imazhin e Republikës së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, në arenën e jashtme dhe, zoti kryeministër, ky do të duhej të ishte një mesazh dhe një mësim për ju si udhëheqës i vendit dhe një përgjigje konkrete për bëmat dhe të pabërat e atyre që udhëheqin me politikën e jashtme. Kjo fiasko diplomatike e ka rrënuar për

tokë imazhin e Republikës së Kosovës dhe frikësohem se do të na duhet kohë, mund, mjete, logjistikë që këtë imazh ta kthejmë në pikën ku ka qenë.

Askush nuk do t'i gëzohej dhe sigurisht se ka pasur tendenca apo edhe deklarata publike që opozita të mos gëzohet për mospranimin në Interpol. Ju lutem, personalisht si qytetar që jetoj në Kosovë dhe planifikoj të jetoj deri në fund të jetës këtu, mospranimi në një organizatë të tillë dhe pothuajse tendenca e dytë dhe dështimi i dytë i shtetit të Kosovës e dëmton shtetin, afirmimin e shtetit të Kosovës dhe e dëmton edhe mekanizimin e sigurisë apo edhe mekanizma të sigurisë kaq të rëndësishëm të Kosovës që të jenë pjesë e një organizate të tillë ndërkombëtare.

Shërbimi diplomatik: fatkeqësisht e kemi politizuar këtë shërbim diplomatik. Ka njerëz joprofesionalë, ka nepotizëm dhe ky shërbim diplomatik i Republikës së Kosovës, e në veçanti në shtete që kanë peshë të madhe politike ndërkombëtare dhe vendimmarrëse, e ka dëmtuar shumë. Unë jam i befasuar me abstenimin e Hungarisë në votën për Interpol, kur vetëm para ca ditësh ishte ministri i Punëve të Jashtme dhe na premtoi diçka tjetër. Pse nuk ka votuar Japonia, si vend me peshë në këtë pjesë të globit dhe shtetet e tjera që kanë vite që e kanë njohur shtetësinë e Republikës së Kosovës. Kjo do të duhej të ishte pyetje për Qeverinë, presidentin, për ministrin e Jashtëm, sepse presidenti dhe ministri i Jashtëm me Kushtetutë janë bartës kryesorë të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.

Është e vërtetë që Serbia nuk do të lërë gur pa lëvizur që ta pengojë forcimin, afirmimin, por edhe bërjen e Republikës së Kosovës shtet funksional. Në këtë kontekst, zoti kryeministër, duhet një rishikim detal i dialogut me Serbinë, duhet një rishikim substancial i agjendës dialoguese dhe partneritetit me Brukselin. Ne nuk jemi të barabartë me Serbinë në bisedimet në Bruksel, ende në Kushtetutën e tyre Republika e Kosovës figuron si pjesë e atij shteti, ky është agresion kushtetues. Ende bëjnë barriera edhe në mekanizmat rajonalë dhe ata ndërkombëtarë, madje-madje patëm pranuar edhe njëfarë fusnote. Është momenti i fundit që klasa politike e Kosovës, ky Parlament, Qeveria të gjithë krerët institucionalë dhe politikë të reflektojnë dhe t'i vënë një pikë të madhe kësaj pa barabarësie në dialogun Kosovë-Serbi dhe është koha e fundit për një rishikim strategjik për partneritet me Brukselin që Kosova në të gjitha agjendat e dialogut, për të gjitha çështjet e dialogut me Serbinë të jetë si shtet i barabartë dhe të ulët në dialog sikur Serbia, si Republikë e Serbisë dhe si Republikë e Kosovës.

Masat e marra nga ana e Qeverisë ditëve të fundit i mbështes, sepse Kosova duhet të tregojë seriozitet, qëndrueshmëri dhe duhet ta mbrojë interesin e vet shtetëror dhe nacional. Prandaj, ky debat në Kuvendin e Republikës së Kosovës le të jetë si mesazh edhe konsensusi, unifikimi, por edhe reflektimi i institucioneve në raport me Serbinë dhe në raport me ecjen tutje të forcimit dhe të afirmimit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: I nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

U drejtohem për herë të parë dhe qytetarëve të Kosovës, sepse edhe të tjera herë i jam drejtuar, po kësaj here në mënyrë të veçantë.

Jemi mbledhur sot për të debatuar, realisht për ta vlerësuar punën e Ministrisë së Jashtme të Kosovës pas dështimeve dhe mospranimit në Interpol, sepse dështuam në vlerësimin e rezultateve për këtë takim. Në këtë takim shkuam, siç thonë, “me duar në xhepa”, sepse besonim, ishim të sigurt pa e vlerësuar mirë se do të pranohejmë. Dështuam për 1 mijë arsye dhe për shumë faktorë, por ne si parlamentarë a jemi fajtorë? U tha Serbia është fajtorë, po ajo, të drejtën t’ju them, e bëri punën mirë, sepse ashtu e kishte paracaktuar për vetveten, fajtorë për neve që s’kishim punuar sa duhet, ku ishim ne? Nga një përvojë imja e rastit gjatë pranimit të Kosovës në Asamblenë Frankofone në Kanada, t’ju them dhe delegacioni i Kosovës përbëhej vetëm nga unë dhe jo në rolin e deputetes, ndodhej zonja Tefta Kelmendi, diplomate në ambasadën tonë në Paris. Aty mungonte delegacioni i Shqipërisë, i Maqedonisë, Ambasadori i Kosovës në Kanada, sepse ishte në pushimin vjetor, ani pse kjo mbledhje, kjo Asamble i paracakton një vit përpara takimet dhe kjo nuk ishte në rregull, sepse ambasadori mund të vinte. Delegacioni i Serbisë përbëhej nga pesë ose gjashtë deputetë. Më te ishte edhe ambasadori i Serbisë në Kanada dhe shumë e shumë asistentë që bënin propagandë me secilin delegacion, natyrisht bënim edhe ne, por ne ishim pak, vetëm një.

Ne u pranuan, për fat, por nuk ishte e lehtë, nëse dikush mendon se ka qenë lehtë. Në takim e radhës të Asamblesë Frankofone, që ishte më shumë festive, ishte prezentë edhe presidenti, edhe zëvendëskryeministri, ministri i Punëve të Jashtme edhe shumë e shumë të tjerë. A kemi me të vërtetë ne diplomaci dhe diplomatë në ambasadat tona, me të cilat është fuqia dhe njohja diplomatike. Kjo që ndodhi jo vetëm me Interpolin, por edhe me pranimin, atmosferën, përfshirjen e pranimeve, me UNESCO-n duhet të na brengosë kur çdo ditë thirrremi për bisedime dhe rregullimin e marrëdhënieve me Serbinë. Kjo situatë lë përshtypje të ngecjes, të mosdijes, mosaftësisë diplomatike, kaluan gati 20 vjet nga përfundimi i luftës që disa i thonë ‘konflikt’, 10 vjet jemi shtet i pavarur dhe sovran, por prapë kemi luftë të pashpallur nga Serbia, luftë speciale që Serbia i ka shpallur dhe kjo është një luftë e llojit të vet.

Edhe pse ajo në bazë të marrëveshjeve të Brukselit obligohet të mos i pengojë Kosovës të ecë tutje, dikush nga Brukseli nuk i dha shkop për këtë që ajo vepron, domethënë e shkel marrëveshjen. Për këtë jam e sigurt. Për Serbinë janë siguruar gjithnjë karotat dhe asnjëherë shkopi. Kjo politikë e bashkësisë ndërkombëtare u ndoq edhe nga UNMIK-u me përfaqësitë e tij për Kosovën, por edhe me shumë mangësi dhe punë të pakryera që lanë pasojë shumë të rënda dhe plagë kronike që nuk po shërohet.

Formimi i komunave njënacionale nga enklavat serbe në Kosovë, në multietnike, ku minoritetet kanë të drejta si në asnjë vend në Bashkimin Evropian, kjo nuk është zgjidhje demokratike dhe e kuptueshme që të kemi komuna njënacionale, është një politike dhe projekt i sprovuar, i kërkuar nga Serbia. Kjo reflektoi edhe në Planin Ahtisari gjithashtu, për të cilin ne e paguam çmimin e lartë të pavarësisë, duke lejuar që të bëhet gabimi i dytë i madh dhe i paparë ndonjëherë që kishat të quhen serbe. Pse ka mbetur kjo histori e sajuar para 100 vjetësh më parë ose më shumë, u dhamë edhe ekstra-territore, se mos e kanë këtë pozitë që e kanë kishat ortodokse në Kosovë, vetë kishat ortodokse në Serbi duhet ta mendonin se nuk mund t'i jepnin dikujt më shumë sesa e kanë në vendin e vet autokton, pra në Serbi. Pse ta ketë këtë të drejtë në Kosovë? Dikush thotë në emër të trashëgimisë historike. Këtë mund ta besojnë vetëm analfabetët e historisë, analfabetët e diplomacisë. Ata që heshtën duhet thënë zëshëm, nuk u lejuan të flasin, as nuk patën mundësi të flasin, jo se nuk patën çka të flasin se ky është një diskriminim, diskriminim ndaj popullit tim, ndaj historisë sonë të lashtë, ndaj historisë sonë autoktone.

Është shkopi që Evropa gjithnjë ia dha Kosovës dhe shqiptarëve, por fabula e mësuar nga luani dhe miu si duket nuk është mësuar mirë. Luani nuk u frikësua nga miu kur kaloi nëpër mustaqet e tij, por tha “e mëson rrugën”. Serbia e mësoi rrugën, ajo tani e bën atë që e ka bërë para një shekulli dhe më shumë, nga një shtet vrashtar që shkaktoi luftërat e Ballkanit, një shtet ekspansionist që shkaktoi tokën e djegur, gjenocidin dhe nuk u ndëshkua që ta mësojë leksionin në emër të të drejtës humanitare dhe të popujve, ajo tani në rolin e shtetit histerik, shtetit viktimë, e ne viktima mbetemi të shastisur e të nemitur. Këtu dështuam.

Profesoresha ime e gjuhës shqipe quhej Liri. Ishte ortodokse. Ajo sa ishte gjallë shkonte në kishat ortodokse dhe tani do të duhej t'i thoshim të shkonte në kishat serbe ortodokse. Tempujt fetarë janë tempuj të Zotit dhe jo të të tjerëve. Tani të kujt pra janë xhamitë, ato na i solli dikush tjetër, pra nuk qenkan tonat. Le t'u kthehemi shenjave tona pagane, pse lejuam, nga mosdija, nga paaftësia jonë që të dështojmë?

Çka ndodhi me Gjykatën Speciale? Jo se deputetët ishin kundër dënimit të kriminelëve brenda nesh, por pse nuk u dërguan në Hagë nëse ishin kriminelë? Pse nuk u themelua një gjykatë e tillë çfarë e ka edhe Serbia, për kriminelët e luftës, nga UNMIK-u, i cili këtë punë e bënte, këtë punë e kishte detyrë dhe e kishte gjyqësorin, e jo të ngrihej e ta ngrinte gjykatën në bazë të të padhënave dhe nga kriminelët, pra të bazuara në të dhënat e kriminelit, e jo të viktimës? Këto u bënë vetëm që të baraspeshohen viktima me krimin.

Faji për politikën dhe politikën e jashtme të Kosovës e kemi ne të gjithë pa përjashtim, dhe të mos e copëtojmë fajin që të bëhet më i vogël. Si mund të funksionojë Ministria e Jashtme më mirë kur edhe politikën, edhe diplomacinë ne e shndërruam në pazar tezgash - “Sa ma shet votën për një post ambasadori?” Ne e bëmë, jo ju s'e bëtë, unë-ty e ti-mua, unë këtu dështova, por dua

një post më të mirë, sepse e bëj më mirë. Këto ishin pazaret, parti interesash e ambiciesh shkatërrimtare, pa një dashuri për atdheun.

Atdheu nuk kërkon fjalomani, as rënie-ngritje qeverish për çdo natë e çdo ditë deri në monotoni, sa që edhe qytetari i thjeshtë thotë “aman na qan kokën, çdo natë e çdo ditë bini dhe ngriheni”. Kemi kohë për të tilla gjëra, të tjerët po punojnë, po ecin e ne po zihemi, po e shpëllajmë trurin tonë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kolege dhe kolegë deputetë,

Unë mendoj që në vargun e skandaleve të cilat ne sot jemi thirrur t’i diskutojmë, t’i debatojmë dhe ta votojmë rezolutën në përputhje me këto diskutime është edhe vetë mosprania e ministrit të Jashtëm sot këtu në Kuvendin e Kosovës. Pra, ky është skandali i radhës, sepse njëkohësisht ky duket edhe injorim ndaj Parlamentit, por duket edhe një manifestim në mënyrë protestuese i papërgjegjësish së tij. Nuk është e vërtetë se nuk ka kohë të jetë sot këtu, nuk është e vërtetë që është diku në ndonjë agjendë më të rëndësishme se këtu, sepse në fakt fiks një javë ditë kishte kohë të priste në Dubai për ta dhënë një intervistë në fundin e konferencës e Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit. Pra, atje kishte kohë një javë të priste, këtu s’paska pasur kohë të vijë. Ky është edhe një demonstrim në mënyrë arrogante i papërgjegjësish së tij.

Kryeministri shkoi, shpresoj të ketë shkuar ta marrë ndonjë vendim të duhur, e vendimi më i duhur tash do të duhej të ishte shkarkimi i menjëhershëm i këtij ministri. Shpresoj të jetë kështu, prandaj do ta mirëpresim një gjë të tillë.

Por, siç edhe u tha këtu, një nga skandalet është edhe sjellja krejt sharlatane e Ministrisë së Punëve të Jashtme edhe në raport me integrimin ose anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Kosova nuk ia arriti të anëtarësohet në Interpol, jo për shkak që mungoi angazhimi i grupit punues, i atyre oficerëve të Policisë, i atyre ekspertëve, por për shkak se ai mekanizëm, i cili do të duhej të ishte në veprim tash, nuk funksionoi dhe në shumë raste ishte edhe pengesë për këtë grup punues. Prandaj, sot Qeveria e Kosovës nuk di kur ndonjëherë tjetër, përveç sot, do të ishte mundësia më e mirë që ta demonstronte edhe një herë që shkarkimi do të ishte veprimi më i menjëhershëm dhe më i pakti i ministrit të Jashtëm.

Në fakt, nëse Qeveria dhe kryeministri i Kosovës po harxhojnë energji tash, më shumë po harxhojnë energji në menaxhimin e skandaleve sesa në punë të tjera, të cilat do të duhej t’i bënte. Por, nëse flasim për shkarkime ministrash, shkarkimi i ministrave ka ndodhur. Ja për shembull,

ministri i Brendshëm është shkarkuar, është emëruar, është shkarkuar, është emëruar, sa Ministria e Brendshme është kthyer në një pistë aeroplanësh që zbresin dhe ngrihen, dhe pse nuk e bën një gjë të tillë edhe për ministrin e Jashtëm? Pra, nuk e bëjnë një gjë të tillë për ministrin e jashtëm, sepse në ditët në vijim do ta shohim se pse ministri i Jashtëm nuk shkarkohet ende.

Unë bashkë me grupin punues sapo jemi kthyer pra nga Asambleja e Përgjithshme e Interpolit dhe normalisht që s'kemi ardhur me lajme të mira, s'kemi ardhur me atë që e kemi pritur të gjithë, megjithëse duhet ta falënderoj edhe një herë grupin punues për një qasje të mirë që ka pasur nga dita e parë që ka filluar ta bëjnë një gjë të tillë. Por, ajo çfarë ka qenë e evidente në vazhdimësi është një qasje e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në këtë rast e Qeverisë, për shkak se ministri i Punëve të Jashtme është edhe zëvendëskryeministër dhe po ashtu një qasje çfarë e kanë pasur ministri i Punëve të Jashtme dhe Presidenti, sidomos gjatë javës së fundit, në zhvillimet rreth Asamblesë së Përgjithshme, është tepër zhgënjyese. Po kaq zhgënjyese është edhe vetë rezultati, sepse rezultati nuk ishte thjesht një numërim votash, rezultati ishte një diagnostikim se ku është pozita apo pozicioni i Kosovës sot në arenën ndërkombëtare. Dhe, ky diagnostikim la të kuptojë edhe një herë se Kosova është në një gjendje shumë të rëndë, jo vetëm në fushën e integritit, por në një gjendje shumë të rëndë edhe në arenën ndërkombëtare. Paramendojeni, janë 18 vende anëtare, në fakt njohëse, 18 vende njohëse që nuk ia dhanë votën për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Çfarë do të thotë kjo për diplomacinë, çka do të thotë kjo për Qeverinë, çfarë do të thotë kjo për ministrin e Jashtëm, çfarë do të thotë kjo për Presidentin? 18 vende nuk i thanë “po” anëtarësimit të Kosovës në Interpol!

Qasja e Ministrisë së Punëve të Jashtme ka bërë që Kosova në vend se ta vazhdojë rrugën e integritit tashmë është e dukshme që ka pësuar kthimin e dezintegritit. Paramendojeni, kush nuk e voton Kosovën në Interpol? U pa që nuk e voton Hungaria, Japonia (këto janë vende njohëse), Koreja e Jugut... Por, nuk e votoi as vendi mikpritës, Emiratet e Bashkuara Arabe. A nuk do të duhej të ishte ky një moment reflektimi që ne ta shohim Kosovën ku e kemi degjeneruar, jo ku e kemi integruar?

Unë nuk di çka duhet të presë pra Qeveria edhe në ditët në vijim, përveçse të marrë veprime të duhura. Kosova nuk e meriton as të udhëhiqet nga një Qeveri e tillë, e aq më tepër nga një ministër i tillë, që tashmë e ka bërë mishmash krejt diplomacinë e Kosovës, atë diplomaci të brishtë që ka qenë.

Kur bëhet fjalë për shkarkimin e ministrit, pse e kërkoj unë shkarkimin e tij sot? Për shkak se përveçse duhet shkarkuar ministri sot, Qeveria do të duhej të jepte dorëheqje si pasojë e të gjitha këtyre skandaleve. Po pse e kërkoj sot shkarkimin e ministrit, sepse ne nuk duhet të shkojmë në zgjedhje me ministër të tillë në detyrë. Pra, ky ministër jo që nuk duhet të jetë ministër, por as nuk duhet të jetë ministër në detyrë.

Tekefundit, nëse bëhet fjalë për trima e trimëresha, atëherë nuk do të duhej që as të kishim frikë nga zgjedhjet. Pra, kush ka besim në vetvete, nuk do të duhej të kishte frikë nga zgjedhjet.

Thaçi edhe Pacolli në fakt u mërzitën shumë pse Kosova dështoi në anëtarësimin në Interpol. Po jua them nga vendi i ngjarjes. Ata u mërzitën pse u humbi një mundësi për të dalë para gazetarëve të shumtë që i thirrën në Dubai. Fiks sot një javë kanë shkuar atje dhe kanë pritur që ta japin këtë konferencë dhe më shumë u mërzitën pse dështoi konferenca sesa pse dështoi Kosova në Interpol. Madje, të jeni të sigurt që Presidenti i vendit këtë do ta shfrytëzojë në të ardhmen, jo për të marrë mësim, por për ta shfrytëzuar si presion ndaj nesh, që ne nuk mund të integrohemi nëse nuk lëshojmë pe ndaj Serbisë. Do të jeni dëshmitarë që Presidenti do ta shfrytëzojë këtë, madje në raste të tilla, qoftë në postimet e tij, qoftë edhe në qasjen e tij, nuk e fshih as entuziazmin pse Kosova nuk u anëtarësua në Interpol.

Nuk dua të përdor analogji të tilla, por vetë mosprania e ministrit sot këtu, duke dhënë në një letër të tij një lloj arsyesimi që ai është jashtë, për detyrat e jashtme, e jo të punëve të jashtme, atëherë e bën atë që të jetë një ministër i jashtëm i punëve të jashtme. Ju kujtohet kjo batutë prej nga vjen.

Prandaj, dorëheqja e Qeverisë do të ishte zgjidhje e duhur në këtë kohë kur menaxhimi i saj, në këto kur kjo Qeveri nuk po mund t'i menaxhojë as skandalet, e lëre më Kosovën. Dorëheqja e tyre do t'i nderonte edhe këta, dorëheqja e tyre do ta shpëtonte Kosovën, prandaj zgjedhjet janë zgjidhja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolege deputete,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ky debat për dështimin në politikat e jashtme nuk është e vërtetë që e ka qëlluar vërtet temën, por çështja për të cilën është thirrur kjo mbledhje e Kuvendit të Kosovës krijon gjithë hapësirën e nevojshme për të diskutuar për temën kryesore me të cilën po ballafaqohet Kosova në politikën e jashtme dhe kjo është tema e bisedimeve dhe e raporteve me Serbinë.

Unë e përgëzoj Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe partinë e zotit Kurti për elegancën që kanë zgjedhur që nëpërmjet këtij debati ta përfundojmë bojkotin e Kuvendit dhe të diskutojnë sot këtu dhe në këtë sallë hapur për dështimet e politikës së jashtme, edhe pse nuk është plotësuar kushti kryesor për të marrë pjesë në Kuvend. Pra, mirë se keni ardhur, faleminderit që e keni përfunduar këtë debat dhe mendoj që është shumë mirë që tash e keni një politikë konstruktive. Nuk di pse

po shqetësoheni. Unë po ju dëshiroj mirëseardhje dhe kjo është jashtëzakonisht e mirë për t'iu kthyer realitetit.

Sot, në shekullin XXI, vetëm ekstremistët nuk duan të bisedojnë. Unë shpresoj dhe uroj që Kuvendi i Kosovës duhet t'i kthehet punës normale dhe të bisedoj gjithashtu normal, krejt normalisht, edhe deputetët me njëri-tjetrin.

Ajo çfarë po ndodh sot në Kosovë është se e kemi një front të hapur me Serbinë, një front diplomatik, një front që kap politikën e jashtme, sportin, kulturën, Kombet e Bashkuara, Kartonin e Gjellbër, përzierjen e Serbisë në punë të brendshme të Kosovës, e një varg temash të fundit, e sidomos njohjen reciproke.

Ne kemi mjaft arsye për të diskutuar me Serbinë. Kemi mjaft tema siç janë dëmet e luftës, pensionet e vjedhura, fati i të pagjeturve, dëmshpërblimi për 20 mijë gra të dhunuara, ndarja e trashëgimisë nga ish-Jugosllavia, depozitat e shtetasve të Kosovës në bankat e ish-Jugosllavisë, pasuria e Kosovës në Serbi, e tema të tjera. Pra, duhet të bisedojmë, sepse nga këto bisedime varen drejtpërdrejt interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Duhet të bisedojmë me njëri-tjetrin dhe duhet së bashku të përcaktojmë se çfarë duam në këto bisedime dhe cilat janë interesat dhe kërkesat e Republikës së Kosovës.

Ajo që unë deri më sot kam parë është mungesa minimale e vullnetit të aktorëve kryesorë për të gjetur një zgjidhje, e cila nuk është e vështirë, por në mungesë të vullnetit politik del e paarritshme. Jam i vetëdijshëm që ka pasur shumë zëra kundër përfshirjes së presidentit Thaçi në këto bisedime, edhe më shumë zëra për të diskutuar çështjen e kufijve. Në këtë çështje, unë nuk po flas në emër të Partisë Socialdemokrate, por sinqerisht kam menduar që kur të hapet çështja e kufijve do të duhej që Lëvizja Vetëvendosje të ishte e para ajo që e kundërshton Planin e Ahtisarit dhe kufijtë e Ahtisarit dhe angazhohet që të bisedohet për kufijtë, pra edhe për temën kryesore për bashkimin me Shqipërinë. Por jo, ndodhi e kundërta, këta duan ta ruajnë Ahtisarin, të cilin e kanë kundërshtuar për vite me radhë.

Presidenti i Kosovës në karrierën e tij politike ka bërë shumë gabime, ka nënshkruar edhe marrëveshje të dëmshme, është treguar person jounifikues, e dimë të gjithë dhe mendoj se shumica pajtohem në këtë çështje, por ajo që megjithatë duhet theksuar është që presidenti Thaçi është president i LDK-së, edhe president i PDK-së. Prandaj, nuk po habitem nga Lëvizja Vetëvendosje që e kritikon, por po habitem nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Bile, disa deputetë të LDK-së nuk hynë fare në listë për shkak se nuk e votuan Hashim Thaçin. Kjo është e vërteta. Është mirë që këtë farë teatri të kukullave, silleni si kukulla, thoni që jeni kukulla dhe pastaj do të jemi në rregull, por jo kështu. Nuk bëhet politika kështu. Megjithatë, ky panik kundër presidentit Thaçi, nëse nuk është artificial, e unë besoj që është artificial, sepse është jashtë çdo logjike normale kur dihet që nuk është presidenti ai i cili nuk mund të nënshkruajë

marrëveshje ndërkombëtare, presidenti mund të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare, por është Kuvendi ai i cili ia miraton apo nuk ia miraton marrëveshjet ndërkombëtare. Është pikërisht ky Kuvend që ia ka miratuar marrëveshjet Thaçit. Pra, nëse ka rrezik, nëse duhet të kemi frikë, duhet të kemi frikë nga Kuvendi, por jo nga Presidenti.

Presidentin e njohim dhe e dimë, e keni zgjedhur ju, Albulena, e ju zonja e tjera pritni deri sa ta përfundoj unë.

Marrëveshjet ndërkombëtare mund të firmosen mund të kalojnë vetëm nëse 80% deputetë të Kuvendit të Kosovës i votojnë. Pra, nëse i votoni ju ato kalojnë, por nëse nuk i votoni, nuk kalojnë. Çka është ky panik? Çka është ky mashtrim dhe kjo demagogji kaq e madhe e një Kuvendi të tërë, i cili mashtron publikisht?

Ne e njohim Thaçin, kemi qëndrimin ndaj Thaçit. Nuk dallojmë në mendimin për Thaçin, ama dallojmë në mashtrimin e madh; Thaçi s'mund ta kalojë asnjë marrëveshje, në qoftë se ju nuk e nënshkruani. Pra, nëse duhet të kemi frikë, duhet të kemi nga ju frikë, e jo nga dikush tjetër.

Qasja e përgjithshme në raport me bisedimet me Serbinë është një qasje qyqare. Përfaqësuesve të një shoqërie të mbetur prapa, që i mungon edhe aftësia minimale për t'u ulur bashkë për të diskutuar bashkë dhe për të përcaktuar bashkë çka dëshirojmë. Çfarë dëshirojmë ne? Opozita, ku është opozita? Çfarë opozita kundër Thaçit? Hajt, po e dimë që Qeveria nuk po bënë. Po mirë, ne si opozitë që po mendojmë ndryshe, pse ne nuk jemi bashkë? Pse nuk u ulëm asnjëherë bashkërisht e t'i përcaktojmë vijat dhe të themi "jo, këto vijat e kuqe". Jo, nuk doni!

Dhe, në fund të fundit, edhe këtë duhet ta them; ju vërtet, kolegë e kolege të nderuara, e bëtë njëfarë bojkoti që nuk është as çerek bojkoti. Në mbledhjet e komisioneve jeni të gjithë të pranishëm. Në udhëtimet jashtë vendit jeni të gjithë pranishëm. Në udhëtimet të cilat kanë të bëjnë me lobimin për çështjen e vizave, jeni të gjithë bashkë.

Ku e keni bojkotin? Pse keni ardhur sot? Që t'i merrni nënshkrimet për mëditje, apo ku qëndron problemi? Edhe, në fund të fundit, edhe sa i përket kësaj çështjes tjetër, çështjes e cila ka të bëjë me çështjen e Interpolit, në fakt unë nuk e kam ditur, e kuptova tani nga Rexhep Selimi. Pra, opozita paska qenë e përfaqësuar edhe në këtë çështje. Atëherë dështimi për çështjen e Interpolit po i takuaka edhe opozitës.

Pse s'po shtrohet pyetja çfarë bëmë ne këtë çështje? Çka bëmë ne për çështjen e Interpolit? Pse nuk po e shtrojmë pyetjen kur po shkojmë në udhëtime për të lobuar për vizat, pse edhe ne si opozitë nuk po themi se edhe ne kemi përgjegjësi, sepse kemi dërguar njerëz të gabuar ndoshta.

Ndoshta s'ë kemi bërë punën tonë mirë. Pse këto pyetje nuk po i shtrojmë kurrë? Thjesht, po më vjen të vjell nga kjo politikë, e cila, përveç akuzave nuk di asgjë tjetër. Nuk ka asgjë konstruktive, as te pozita, as te opozita sa u përket çështjeve të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e shtetit, me zhvillimin e vendit.

Thjesht, nganjëherë po më vjen turp që jam deputet i Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi. Donika e ka fjalën, ju lutem kolegë që ta ndjekim.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Mendoj se nga dje, për herë të parë në politikën e jashtme Kosova nuk ka kompleks inferioriteti. Pra, vendimi i djeshëm për të cilin nuk po shoh që po deklarohen deputetët e këtij Kuvendi, është vendimi i cili është dashur të merret shumë vite më herët, por nuk ka pasur nga kush.

Dje, për herë të parë, pas veprimeve të Serbisë edhe në rastin e Interpolit dhe fitores së tyre të Pirros, Serbia e mori përgjigjen e duhur.

Ky veprim në politikën e jashtme, pra ky instrument, taksë prej 100% do duhej ta kishte përkrahjen e politikës së brendshme. Në rend të parë, ky Kuvend sot do të duhej të dilte me një rekomandim kyç, të cilin do ta propozoj.

Pra, Kuvendi i Republikës së Kosovës ta përkrahë fuqishëm vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për taksën 100% ndaj Serbisë.

Besoj që këtu pajtohemi të gjithë dhe besoj se kjo është një temë, por dua të besoj edhe pse nuk u tha, prita deri tani, nuk e mora fjalën. Prita, sepse kjo çështje është proklamuar si kauzë e plotëve, po sot nuk po shoh që të paktën as nuk po përshëndetet si veprim. Nuk e di as çfarë qëndrimi zyrtar kanë. T'i dëgjojmë deputetët nëse e përkrahin taksën, apo nuk e përkrahin taksën.

Mendoj se aty ku duhet të jemi bashkë, është përballja me Serbinë. Dhe, kjo nuk po tregohet sot në Kuvendin e kësaj republike.

Sot të gjithë po flasim për pushtet, ndërkaq nuk dëgjoja që dikush foli për shtet. Prandaj, në këtë moment ku jemi, e që për herë të parë Kosovës po i vjen era shtet pas vendimeve të marra, pra pas Ligjit për ushtrinë, të cilin e kemi kaluar në lexim të parë, e sot kur dikush me insistim që e njeh këtë fushë edhe është në komision, po kërkon zgjedhje, po më çudit, se e di që shkuarja në zgjedhje në këtë moment e kthen Ligjin për ushtrinë në pikëm zero. Dhe, nëse dikush e ka këtë kërkesë le ta thotë, mos u frikësoni, po thojeni shqip, sepse po merret vesh çka po doni.

Nëse jeni kundër ushtrisë, nëse jeni kundër taksës, atëherë po e vazhdojmë këtë debat deri në mbrëmje. Rezolutën të cilën na e dorëzuat, e pashë dhe e lexova. Edhe po thotë: e konteston shtetësinë, e cenon subjektivitetin.

Unë ju pyes, masat e fundit, veprimi dhe vendimi i djeshëm i kryeministrit, a e tregojnë të kundërtën? Pra, edhe e ritheksojnë shtetësinë, edhe e tregojnë subjektivitetin e lartë të cilin e ka treguar Kosova për herë të parë në dy dekadat e fundit në raport me Serbinë.

Prandaj, kjo përpjeke që sot të tërheqim vëmendjen, atëherë kur kemi nevojë të jemi bashkë, kur kemi nevojë të përballemi me Serbinë, e cila sigurisht që do të vazhdojë me agresivitet të lartë betejën e saj diplomatike kundër vendimit të marrë dje, ne flasim për çështje krejt jorelevante.

Interpoli po, është i rëndësisë së veçantë, edhe anëtarësimi i Kosovës në Interpol, por po harrojmë se ka dështuar dy herë më parë, jo në këtë Qeveri, po dy herë më parë, atëherë kur dinamikat e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë qenë shumë më në favor ndaj Republikës së Kosovës sesa që janë sot.

Pra, sot jemi në një rrethanë të re. Kur po shihet që dinamikat e marrëdhënieve ndërkombëtare nuk janë aq në favor tonin sa kanë qenë më herët dhe kur më shumë se kurrë kemi nevojë që të jemi unik në temat që lidhen me politikën e jashtme e sidomos në dy çështjet të cilat janë në zhvillim e sipër. Pra, sot ky Kuvend ka nevojë të deklarohet për taksën dhe unë thërras edhe një herë që ta nxjerrim rekomandim kyç i cili do të bëjë që Kuvendi i Kosovës e përkrah fuqishëm vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për taksën 100% ndaj Serbisë, nëse e keni përnjëmend.

Dhe, e dyta, që Kuvendi i Republikës së Kosovës të kërkojë ndërprerjen e dialogut derisa Serbia të reflektojë duke e ndalë ofensivën e saj ndaj Kosovës. Sepse, siç e thashë, nëse ka një pikë që duhet të na bëjë bashkë, është ballafaqimi me Serbinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Po e vazhdoj aty ku e la deputeti Faton Topalli, edhe Rexha. Rexhë, ta përsëris fjalimin, pajtohem plotësisht me fjalimin tënd, që ka qenë një ekskursion në Dubaj, temperatura e mirë edhe asgjë më shumë. Kurrëgjë më shumë.

Vetë fakti që i kanë marrë 20 gazetarë me vete, dhe vetë fakti që s'ka një diplomat, një politikan në botë që del pa u votuar rezoluta, thotë që ne do të anëtarësohemi. Një diplomat thotë “mund të anëtarësohemi, ka gjasa për anëtarësim”, por jo “do të anëtarësohemi”, se në momentin që thua “do të anëtarësohemi” dhe nuk anëtarësohesh, atëherë duhet të japësh dorëheqje.

Por, Faton Topalli e pati fjalimin dhe unë po e citoj një kanadez. Një profesor kanadez, i cili mua dhe nuses sime na e ka dhënë një këshillë para pesë vjetëve shumë të mirë. Tha “me ju ballkanasit është një problem shumë, shumë, shumë i madh. Ju këshillën dhe kritikën i merrni si sulm. Jo si këshillë, jo si kritikë, por në momentin që dikush e thotë një mendim ndryshe, ti e merr që mua po më sulmon”. Prandaj, ndodh edhe ky debat që ne në të shumtën e rasteve këtu mendojmë që po e sulmojmë njëri-tjetrin dhe çohemi edhe fyejmë njëri-tjetrin për shkak të këtij mentaliteti komunist, e para.

E dyta, sa i përket diplomacisë, unë mendoj që mjafton ta citoj ambasadorën të shkëlqyeshme, që është e rrallë, Vlora Çitaku. Në qoftë se e citoni Vlora Çitakun, e cila tha: “Diplomacia jonë ka dështuar”, ne duhet të heshtim natën kur djelmohat tonë fituan kundër Azerbajxhanit”. Prandaj, vetë fakti që ajo e ka thënë, që është diplomatja më e mirë që e kemi jashtë, tregon se në çfarë gjendje është diplomacia e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Hajde e marrim një sitë dhe e bëjmë një analizë. E bëjmë një hetim. Qysh kanë shkuar njerëzit në diplomacinë tonë jashtë? Kush i ka dërguar dajat e tezet e djemtë e mixhës e njerëzit pa kurrfarë eksperience, pa njohje të gjuhëve, nëpër diplomaci. Merreni bëjeni një rëntgen dhe thirrini në interpelancë ish-ministrat e kaluar; edhe Enver Hoxhajn, edhe Skënder Hysenin, edhe të gjithë me radhë dhe pyetini sa familjarë të tyre i kanë dërguar në diplomaci të jashtme.

A ka ndonjë njeri normal në këtë vend, i cili nuk e pranon se kemi me mijëra djem dhe vajza që kanë mbaruar akademitë në vendet e huaja dhe nuk i kemi nëpër ambasadat tona. Pse ka ndodhur kjo? Pse pasi ne qenkemi kaq të zotët, pse të vijnë djelmohat tonë nga Diaspora e të luajnë futboll për Kosovën? Eja po luajmë vetë.

Gjyma e deputetëve po hyjmë në fushë dhe po luajmë futboll.

Të njëjtën gjë e ka bërë diplomacia jonë, krimin më të madh. Sikur po e bënë me atë dëgjimin publik nëpër Diasporë ministri i Diasporës dhe disa kolegë të mi deputetë, të cilët shkojnë vetëm për shopping, sepse nuk ke në botë; as Kroacinë, as Slloveninë, as Bosnjën, e as Malin e Zi që shkojnë në dëgjime publike, i mbledhin 10 mërgimtarë atje, hanë biftek, harxhojnë para të taksapaguesve dhe vijnë këtu e na tregojnë pallavra e përralla të Nasradinit.

Kjo është diplomacia jonë. Ky është Parlamenti ynë, që keni darka prej deputetëve të Parlamentit të Kosovës deri në 9 800 euro për një darkë. Keni darka e dreka deri në 4 500 euro nga deputetë, kolegë të mi këtu. Me emra le të flasë Sekretari, pse të flas unë, pastaj ta ha unë. Fol me emra, armiqësohu me ty. Fol me emra, armiqësohu me Ganimeten. Po mirë, de! E po fol me emra, pastaj kur po shkoj te shtëpia njëqind të shara gruaja ime; po thotë “pse more po flet ti me emra”. A veç një budalla e gjetët me emra...

Po, ti ke qenë në dëgjim publik. A ke qenë jashtë? Po, jo replikë se nuk ta përmenda emrin. Hiç s'ka replikë. Hiç! Nuk ta përmenda emrin. Ti ke qenë në dëgjim publik. 200 000 euro i keni harxhuar ju deputetët e Kosovës. 200 000 euro udhëtime për 6 muaj. Marre duhet t'ju vijë. Marre duhet t'ju vijë! Marre duhet t'ju vijë në varfëri, kur fëmijët e Kosovës flenë në çimento. Kur fëmijët e Kosovës nuk kanë ngrohje. Kur fëmijët e Kosovës rrinë 22 veta në një çerdhe. Marre duhet t'ju vijë të harxhoni para të taksapaguesve. Marre duhet t'i vijë Qeverisë që t'i lëshojë zëvendësministrat të shkojnë si baloshë me ftesa të shoqatave kulturo-artistike e të harxhojnë mijëra e mijëra euro nëpër Evropë.

Çka kërkojnë këshilltarët e ministrave që shkojnë në Amerikë e nëpër Evropë? Çka ka kërkuar delegacioni i Qeverisë 20-30 veta të shkojnë në Nju-Jork? Çka ka kërkuar i gjithë ai delegacion të shkojë në Dubaj? Ejani më tregoni pse? Ku është rezultati?

Çka kërkojnë këshilltarët...? Kryetari i Parlamentit sa herë udhëton jashtë i merr me vete rreth 10-12 këshilltarë. Çka kanë kërkuar grupet parlamentare të Parlamentit të Kosovës që të marrin vetura me qira? Çka kanë kërkuar? 72 000 euro i paguan Parlamenti yt dhe imi brenda një muaji vetëm qira të veturave që kanë marrë për shefat e grupeve parlamentare, duke e përjashtuar "Vetëvendosjen!" që është i vetmi grup që e kanë punësuar një shofer dhe e shfrytëzojnë veturën për deputetët, jo për shefin e grupit parlamentar.

Këta tanët, duke filluar prej shefit tuaj e deri te imi, e kanë veturën private. Unë as që e kam ditur. Më kanë treguar vonë që ne kemi veturë. As që e kam ditur që e kanë marrë. Prandaj, mjerimi ynë i brendshëm Rexhë, kjo Qeveri dhe të gjitha qeveritë para kësaj, qysh e kemi gatuar ne brumin, qysh e pjekim ne bukën, ashtu e hanë të huajt.

Pastaj, më thoni një diçka. Po a e dini more ju sa diplomatë i kemi dërguar ne në diplomacinë e jashtme që janë me krim, janë me vrasje, me plagosje, me drogë, me trafikimin të qenieve njerëzore? A i pyet ndonjëherë ministria jonë e Jashtme dhe Qeveria jonë, për shembull; Suedinë, Norvegjinë, Gjermaninë, do ta çojë Rexhep Selimin diplomat ose Milaim Zekën, a ma dërgoni biografinë e Milaim Zekës? A ka qenë ky njeri ndonjëherë i burgosur? A ka qenë ky njeri në tabelat e krimit?

Ne e dimë këtu, deputetët e dimë që kemi diplomatë të atillë që i kanë bërë njëqind skandale. Në fund, dua të them diçka, që diplomacia nuk mund të jetë më mirë, se po e përfundoj fjalimin tim, me "Të fortit e lagjes".

Rexhë, ju në Shqipëri shkoni shpesh, edhe unë, e ke dëgjuar në të '90-tën "Të fortit e lagjes", tash "Të fortit e lagjes" në Tiranë që e uzurponin parkingun e uzurponin hapësirat publike, na kanë ardhur në Qeverinë e Kosovës.

Qeveria e Kosovës udhëhiqet nga “Të fortit e PDK-së”, “Të fortit e AKR-së”, “Të fortit” e AAK-së”, “Të fortit” e Nismës. Domethënë, brenda një qeverie i kemi pesë qeveri. Brenda një qeverie i kemi pesë qeveri! Prandaj, e kemi diplomacinë shaka. Kjo diplomaci është sikur e Nasradinit.

Sikur unë të kisha fuqi magjike, do ta kisha mbyllur komplet Ministrinë e Punëve të Jashtme. Sepse, ministrat e Punëve të Jashtme e diplomatët tanë më të mirë janë sportistët tanë. Janë këngëtarët tanë. Dhe, krenarinë tonë kombëtare sa 100 milionë, 200 milionë për t’i dhënë në diplomaci, nuk do të bënin jehonë në botë sa sportistët tanë dhe koncerti që u mbajt dje në Vatikan.

Ishin 200 personalitete shqiptare në Vatikan, nga Kosova, nga Maqedonia, nga Lugina, nga Diaspora, nga Tirana, që na e zbardhën fytyrën. Prandaj, këta janë diplomatët tanë. Ndërsa në fund për rezolutën dhe po e përfundoj.

Unë e kuptoj që po dëshironi t’ia vendosni këmbën dhe ta rrëzoni Qeverinë, sepse nuk kam parë askund në botë që në rezolutë kërkohet dorëheqja e Qeverisë. Ndryshojeni rezolutën, nëse doni që t’jua votoj. Po flas në emrin tim personal. Por, jo vetëm çfarë po keni dëshirë, fontanë dëshirash përshkruani tekste nëpër rezoluta.

Na kërkohet të tërhiqet Qeveria, e ku keni dëgjuar ju në këtë dynja që një shqiptar ka post dhe tërhiqet me vetëdëshirë? S’ka bre! Nuk ka”! Si ta kesh emrin shqiptar e të ulesh në karrigen e pushtetit, për pa të rrëzuar kali, po i hipe kalit te ne asnjëherë nuk i zbret. Kështu është pushteti te ne. Urdhëro! Ani e përgëzoj dhe i kërkuj falje Fatmir Rexhepit. Po ai garant...

KRYESUESI: Faleminderit, Milaim! Fjalën e ka deputeti Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kolegë të nderuar,

Përshëndetje kryesues,

Kabinet qeveritar,

Para se ta komentoj seancën, dua të përgëzoj për fitoren e Kombëtares e të falënderojmë edhe shtetin zviceran, i cili ka shkolluar dhe ka edukuar më së shumti futbollistë dhe sot ne jem në rritje çdo ditë.

Kam bërë thirrje që të jenë unikë edhe spektri politik për të shkuar përpara.

Seanca e thirrur sot e ka adresën e gabuar, sigurisht me dëshirë apo pa dëshirë, e keni bërë gabimisht. Unë jam deputet i votuar nga qytetarët, pastaj i jam përgjegjës ftesës, por ju tregoj që thirrja është e gabueshme.

Sigurisht sot ata që e kanë thirrur këtë seancë, e përmenda edhe më herët, gjysmën e diplomatëve i keni atje nëpër ambasada, i keni dërguar ju, sigurisht që tani janë shumë pak që kanë shkuar, do të thotë kanë shkuar më herët.

Kjo puna e Interpolit nuk ka filluar sot, ka filluar shumë më herët. Ku keni qenë ju aq të vyeshëm, të zellshëm që s'e keni arritur këtë qëllim? A keni qenë në qeverisje? Po. Prandaj ku është problemi, kërkoni direkt zgjedhje, po kjo nuk zë vend.

Ju e dini fort mirë që keni ambasadorë, i dini arsyet pse i keni çuar ambasadorët, me kushte. Kërkoni arsyet atje. Do të thotë, këtu sot nuk mund t'jua rehatojmë këtë çështje, t'jua heqim dhembjet, pse ju i keni çuar njerëzit më herët.

Prandaj, po ju tregoj që Ministria e Punëve të Jashtme nuk është kryekëput përgjegjëse për mosanëtarësimin në Interpol, edhe këtë e keni harruar, domethënë çdo ditë e tutje, po nga mllefi po gaboni, do të thotë, nuk është e drejtë.

E përmendi dikush edhe më herët ministrin e Punëve të Jashtme, Behxhet Pacollin, por Behxhet Pacollit a ia keni numëruar sa njohjet ia ka sjellë Republikës së Kosovës, keni harruar apo? Është e keqe kjo, kur harrojmë, e hamë bukën, pastaj i shkelim troshat, do të thotë është e keqe kjo dhe mendoj që nuk është Parlamenti vetëm për t'u sharë njëri me tjetrin, po është e rëndësishme që ne ta përkrahim njëri-tjetrin dhe të dalim me rezultat.

Prandaj, ne si Republikë e Kosovës, si Qeveri e Republikës së Kosovës, si Parlament nuk kemi të bëjmë me një ministri, kemi të bëjmë me një shtet agresiv, Serbinë, e cila ka aleatë, është shtet më i madh se Republika e Kosovës dhe natyrisht ka lobime më të fuqishme. Shpeshherë e ka ende një strukturë prej ish-Jugosllavisë që i kanë ato miqësitë dhe nuk është lehtë të kalohen. Do të thotë, nuk është e sodit, se po të kishte qenë lehtë, ju e kishit kryer më herët, nuk e kishit pritur këtë Qeveri. Do të thotë, ju nuk e keni kryer më herët detyrën tuaj, se ju i keni dërguar njerëzit familjarë, kanë qenë edhe deputetë edhe të tjerët, të cilët janë kushtëzua për diplomaci, nuk keni zgjedhur kualitet.

Kjo është e vonshme të qani me lot krokodili.

Prandaj, shikoni pak biografinë, shikoni edhe njohjet, shikoni edhe punët që kanë krye deri më sot, shikoni edhe kush ka dhënë kontributin më të madhin edhe në diplomaci, edhe në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, pastaj adresoni.

Unë jam për kritika, po të jemi realistë dhe konkretë, jo për interesa të ngushta, kjo nuk na bënë të fuqishëm, kjo është duke na sjell mbrapa.

Qe sa kohë jam në këtë Parlament, për herë të parë, po kam dëgjuar boll, kam parë boll, këtu ka ndodhur rasti që edhe kur ka propozuar dikush një ligj apo një temë të caktuar që ka qenë e mirë, janë çuar të tjerët që të përfitojnë në aspektin politik ia kanë humbur edhe ngjyrën, domethënë ne jem duke ua humbur ngjyrën.

Sigurisht që këtu kemi pasur aleancë me të gjitha këto parti që janë brenda, prandaj unë kur e shaj dikë, nuk kam qejf të kem edhe aleat, duhem të jemi shumë konkretë. Do të thotë, duhet kërkuar një adresë të koordinuar.

Ministria e Punëve të Jashtme apo diplomacia nuk është vetëm e qeverisë, është e krejt neve, është e krejt këtyre deputetëve që me mijëra euro harxhojnë nëpër takime, nëpër Bashkimin Evropian dhe vende të ndryshme e çka kanë sjellë këtu, të më tregojmë konkretisht, ku janë ato, a kanë bërë më shumë shpenzime, a kanë sjellë diçka të mirë.

Prandaj, këtu nuk ka hapësirë hiç t'i thuhet dikujt diçka. Ka hapësirë që të ndalemi e të reflektojmë e të mendojmë mirë ku i kem këto gabime, a jemi ne në rregull? Mos mendoni se anëtarësimi në Interpol nuk është bash 'hyra aty edhe kalova', po është një punë e madhe.

Ne brenda vendit tonë nuk i kemi punët bash në rregull, në mes veti nuk jemi në rregull. Një aheng të bëhet kërcet ku me ditë çka atje. Pse, pse ne në përgjithësi, jo nuk ka ngjyra politike, se ka pasur njerëz të ndryshëm. Prandaj mos e personalizoni, por po ju them që ne si vend, si popull, duhet të reflektojmë, do të thotë nuk shkojnë veç me krah, të shtyhen me të njohshëm, të shikohen interesat personale, po ne duhet korrigjuar dhe përkrahur njëri-tjetrin nëse duam të fitojmë karshi Serbisë, asnjëherë ndryshe jo.

Veprimi më i fundit i djeshëm mendoj që ka mundur të jetë edhe më herët dhe më fuqishëm, po ne kur t'i themi dikujt jo, duhet pastaj mbajtur atë linjë. Po mbani në mend që as kryeministri nuk do të mund të mbajë nëse nuk jem të gjithë të bashkuar, do të thotë, duhet t'i japim përkrahje të gjithë, edhe unë jam për t'i dhënë përkrahje.

Mbani në mend që as presidenti vetë nuk mund të kryejë punë nëse ne nuk jemi në ujdi së bashku, as ministrat, e kjo çështja e Interpolit kryekëput nuk është hiç e ministrit të Punëve të Jashtme, sigurisht se diplomacia e luan rolin e vet, po nuk është kryekëput e asaj.

Prandaj, çdo kush që ka folur këtu, edhe ata që nuk kanë folur, e dinë ku janë problemet, e dinë kush i ka çuar krejt korin diplomatik, nuk është i emëruar sot kori diplomatik.

Edhe mos harroni se kjo punë është e përbashkët me juve dhe dikujt nëse ndonjëherë i hiqet një interes personal, e kam kuptuar që e kemi prej gjenezës, ne që duhet të sulmojmë pastaj, unë

mendoj që kjo është e padrejtë, jokorrekte, por unë jam i prirë pikërisht me juve që ne t'i mbledhim të gjitha lëshimet aty ku janë bërë dhe t'i bëjmë korrigjimet apo t'i bëjmë ndryshimet.

Por, prapë po them, ata që kanë qenë qe dy qeverisje më herët pse nuk arritën ta bëjnë këtë çështje. Po ju garantoj po të kishte ndodhur atë ditë votimi që këtu ka pasur lëvdata secili dhe më së pakti ishte përmendur Pacolli, po ishin përmendur të tjerët se unë e kam bërë këtë punë, unë e kam takuar atje.

Mos harroni që ne kemi arritur të marrim votën edhe te një shteti, ku me të vërtetë e ka pasur vështirë të votojë, po e ka përkrahur, e ka votuar përkrahjen në Interpol të Republikës së Kosovës, keni harruar atë. Do të thotë, nuk është pa lidhje. Por ne kemi të bëjmë me një shtet shumë të fuqishëm, që nuk na ka pranuar, është Rusia, bashkë me aleatët e vet, Serbia po ashtu si agresorja më e fuqishme, në të gjitha periudhat e shqiptarisë, çka keni pritur që do të na përkrahë, jo. Unë po ju them që ende nuk do të vazhdojë të na përkrahë, por ne duhet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Ilir Deda.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Zonja dhe zotërinj,

Kolegë të nderuar,

Faktikisht është gjynah t'i thuhet kësaj çfarë kemi sot diplomaci dhe është gjynah të quajmë çka do që kemi bërë në dhjetë vjetët e kaluar si diplomaci. Kosova ka pasur diplomaci e lobim të suksesshëm në vitet e '90-ta. Faktikisht, në atë kohë neve na kanë njohur si një popull, i cili po di të përdorë instrumente diplomatike, edhe mbas bombardimeve të NATO-s shqiptarët e Kosovës janë parë si populli apo ndër popujt e paktë në botë, në tre, faktikisht, popujve të botës, të cilët kanë ditur t'i përdorin mekanizmat diplomatikë lobues për të arritur qëllimin e tyre, edhe prej vitit '99 ne e kemi marrë teposhtën.

E kemi marrë teposhtën për shkak të realitetit të Kosovës, për shkak të mendësisë provinciale, e cila e ka parë diplomacinë në fjalinë 'të shkojë, ta rehatoj dikë të partisë aty'. Të mos bëhemi engjëj para njëri-tjetrit tash. Sepse, prej vitit '99, edhe kur është tentuar para shpalljes së pavarësisë të ndërtohet një celulë e vogël, e cila do t'i përgatitë diplomatët e ardhshëm, është parë ashtu, si mekanizëm i rehatimit të kuadrove lojale e partiake. Partizimi i Kosovës dhe ajo mendësi faktikisht na ka sjellë që ne sot të ballafaqohemi me punën e kësaj mendësie, domethënë me vetveten tonë. Tash, çka domethënë dështimi epik, debakli në UNESCO? Debakli në UNESCO do të thotë që Kosova nuk ka ditur të ndërtojë marrëdhënie bilaterale as me shtetet që na kanë njohur. Kosova nuk ka ditur ta ketë një qasje apo një kërkesë as drejt Bashkimit Evropian, ku një pjesë e shteteve aty votojnë kundër kycjes së Kosovës në rrjetin global të

luftimit të krimit. E çdo ditë na thonë qysh duhet ta luftojmë krimin dhe korrupsionin. A, shtetet njohëse, të cilat na kanë njohur, kanë abstenuar ose nuk kanë marrë pjesë në votim, ose kanë votuar kundër. E, po zonja e zotërinj, kjo është të ballafaqohet shteti me të vërtetën, të cilën një mendësi e caktuar na ka sjellë deri në këtë pikë. Në rregull, nuk është fundi i botës, por duhet të jetë pikënisje për mësim.

Tash, të mos kishte ndodhur masa dje, do të bisedonim pak më ndryshe sot. Po, sot nuk duhet të anashkalojmë edhe një gjë tjetër, Kosovës iu kanë tërhequr mes shtatë edhe dhjetë njohjeve, zonja dhe zotërinj, kjo nuk ka të bëjë me Qeveri, ka të bëjë me shtetin, e kur ka të bëjë me shtetin, ne jemi në betejë, e dje ka filluar një betejë më e madhe, sepse këtë Kosovë e kanë mbështetur për muri, për shkak të kryeultësisë, e cila ka mbizotëruar sidomos në këto dhjetë vjet. Unë e kam përshëndetur, edhe Alternativa e përshëndet masën e djeshme të Qeverisë, ne kërkojmë edhe zhvillim të pakos të masave të reja, të cilat duhet të vijnë. Përndryshe, unë isha duke e menduar, a ju kujtohet kur kemi pësuar debakël në UNESCO gjatë qeverisë së kaluar, thashë paramendoni të kishim pasur unitet në atë kohë pas atij debakli që të ndërmerim veprime çfarë janë marrë.

Ndoshta do të ishim në një pikë tjetër sot, ndoshta, nuk e dimë, por sot jemi në këtë betejën tjetër. Dhe, ne në këtë dhjetë vjet i kemi ndërruar tri herë “strategjinë e politikës së jashtme”. Kur ke strategji, nuk e ndërron çdo tre vjet, ajo duhet të jetë diçka, e cila të mbanë apo të udhëheqë, edhe të ashtuquajturat strategji të qeverive të Republikës së Kosovës kanë qenë një herë njohjet bilaterale, një herë anëtarësimi në organizata multilaterale, mandej e inspiruar nga kryetari i tashëm i Kosovës, zoti Thaçi, e gjithë diplomacia është bllokuar që Kosova ta rrumbullakësojë shtetësinë e vet nëpër dialogun e tij personal me Republikën e Serbisë. Natyrisht që dështojmë në Perëndim kur kryetari i shtetit flet për ndërrim të territorit, që është cenim i shtetësisë. E, unë e shoh masën e djeshme si përforcim të shtetësisë në këtë territor, të cilin e kemi, e për të cilin jemi, deklarativisht të paktën, të gjithë ne që jemi këtu.

Çka duhet të bëjmë? Ne duhet ta kuptojmë apo të paktën njerëzit në partitë politike, të cilët do të merren me politikë të jashtme, duhet ta kuptojnë që duhet ta fillojnë diskontinuitetin e mendësisë, e cila e ka zaptuar politikën e jashtme. Po mos harroni që ka pasur edhe vota të caktuara, në votime të caktuara, ku si shpërblim është marrë një post në politikë të jashtme, domethënë kur po flas këtu, është një kontinuitet, e fundi është Interpoli. Po, këtu ministri i Punëve të Jashtme duhet të japë përgjegjësi, të mos na thotë “fake news” është tërheqja e njohjeve, por të vijë le të tregojë, në seancë të mbyllur, nëse është nevoja, çka po bëhet me këtë si kundërpërgjigje ndaj tërheqjes së njohjeve, a do të ketë diçka tjetër dhe ta kuptojë një herë e përgjithmonë gjithkush në këtë Kosovë që politika e jashtme nuk është individuale. Parlamenti, i cili ka rol në diplomaci, është i anashkaluar total, i anashkaluar, një në raportime të ministrit të Jashtëm në komisionet përkatëse, nuk vjen kurrë, as në Komision për Politikë të Jashtme, as për

Integrime Evropiane, dhe dy, nuk ka bashkëndim për asnjë çështje të politikës së jashtme, a e dini pse?

Sepse, është ajo mendësia e njëjtë, e cila transferohet në Kryesi të Kuvendit, e cila thotë nëse dikush prej këtij Kuvendi do të shkojë të llojë, duhet pasur ftesë prej dikujt për lobim! Kjo tregon që Kosova në total nuk është askund të kuptojë këtë fushë dhe këtë fushëveprim. Unë thënë të drejtën hiç s'jam optimist që do të ndërrojë me qeverinë e nesërme, cilado që të jetë ajo, sepse mendësia nuk i përket një partie politike, ajo provinciale, por po u përket shumicës së partive politike. E, nëse doni lidhshëm, urdhëroni, bre, liderë, merrni vesh që dikasterin e politikës së jashtme s'do ta partizoni më. E, anëtarëve tonë u themi: "S'ka vend për ty aty, e as për një kushëri këtu, e as për këto farë zyrtar për politikë të jashtme që i kemi, sepse s'janë njerëz të aftë për të udhëhequr, as të jenë në diplomaci". Aty e tregoni seriozitetin, a deri atëherë, kështu do të mbetemi. Dhe, për fund, ne sot duhet ta çojmë një mesazh tjetër, mesazhin e unitetit në betejën për shtetësinë e Kosovës.

Në fakt, unë juve po ju lus prej muajit maj që Kosova ta marrë një vendim, ky Kuvend që i përket territorit të këtij shteti, po s'po mendojnë krejt veç për territor, por po mendojnë nëse e bëjmë këtë, çka është tjetra. Jo, jo, urdhëroni, një vendim duhet ta marrë ky Kuvend. Edhe e dyta, unitet i plotë për masat, të cilat janë në qeveri, sepse në betejë nuk lihen njerëzit vetë, beteja është e çdonjërit prej nesh, s'është e Ramushit, s'është e Albinit, s'është e LDK-së, e asnjë tjetër, është e të gjithëve tash, sepse jemi në procesin më serioz të sfidimit të shtetësisë së Kosovës. Edhe askund s'do të mbërrijmë, të dashur kolegë, në qoftë se ne nuk mbërrijmë një 3-4 pikësh ta aprovojmë bashkë, që i përket territorit të shtetit tonë.

T'ju tregoj diçka, vitin e ardhshëm do të jetë vonë nëse ne mbesim kështu ku jemi tash. Vonë jemi tash për territor, sepse derisa ne shtyhem për fjalë në rezolutë, Hashim Thaçi po u grah punëve, e në fund të gjithë do të ndihemi përgjegjës në një mënyrë, sepse do të reflektojmë a kemi mundur të marrim një veprim të mirë para 3-4 muajve apo jo? Kështu që unë shpresoj që sot do të dalim me përfundim shtetëror e shtetformues në Kosovë, e jo partiak e të politikës ditore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, tani fjalën ia jap deputetes Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues Shala!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra që jeni të pranishëm,

Diskutimin tim për këtë pikë po e filloj duke iu referuar deklaramentit të fundit të kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, i cili me rastin e dështimit të diplomacisë së Republikës së Kosovës për anëtarësim në Interpol, iu drejtua kështu opozitës, po citoj: "Do të ishte mirë dhe patriotike sigurisht që partitë opozitare në vend që të bashkëndejnë me Serbinë gëzimin për

mosanëtarësimin e Kosovës në Interpol, e t'i fërkojnë duart për pushtet, t'i thërrasin arsyes dhe të gjejnë forcën e duhur për t'iu bashkuar institucioneve të vendit në përballje të përbashkët me sfidat që kemi përpara si shtet e shoqëri”.

Fatkeqësisht sot s'qenka këtu zoti Veseli, se nuk është me rëndësi kjo çfarë ka ndodhur dhe çfarë duhet të ndodhë me Kosovën, me rëndësi janë këto deklaratat patetike. Unë po i drejtohem zotit Veseli, duke i thënë ju ishte dashur që së paku një herë në jetën tuaj të jeni i guximshëm e korrekt dhe t'u drejtoheni liderëve institucionalë, duke filluar nga presidentin, kryeministri, ministri i Punëve të Jashtme, duke përfshirë edhe veten tuaj dhe të pranoni dështimin tuaj dhe të jepni që të gjithë dorëheqje, të hapni rrugë për zgjedhjet nacionale.

Në vend se të pranoni se koalicioni juaj qeverisës është i shantazhuar nga presidenti, ju lëshoni deklaratat patetike dhe fyese, që ndikojnë në përçarje të spektrit politik në vend, në kohën e paduhur, kuptohet. Nuk mund të fshiheni më pas hijeve tuaja. Nuk ka shembull më konkret se refuzimi i Kosovës për anëtarësim në Interpol. Kjo është përgjigjja e miqve dhe e kundërshtarëve të Kosovës për deklaratat dhe idetë e presidentit që, sipas tij, projekti i pavarësisë së Kosovës është i dështuar dhe duhet rinegociuar kufijtë dhe territori i vendit.

Ju, përfaqësues institucionalë, me deklaratat të tilla, me ide, me sjellje jodiplomatike, me skandale të përditshme keni arritur që Kosovës t'ia dëmtoni imazhin dhe të ardhmen, e për këtë gjë duhet të jepni llogari. Ju, si përfaqësues institucionalë, me çakordim total mes jush dhe me çakordim total të politikës së jashtme, siç janë përplasjet politike president-kryeministër, përplasjet mes partive politike të koalicionit, papërgjegjësi totale e Ministrisë së Punëve të Jashtme, ja deri ku e keni sjellë Kosovën.

Shtetet që e kanë njohur Kosovën prapë më s'e mbështesin Kosovën. Çfarë lobimi është bërë e po bëhet për Kosovën? Ju nuk keni asnjë strategji konkrete për asnjë proces diplomatik. Nuk ka transparencë, përveç udhëtimeve jashtë vendit me delegacione të stërmëdha, e që nuk komunikojnë asnjëra me tjetra, shpenzime marramendëse si dhe rehatimin e eksponentëve tuaj politikë të pakompetencë profesionale nëpër ambasada, asnjë veprim tjetër nga kjo Qeveri nuk ka. Nuk ka transparencë në shpenzimet buxhetore për lobim. Ky Kuvend ka ngritur një komision hetimor për fondet e lobimit të presidentit dhe kryeministrit dhe liderët institucionalë nuk paraqiten fare as në komision për të raportuar për shqetësimet e Kuvendit dhe për paranë e taksapaguesve të Republikës së Kosovës. Paratë e taksapaguesve të varfër të Republikës së Kosovës po shpenzohen për të botuar libra, për të përmirësuar imazhin e presidentit tonë, siç e kemi deklarimin e ish-prokurorit të Hagës që Hashimi i ka mbetur borxh edhe 500 mijë euro për punën e tij që ka bërë në lidhje me botimin e librit për presidentin e Republikës së Kosovës. Skandaloze!

Harxhohen miliona euro për të ngritur imazhin e tij, duke paguar gazetarë dhe publicistë që të lavdërojnë atë e të fyejnë kundërshtarët e tij politikë, siç ishte rasti për presidentin Rugova. Ironi! Kur sorra pretendon të krahasohet ose të bëhet shqiponjë!

Një krahasim. Dyshohet se dy herë më shumë janë shpenzuar para për librat e Hashimit, sesa për lobim për anëtarësim në Interpol. Kjo është puna juaj dhe diplomacia juaj. Lidhja Demokratike e Kosovës kurrë nuk i është gëzuar as që po i gëzohet dështimit të Kosovës çdo ditë nga veprimet tuaja, por po kërkon dorëheqjen tuaj, sepse me ju po shohim se nuk ka shpresë ky vend.

Me këtë rast dua t'i drejtohem edhe bashkësisë evropiane, Brukselit zyrtar. Kërkojmë trajtim dinjitoz për qytetarët e Republikës së Kosovës, për rininë më të shëndoshë e më proevropiane në regjion. Të arriturat dhe dështimet e këtij vendi janë bërë bashkë me bashkësinë evropiane në Kosovë. Kërkojmë nga BE-ja lëvizje të lirë, se për bëmat e liderëve tanë, jeni përgjegjës edhe ju, ndërsa qytetarëve të këtij vendi po u siset durimi. Ju si ndërmjetësues të dialogut Kosovë-Serbi, duhet ta ngrini zërin dhe t'i drejtoheni Serbisë. Nuk ka marrëveshje ku liderët e Serbisë llobojnë dhe korruptojnë nëpër korridoret e institucioneve ndërkombëtare hapur për ta penguar Kosovën në rrugëtimin e saj.

E dimë se Serbia ka alternativë kundrejt Bashkimit Evropian, e ka Rusinë, ndërsa Kosova nuk ka alternativë. Ne, pra, të vetmen alternativë e kemi BE-në dhe pretendojmë dhe kërkojmë që të mos ndihemi jetim, edhe pse e kemi nënën, pra. Ka raste kur nëna heq dorë nga fëmija, por ajo nënë është e humbur dhe e dështuar, kur i mbyll zemrën dhe dyert fëmijëve të vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetes Blerta Deliu Kodra.

BLERTA DELIU KODRA: Faleminderit, kryesues Shala!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në fakt u përmendën disa argumente që kërkesa për anëtarësim në Interpol nuk është kërkesë që parashtrohet për herë të parë. Një kërkesë të parë e kemi pasur qysh në vitin 2010 nga asokohe ministri i brendshëm, Bajram Rexhepi, i cili do ta thotë e kishte bartur këtë ide te Sekretari i Përgjithshëm i Interpolit dhe nuk kishte kaluar në agjendë tjetër. Po ashtu pesë vjet më vonë kemi pasur një tentativë të dytë për anëtarësim në këtë organizatë të Interpolit dhe kërkesa e fundit ka qenë para një viti, kur nuk ishte futur fare në agjendë të Komitetit Ekzekutiv të kësaj organizate, meqë institucionet asokohe kishin tërhequr kandidaturën për shkak të mungesës së votës.

Do të thotë, është absolutisht një moment i ri, sepse kësaj here ne e kemi pasur në agjendë anëtarësimin e Kosovës në Interpol dhe po bashkohem me atë që u tha sot këtu që është një

disfatë dhe goditje e madhe për institucionet e Republikës së Kosovës, për shtetin mosanëtarësimi në Interpol dhe një mësim, të cilin duhet ta marrim të gjithë, pozitë e opozitë, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe shteti i Kosovës.

Nga ky dështim mendoj që Kosova ka humbur një betejë, por assesi nuk e ka humbur përpjekjen dhe luftën e saj për t'u bërë anëtare e Interpolit në një të ardhme. Për më tepër, kjo humbje nuk është vetëm humbje e Republikës së Kosovës, është humbje edhe e aleatëve dhe miqve strategjikë të Republikës së Kosovës.

Shqetësim i madh në këtë rast është ajo që u përmend edhe nga kolegët e mi deputetë, shqetësim i madh në këtë votim për Interpolin ka qenë vota kundër nga shtetet, të cilat tashmë e kanë njohur Republikën e Kosovës dhe, më shumë sesa për njohje të reja, është obligim i diplomacisë kosovare që të fokusohet në fuqizimin e këtyre raporteve bilaterale te ato shtete të cilat e kanë njohur Kosovën dhe të cilat për anëtarësimin e saj në Interpol kanë votuar kundër. Shto këtu pastaj edhe ofensivën për të lobuar kundër Kosovës, betejën milionëshe të saj për të tërhequr njohjet, të cilat u përmendën këtu. Qasja e Serbisë karshi Kosovës, do të thotë e konfirmon më së miri këtë qasje deklarata e ministrit të Jashtëm, Ivica Daçiq, i cili u deklarua në mënyrë të pamatur. Qasje e cila shkon do të thotë në reagim, fushatën dhe ofensivën e ashpër që është duke e bërë Serbia. Dhe, gjithë ky presion i Serbisë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Interpol, të gjithëve na sjell te një konkluzion i qartë që, ata udhëheqës të institucioneve në Serbi e kanë parë të rrezikshëm anëtarësimin e Kosovës në Interpol pikërisht për shkak të emrave të tyre, të cilët kanë mundur të jenë në listën e Interpolit për shkak të krimeve që ata i kanë bërë gjatë kohës së luftës në Kosovë.

Megjithatë, për këtë dështim besoj që ne duhet të marrim përgjegjësinë dhe përgjegjësia duhet të jetë e të gjithëve. Kërkoj që në këtë kuadër ne të kemi një politikë më proaktive, e cila përfaqëson qartë interesin e shtetit të Kosovës dhe e cila do të duhej të definojë qartë pse disa shtete votuan kundër Kosovës? Cilat janë arsyet? A janë këto arsye politike, për të ardhur tek një analizë e qartë për një tentativë tjetër që do ta kenë institucionet.

Pastaj duhet të shihet strategjia për lobim, duke përfshirë këtu një transparencë të plotë të procesit të lobimit. Transparencë për fondet shtesë, të cilat u janë alokuar nga Qeveria për këtë proces të anëtarësimin në Interpol.

Një faktor tjetër që do të duhej të ndihmonte diplomacinë është një koordinim më i mirë ndër-institucional për proceset e anëtarësimin dhe proceset integruese, sidomos kur kemi parasysh faktin se vitin e kaluar ne nuk kemi arritur që të kemi shumë sukses që të bëhemi pjesë e organizatave ndërkombëtare, me përjashtim të një organizate, të Frankofonisë. Kjo e shton edhe më tepër nevojën që ne të jemi më të koordinuar. Kjo mungesë e koordinimit është vërejtur edhe ndërmjet, do të thotë bashkëpunimit Kuvend - Qeveri.

E thanë edhe kolegët e mi deputetë dhe kërkoj nga parashtruesit e kërkesës për këtë seancë të jashtëzakonshme, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, që të jenë më të përgjegjshëm kur kërkojnë seanca dhe të kenë në konsideratë kur ne deklarohe mi në seancë, sepse fundja është seancë e thirrur nga opozita dhe është mirë që ata të dëgjojnë argumentet edhe të pozitës në rastin e kërkesës që e kanë parashtruar që ne sot të jemi në këtë seancë.

Kur është fjala për moskoordinim, unë e ndaj shqetësimin e njëjtë me kolegun Ilir Deda, do të thotë si kryetare e komisionit gjatë një viti e gjysmë kemi parashtruar kërkesa të vazhdueshme që ministri i Jashtëm të raportojë në Komisionin për Integritet. Kemi ftuar në raportim disa herë ministrin e Punëve të Jashtëme, pasi që ministri i Punëve të Jashtëme është edhe kryesues i Këshillit për stabilizim-asociim. Këshill ky i cili ka për obligim mbikëqyrjen e zbatimit të realizimit të MSA-s dhe ministri i Jashtëm asnjëherë nuk ka ardhur në Kuvend që të raportojë në Komisionin për Integritet Evropiane dhe në Komisionin për Politikë të Jashtëme.

Do të thotë, edhe kjo mungesë e koordinimit ndërinstytucional shkon në vijë të asaj që Kosova nuk ka qenë e mirorganizuar në aspektin e anëtarësimit, sepse komisionet parlamentare kanë në fokus edhe diplomacinë parlamentare, edhe kanë pasur qasje të tyre, me kolegët deputetë kemi qenë në shumë takime rajonale dhe ndërkombëtare, ku jemi munduar të shtrijmë aktivitetin e lobimit dhe të zhvillojmë aktivitetin tonë si deputetë me parlamentet e tjera.

Mendoj që ministri i Jashtëm duhet të jetë i vëmendshëm të përgjigjet edhe në pyetjet e shumta parlamentare që i kemi pasur lidhur me tendencën e Serbisë që të deklarohe se disa shtete tashmë e kanë tërhequr njohjen nga Republika e Kosovës.

Ai duhet të ofrojë këto përgjigje, sepse e ka obligim kushtetues dhe duhet të jetë në Kuvend për t'iu përgjigjur kërkesave dhe shqetësimeve të deputetëve, të cilët përfaqësojnë qytetarët e Republikës së Kosovës. Shto këtu edhe mungesën e një konsensusi të brendshëm politik, e cila ka qenë njëra prej sfidave kryesore të këtij Parlamenti vitin e fundit. Do të thotë, unë ndaj shqetësimin e njëjtë me zotin Deda që më shumë se për çdo gjë, klasa politike kosovare ka nevojë për një unitet të brendshëm, në mënyrë që në qasjen tonë në iniciativa si kjo të jemi më të unifikuar dhe pastaj të mos e drejtojmë gishtin nga njëri-tjetri, se pozita ose opozita ka faj më shumë ose më pak.

Prandaj, mungesa e një koordinimi tonë të brendshëm dhe mungesa e një strategjie shtetërore të qartë ka pasur ndikim edhe në zbehjen e imazhit tonë si shtet këtyre viteve të fundit. Në këtë kohë të luftës së egër që është duke e bërë Serbia, natyrisht që unë e mbështes vendimin për taksë të Qeverisë dhe mendoj që është argumenti më i mirë që duhet të shkojë në raportet tona si dy shtete të pavarura dhe sovrane dhe po ashtu kërkoj nga Bashkimi Evropian që presionin e vazhdueshëm që e ka në raport me deklaratat e fundit, në raport me vendimin e Qeverisë, të jetë i vëmendshëm edhe karshi shtetit serb, sepse marrëveshja e 2013-ës, e cila parasheh që dy shtetet

ta ndihmojnë njëri-tjetrin, sidomos në anëtarësimet në organizatat e ndryshme, Serbia e ka shkelur vazhdimisht këtë obligim të saj, dhe ne duhet të veprojmë si dy shtete të pavarura dhe sovrane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani unë po i jap fjalën edhe deputetit Adem Mikullovcit dhe propozoj që pas fjalës së tij të marrim një pauzë deri në orën 15. Adem Mikullovcit, urdhëro!

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Dua t'ju them shkurt, në prag të Luftës së Dytë Botërore, në odën e Junikut burrat, njerëzit që ishin mbledhur aty, i thanë Ramadan Shabanit, a mund të na thuash për dy minuta se ku jemi, çka jemi e çka po na pret?

Ramadan Shabani përgjigjet: “Që t'ju flas dy minuta, duhet të përgatitem dy ditë. Nëse doni t'ju flas dy ditë, mund t'ia filloj menjëherë tash”.

Dua të them, neve na duhen dy ditë që t'i numërojmë të gjitha të metat, gafet, gabimet dhe fatkeqësitë që na i ka sjellë politika e jashtme e Kosovës. Prandaj, unë i drejtohem, edhe pse nuk është këtu prezent, kryeministrit direkt dhe i them: Zoti kryeministër, ishte potez që e kam pritur 20 vjet, potezin që e bëre me importin e mallrave nga Serbia. Ki rastin ta bësh edhe një potez tjetër të ngjashëm, fort të mirë dhe momentalisht kërkoj prej teje ta shkarkosh ministrin e Punëve të Jashtme.

Kjo është kërkesë imja kategorike. Se ai njëri është duke na dëmtuar shumë dhe na bëri gazin e botës. Kjo!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë punën do ta vazhdojmë në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë,
Vazhdojmë punën sipas agjendës.

Sipas radhës së paraqitjes, fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu, unë s'po e shoh në sallë. Albulena Balaj Halimaj, po ashtu nuk është në sallë.

Atëherë, fjalën e merr deputetja Mirjeta Kalludra.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot në vend që të zhvillojmë seancë parlamentare, ku do të diskutonim për të arriturat dhe rezultatet, e me theks të veçantë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, ne na duhet të diskutojmë të kundërtën, dështimet dhe skandalet e politikës së jashtme dhe të kësaj Qeverie.

Pavarësisht që ndahen miliona euro në emër të lobimit të anëtarësimin të Kosovës në organizata ndërkombëtare, siç duket këto u shfrytëzuan për dreka e darka të shtrenjta, udhëtime, për shëtitje e shopin të asistentëve, këshilltarëve e ministrave gjithandej.

Pra, s'ka si të mos dështojë politika e jashtme e Kosovës, një gjë të tillë më së miri e tregon edhe dështimi i fundit i mosanëtarësimin të Kosovës në Interpol. Pra, kjo tregon më së miri se ku gjendet sot politika e jashtme e vendit.

Arsyetimi i ministrit Pacolli dhe i Qeverisë për fushatën e egër të Serbisë është vetëm një arsyetim formal, sa për të arsyetuar dështimet apo mospunën e tyre para qytetarëve të Kosovës, sepse nga Serbia dhe politikat e saj nuk pritet asgjë e mirë për Kosovën.

Dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës s'kanë të ndalur dhe në vend se prioritetet e politikës së jashtme të jenë afatgjata, ato po ndryshohen çdo ditë, duke krijuar kështu konfuzion dhe situata të papëlqyera para partnerëve tanë ndërkombëtarë, ku stopimi i procesit të njohjeve është vetëm një nga pasojat e kësaj politike të jashtme të çakorduar, të papërgatitur, të papërgjegjshme dhe të dëmshme për shtetin e Kosovës.

Këtë e tregon më së miri edhe situata e fundit, ku për ne nuk votuan pro as disa nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe të cilat kanë qenë kontribuuese në zhvillimin e Kosovës si dhe kanë dhuruar miliona euro për Kosovën.

Kjo na tregon qartë se diçka nuk është në rregull me politikën tonë të jashtme dhe me këtë Qeveri.

Ky është një sinjal dhe moment i fundit që kjo Qeveri të japë dorëheqje edhe të shkojmë në zgjedhje, sepse Kosovës i duhet një qeveri legjitime, profesionale dhe jo Qeveri e pakicës, Qeveri e pazareve, Qeveri e shantazhuar nga Lista serbe, po ashtu e shantazhuar edhe nga partnerët e koalicionit qeverisës.

Të nderuar qytetarë,

U raportua përmes mediave se në Dubaj, aty ku zhvillohen punimet e organizatës Interpol, Kosova u përfaqësua nga një delegacion i gjerë. Mirëpo, këtij delegacioni i mungonte ministri i Punëve të Brendshme, zoti Ekrem Mustafa, për shkak të një aktakuze që është ngritur ndaj tij.

Kjo nuk është më risi për këtë Qeveri, sepse ka një numër të madh të ministrave, zëvendësministrave me aktakuzë të ngritur, ku pothuajse çdo ditë kemi lajme se sot u zhvillua një seancë gjyqësore ndaj këtij apo atij ministri.

Se Republika e Kosovës e ka themeluar diplomacinë e saj, përmes së cilës synohej forcimi i shtetit më të ri në Kosovë, por ja që po del të jetë e kundërta.

Diplomacia e Kosovës dështoi ta bëjë këtë, madje shkaktoi skandale e dështime të njëpasnjëshme, skandale të shumta, emërime politike joprofesionale, nepotizëm, mungesë të llogaridhënies, janë të vetmet ato që përshkruajnë diplomacinë apo politikën e jashtme të Kosovës.

Pas të gjitha këtyre dështimeve skandaleve të shumta, kjo Qeveri duhet të japë dorëheqje, sepse gjithë këto skandale e kanë dëmtuar jashtëzakonisht shumë imazhin e Kosovës në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka deputeti Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje të nderuar deputetë,

Ai i cili do të duhej sot të ishte në seancë, pra ministri i Jashtëm, Behxhet Pacolli, nuk është, sepse ai është frikacak në politikë, ai nuk është madje as politikan. Në bastardimet gjuhësore, frikacakut ndryshe i thuhet edhe ‘tuts’.

Ministri i Jashtëm nuk është këtu jo vetëm shkak i punëve që ka, por vetëm për një arsye. Ai është një ‘tuts’, sepse i frikohet opozitës, sepse ai edhe në të kaluarën, edhe sot po e ha bukën me turp.

Të nderuar qytetarë,

Viti 2018 për politikën e jashtme të Kosovës ka qenë vit i dështimeve të mëdha për shkak të kësaj Qeverie jostabile, kanë devijuar ndjeshëm planet e Kosovës për forcimin e sovranitetit të saj ndërkombëtar.

Me një kryeministër si Haradinaj, me një president si Thaçi dhe me një ministër të Jashtëm si Pacolli, Kosova ka arritur të sigurojë vetëm një njohje dhe atë nga Barbadosi.

Me këtë qeveri Kosova për herë të parë është përballur me tërheqjet e njohjeve të bëra për shtetin e Kosovës.

Këta qeveritarë kanë lejuar Serbinë të thërrasë konferenca për gazetarë, duke na shpalosur çnjohjet, kanë lejuar Serbinë të tallet me ne, prandaj ne nuk kemi nevojë për mëshirë nga Serbia, të cilën po e kërkon Pacolli, rrjedhimisht nuk kemi nevojë për një qeveri që ankohet nga Serbia, po për një Qeveri që përballet me Serbinë.

Qeveria e Kosovës ka lënë anash fushatën për njohje të Kosovës, ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës nuk ka qenë në gjendje të zgjerojë njohje ndërkombëtare të vendit.

Pacolli ka qenë i zënë më shumë për ta lëmuar dorën e Trampit aksidentalisht e për ta tallur veten e për të na tallur neve, ndërsa ka qenë i zënë duke menduar t'i hapë kufijtë me Kosovën në raport me Serbinë, e duke thënë se nuk duhet të ekzistojnë kufijtë midis këtyre dy vendeve, sigurisht ndoshta mund ta ketë nga nostalgjia e hershme.

Ndërkaq, në anën tjetër, aleatët tanë kanë ulur investimet e tyre diplomatike në ndihmën për Kosovën për të siguruar njohje të reja diplomatike dhe sigurisht kjo ka ndodhur për shkak se të tjerët nuk na ndihmojnë kur ne nuk i ndihmojmë dot vetes.

Diplomacia e Kosovës është përballur me pengesa, të cilat i ka shkaktuar vetë. Prandaj, ka krijuar marrëdhënie të kushtëzuara diplomatike sidomos me rinegocimin e Gjykatës Speciale, të cilën Lëvizja Vetëvendosje e paralajmëronte mosvotimin e saj me kohë.

Frustrimi ndërkombëtar me mungesën e përparimit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe ndërhyrjet partiake në institucionet e vendit, sidomos në fushën e drejtësisë. Debatet kundërthënëse të korigjimit të kufirit kanë ngritur shqetësimet për destabilizim të brendshëm, po ashtu edhe rajonal, sepse kemi një president gazi, i cili po dëshiron që 100 e sa shtete që e kanë njohur Kosovën, e që ne saktë nuk e dimë numrin e njohjeve të Kosovës dhe që saktë nuk e di as Pacolli, as Ministria e Jashtme, as kryeministri, as presidenti. Pra, ai do që këto 100 e sa shtete që e kanë njohur Kosovën, ta çnjohin dhe me kufirin gjysmak pa veriun e Mitrovicës, ta rinjohin edhe një herë.

Në vitin 2018 kërkesat për anëtarësim në organizata ndërkombëtare për shkak të mungesës së një politike të fuqishme të jashtme dhe për shkak të humbjes së mbështetjes së jashtme, Kosova nuk ka aplikuar prapë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë, Kulturë, UNESCO dhe tashmë dështimi i tretë skandaloz në Interpol.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare perceptohet se e forcon shtetësinë e Kosovës, por gjithashtu sjell përgjegjësi të mëdha, për çka Kosova nuk ka marrë masa të duhura të përgatitjeve institucionale për të forcuar kapacitetet dhe për të krijuar mekanizma për të marrë detyrimet që rrjedhin nga organizata të ndryshme.

Pas dështimit në UNESCO në vitin 2015, Kosova ka lënë me një anë synimin e saj për të aplikuar përsëri për anëtarësim, për shkak se nuk ka arritur të sigurojë mbështetjen e aleatëve dhe sigurisht përgjegjës për këtë janë qeveritë e kaluara dhe sidomos kjo Qeveri.

Në këtë mënyrë, kjo Qeveri ka hequr dorë që Kosova të jetë pjesë e përpjekjeve vendore, madje edhe globale, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë, të promovimit të edukimit mbi paqen, të rrisë bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik.

Mosliberalizimi i vizave po vjen si pasojë e krimit dhe korrupsionit në Kosovë. Por më e rëndësishmja, sepse nuk po arrin të gjejë përkrahje nga shtetet aleate dhe ato të cilat i njohim si shtete mike, e pa përkrahjen e shteteve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën ne mund të marrim liberalizimin e vizave nga Bashkimi Evropian, po nuk e kemi përkrahjen e shteteve që e kanë ndihmuar Kosovën dhe të cilat ne i konsiderojmë shtete aleate e mike, me ç'rast po i humbim edhe ato.

Dështimi i fundit në Interpol është tregues shumë i qartë se kjo Qeveri është e dështuar, me njerëz të dështuar, të cilët po e dështojnë Kosovën.

Prandaj, Kosova bën edhe pa këtë Qeveri, edhe pa këtë president të dështuar e të shantazhuar, që të mos dështojë Kosova, më mirë le të dështojë presidenti, kryeministri, ky ministër 'tuts' dhe kjo Qeveri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e agjendës të asaj që po flasim sot, edhe për çka ka kërkuar opozita, personalisht bëj kërkesë që në këto momente të jemi të unifikuar rreth gjendjes në të cilën është Kosova dhe rreth asaj që po flasim për politikën e jashtme.

Është e vërtetë që shteti ynë ka dështuar në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, mirëpo është edhe një e vërtetë tjetër që edhe qeveritë e mëhershme kanë dështuar një diçka të tillë. Bile në Asamblenë e fundit janë detyruar edhe ta tërheqin kërkesën, po nuk kanë qenë fajtorë, sepse e kanë ditur përkrahjen.

Për të kaluar me vota në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit na duhen edhe 40 vende më shumë se sa shtetet që kanë njohur Kosovën. Po në rrafshin diplomatik ka qenë edhe një e arritur e madhe që e ka trembur Serbinë shumë, ka qenë vota jo kundër për të hyrë në agjendë e Ruisë. Nuk e di prejardhjen e gjithë kësaj, mirëpo Serbia është trembur shumë në këtë aspekt, po ka korrur fitore në lobimin e saj kundër anëtarësimit të shtetit tonë në Interpol.

Dihet se cila ka qenë agjenda e Serbisë më e madhja në këtë aspekt, do të thotë me vetë paraqitjen e kërkesës së Republikës së Kosovës për anëtarësimin në Interpol, Serbia është alarmuar dhe i ka alarmuar të gjitha qarqet proserbe në tërë botën se Kosova, menjëherë sapo të futet në Interpol do t'i fusë në listën e Interpolit mbi gjashtë mijë persona të Republikës së Serbisë, çka do të thotë se Serbia u vu në mbrojtjen e gjashtë mijë kriminelëve të saj dhe që Asambleja e Përgjithshme nuk qe e interesuar për t'i dënua këta kriminelë. Këto janë supozime, mirëpo Kosova e di se çka ka ndodhur 20 vjet përpara pikërisht nga Serbia, dhe duke mos dashur ta dënojë krimin e organizuar, kriminalitetin dhe krimet e luftës në këtë rast Asambleja e Përgjithshme e Interpolit nuk i dha shuplakë Kosovës, po i dha vetvetes në gjendjen e sigurisë. Pranoi dy shtete që mekanizmin e tyre për ruajtjen e kufijve në kuadër të Interpolit dhe gjendjes së sigurisë botërore, kufijtë e tyre i ruajnë me gomarë, e jo një polici që ne si popull nuk duhet të lëkundemi në qëndrimet tona, sepse kemi policinë më të fortë në rajon dhe lirisht i them është 'polici spartane' në mbrojtje të integritetit dhe në atë që është e thirrur me ligj në Republikën e Kosovës. I them 'spartane', se me të vërtetë policinë e kemi më të integruar, jo 'spartane' në kuptimin klasik, po 'spartane' me gjithë mekanizmin e saj përcjellës në shekullin XXI.

Unë kisha bërë thirrje gjithë mekanizmit këtu, të gjitha subjekteve politike, jemi në një gjendje krejt tjetër që duhet të bashkohemi pozitë-opozitë kur është interesi nacional, po edhe në politikën e jashtme.

Për atë që po vjen si rezolutë, nuk duhet ta kryqëzojmë zotin Pacolli në këtë rast pse është ministër i Jashtëm. E dimë sa ka ndarë buxhet Kosova për Ministrinë e Punëve të Jashtme, sepse s'kemi më shumë, janë 30 milionë, vetëm në një segment, në lobim, besoj se Serbia ka dhënë shumë më shumë.

Po kur është si personalitet edhe në politikë, edhe vetë po të kisha qenë në opozitë e kisha kundërshtuar, po rrugëtimi deri këtu për të ardhur Behgjet Pacolli në Kuvendin e Kosovës ka ardhur nëpërmjet LDK-së, ka qenë në listë bashkë me ta, të LDK-së, ka qenë i dyti apo i treti i zgjedhur në listën e tyre.

Gjegjësisht, edhe për Lëvizjen Vetëvendosje e them se nuk duhet në asnjë aspekt ta kryqëzojmë për shkak se edhe në Komunën e Prishtinës, pavarësisht se është ndarë Partia Socialdemokrate, me zotin Pacolli kanë bërë koalicion si Vetëvendosje dhe sot e udhëheqin Prishtinën.

Në rrafshin tjetër, personalisht edhe vetë jam kundër një mekanizmi që zoti Pacolli me vetë fjalën e tij u deklarua parakohshëm në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, kur tha ne do të anëtarësohemi, nuk duhet ngutur, për shkak se Interpoli është pak më gjerë se ndoshta Bashkimi Evropian dhe shumë miq të tjerë që e kanë njohtë Kosovën, për atë deklaratat e ngutshme nuk i kam pëlqyer, nuk i pëlqen askush, po besoj se Qeveria, në këtë rast edhe Ministria e Punëve të Jashtme duhet të jetë më syçelë të ardhmen, kemi shumë elemente të tjera përpara, sepse kemi të bëjmë me një armik që e kemi komshi, të keq, na u ka bërë komshi, sepse në historinë e njerëzimit askush nuk di ku kanë qenë këta njerëz para shekullit VII. Le ta gjejë dikush, ne e dimë që kanë ardhur nga Karpatet, por historia e tyre fillon në vitet 700, po edhe aty jo me emra adekuatë. Ndërsa neve për civilizimin tregojmë shumë, kudo që gërmohet në tokën e Kosovës, shihet se ka civilizim mijërvjeçar.

Kështu që në kuadër të këtij procesi që sot po flasim, lidhur me të gjitha këto kërkesa, edhe një rezolutë që sot na del përpara, unë mendoj se ka të drejtë opozita çdo sekondë për të kërkuar zgjedhje, po qysh? Zgjedhjet nuk bëhen me rezoluta, duhet të fitohen votat ose të bëhen votat për ta rrëzuar një qeveri.

Unë edhe një herë po kërkoj prej të gjithë juve, Qeveria ka marrë hapa konkretë tani, edhe ato masa kërkoj nga këtu që të radikalizohen edhe më shumë që proceset e Kosovës më mos të ngadalësohen, as të pengohen në integrimin e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Enver Hoti nuk është. Kështu që fjalën e ka deputetja Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fjalën time do të flas për disa nivele përgjegjësish dhe përgjegjësi për politikën e jashtme.

Për fatin tonë të keq, gjegjësisht për dështimin e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës me shumë keqardhje duhet të pranojmë fatin se tashmë nuk arritëm që të futemi në mesin e 192 shteteve që janë pjesë e organizatës së Interpolit.

Dhimbja është edhe më e madhe kur disa zëdhënës tanë politikë të papërgjegjshëm na kanë ushqyer me trumbeta vetëmburrëse se tani më kësaj radhe Kosova do të pranohet në këtë

organizatë tejet me interes për ne, por jo vetëm për ne, por për të gjitha ato shtete dhe popuj që janë të interesuar të luftojnë krimin dhe kriminalët kudo që janë.

Tashmë edhe është fakt i ditur që Serbia nuk lë gjë pa bërë për të penguar rrugëtimin tonë drejt rumbullakimit të shtetësisë tonë.

Mirëpo, më habit fakti se si politika jonë e jashtme, po edhe plot zëra të tjerë në këtë shans të anëtarësimit tonë në Interpol, në vend që të merren me punët e tyre konkrete dhe lobuese, ata janë marrë me shtrëngime duarsh të politikanëve të mëdhenj, pa thënë as edhe një fjalë për këtë anëtarësim, po njëherësh janë krekosur para opinionit të brendshëm se gjoja tashmë kjo punë është e kryer, ashtu siç bën para dy vjetëve me hapjen e shampanjës për gjoja pranimin tonë në UNESCO, e që për fat të keq, si në rastin e tillë të Interpolit, ashtu edhe në UNESCO në rundin e dytë të votimeve Kosova dështoi të futet në dy organizma shumë të rëndësishme për vendin tonë.

I përmenda këta shembuj për t'iu drejtuar edhe një herë njerëzve tanë kompetentë, në rastin konkret, Ministrisë së Punëve të Jashtme se si është e mundur vallë që dy herë me radhë të dështojë lobimi ynë me një shtet jo vetëm që është mik i ngushtë i Republikës së Kosovës, e cila është ndër shtetet e para që ka njohur Republikën e Kosovës, siç është Japonia.

Po të kthehemi në retrospektivë, Japonia abstenoj për UNESCO para dy vjetëve, mirëpo kjo që ndodhi me Interpolin, që ky shtet përsëri të abstenojë në rastin e votimit të Kosovës në Interpol, kjo me të vërtetë nuk mund ta fajësojë askënd përveç politikanëve të gabuar dhe të papërgjegjshëm.

Shkurtpamësia e këtyre politikanëve shkoi deri atje sa që një javë para se të mbahej kjo konferencë e Interpolit në Dubaj, aty ku e kanë mendjen ditë e natë, ndanë 1.4 milion euro për gjoja lobimin e Kosovës për t'u pranuar në Interpol.

Tash shtrohet pyetja se si do të arsyetohen këta zyrtarë të lartë pranë popullit të vet për këtë dështim?

Në këtë nervozë të qytetarëve, të paktën këto donacione të quajtura lobim për shtetin tonë t'i kthehen buxhetit të këtij vendi të varfër dhe të kërkojnë ndjesë të gjithë ata që të paktën me para po përpiqen të kompensojnë dëmet profesionale të dështimit të tyre politik.

Me keqardhje duhet thënë se politika jonë, por edhe disa shtete të fuqishme aleate të Republikës së Kosovës, siç janë SHBA, Gjermania, Franca, në veçanti Austria, nuk e kanë kontributin e tyre me tërë potencialin që ato kanë rreth lobimit të shteteve anëtare të Interpolit për ta ndihmuar kësaj radhe jo vetëm Kosovën në drejtim të një segmenti të shtetësisë, por për të krijuar edhe një siguri më të madhe në rajon dhe më gjerë.

Mbasi është momenti i fundit që institucionet e vendit, përkatësisht Kuvendi i Republikës së Kosovës me Qeverinë të krijojë trupa përkatëse pune për të analizuar shkaqet e dështimit të njëpasnjëshëm të Kosovës në institucione të ngjashme ndërkombëtare.

Këto masa duhet të shoqërohen në bashkëpunim edhe me ekspertë të shteteve aleate të Kosovës, në mënyrë që të nxirret një përfundim se si duhet koordinuar punët drejt një synimi, gjegjësisht sukcesi në këto organizma.

Një çështje tjetër që po aq e rëndësishme, siç janë ato që u thanë më lart, është edhe çështja e ndryshimit të politikave tona në raport me Serbinë. Mendoj se kësaj radhe ne duhet të kushtëzojmë çdo bashkëpunim ekonomik, shtetëror me Serbinë, derisa ajo të kuptojë se marrëveshjet që janë nënshkruar që nga viti 2013 e këndej duhet t'i zbatojë një për një.

Them kështu, sepse Serbia me politikat e saja subversive, duke e dëmtuar Kosovën në çdo hap të ecjes së saj, ka shkelur marrëveshjen e Brukselit që është zotuar se nuk do ta pengojë Kosovën në anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare. Kurse, në fakt, ajo edhe me rastin e UNESCO-s, por edhe me rastin e Interpolit, me politika të saj ogurzeza arriti të minojë inkuadrimitin e vendit tonë në dy organizata.

Të gjithë ata që nuk angazhohen në kushtëzimin e bashkëpunimit ekonomik me shtetin e Serbisë, i kontribuojnë pengimit të shtetndërtimit të Republikës së Kosovës.

Një marrëveshje ndërkombëtare që nuk ka mekanizëm të zbatimit të saj, nuk mund të quhet marrëveshje, po e përsëris, një marrëveshje ndërkombëtare që nuk ka mekanizëm të zbatimit, nuk mund të quhet marrëveshje. Andaj, i vetmi mekanizëm që Serbia mund ta kuptojë është ai i masave ekonomike, për çka ministri Shala, në mbështetje të Qeverisë, edhe filloi këtë, me besimin e plotë që ndalesa të tilla ose taksa të tilla do të vazhdojnë.

Prandaj, Bashkimi Evropian nuk duhet të na bëjë ftesë që këto taksa t'i heqim, përkundrazi duhet ta përshëndesë këtë, për shkak se Serbia nuk po e realizon ose nuk po i përmbahet asnjë marrëveshjeje që e ka bërë në Bruksel për Kosovën.

Ne si Kosovë nuk duhet të heshtim më përball veprimeve të disa shteteve të Bashkimit Evropian, të cilat në kundërshti me parimet bazë të Bashkimit Evropian, kur është fjala për Kosovën ndërtojnë politika antievropiane, duke mos e përkrahur një vend të ri, siç është Kosova, me perspektivë evropiane, por u bashkëngjitet shteteve të ashtuquajtura aziatike, të cilat kanë prirje të rrënojnë çdo vlerë të Bashkimit Evropian.

Se cilat janë ato shtete, që kësaj radhe edhe më herët penguan që Kosova të inkuadrohet në këto organizma, nuk është vështirë të gjenden, ato dihen, sepse votat e tyre janë evidentuar. Mirëpo

fjalën e kam për institucionet e Bashkimit Evropian, të cilat në njërin anën përpiqen ta ndihmojnë Kosovën në gjetjen e një zgjidhje me Serbinë dhe ta inkuadrojnë atë në mesin e institucioneve të saj, po në anën tjetër ato shumë pak po bëjnë kur është fjala për tërheqjen e vërejtjeve të këtyre shteteve planprishëse lidhur me pengesat që ia krijojnë Kosovës në drejtim të anëtarësimit të saj në organizma ndërkombëtarë.

Fundja, të gjitha ato shtete që penguan anëtarësimin e Kosovës në Interpol treguan se sa janë të interesuara për siguri, e që në fakt, ato edhe më tutje mbetën peng i politikave konservative ndaj shteteve të reja, duke i hapur kështu rrugë qarkullimit të lirë të kriminelëve, të cilët kanë kryer krime makabre jo vetëm në Kosovë, po edhe në Bosnjë, Kroaci edhe në shtete të tjera.

Është koha e fundit që institucionet tona kompetente, siç është Komisioni për Politikë të Jashtme, Komisioni për Siguri, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme të nxjerrin konkluzione të mirëfillta për këtë dështim të radhës, duke krijuar platforma të reja dhe politika të koordinuara me të gjithë faktorët e brendshëm dhe institucionet përkatëse të aleatëve tanë, në mënyrë që në momentin kur aplikojmë për këto anëtarësime, të kemi siguri për arritjen e objektivave të politikave tona.

Një tjetër përgjegjësi ndaj politikave të jashtme kanë edhe ambasadat tona.

Jam shumë e interesuar të di se gjatë procesit të lobimit të Kosovës për t'u anëtarësuar në Interpol, çka bëjnë ato? Sa nga diplomatët tanë që i kemi nëpër botë bënë takime, kërkuan jo vetëm votë për Kosovën, por edhe lobim nga shteti ku janë ata për shtetin tonë. Sa nga këto 1,4 milion iu ndanë ambasadave për lobim.

Ju lutem, diplomatë ku do që jeni, e sidomos ju që jeni nëpër qendra evropiane, të punoni pa u ndalur dhe me zemër që të krijoni fillimisht një imazh të mirë për vendin tonë, pastaj të loboni për njohje, të loboni për anëtarësime, në organizata të ngjashme e që Kosova e meriton.

Unë nuk dua që të jem aq kritike sa disa e meritojnë, sepse ka raste kur diplomatët tanë të gjithën që e bëjnë, janë akomodimet të delegacioneve tona nëpër vendet e tyre dhe udhërrëfyesit tanë për sallat e takimeve.

Duke mos më keqkuptuar, jo të gjithë janë të tillë, por ajo që unë po dua dhe besoj edhe qytetarët është që të jemi shumë të kujdesshëm se kë e zgjedhim ta dërgojmë që ta përfaqësojë vendin tonë ku punojnë atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Shemsi Sylaj.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Dështimet e njëpasnjëshme të diplomacisë kosovare po e shfaqin Kosovën si shtet pa vizion të qartë dhe të çorientuar.

Pas dështimit për pranim në Interpol, u pa se nuk ka pasur lobim të mirëfilltë për anëtarësim dhe Kosova po e dëshmon që nuk di t'i ruajë aleancat me shtetet e tjera.

Mungesës së përvojës diplomatike së të gjitha qeverive që nga shpallja e pavarësisë e këndeju shtua edhe një atribut tjetër, e shndërroam Ministrinë e Jashtme të sapoformuar në një kulaç për ndarje të pushtetit dhe i mbushëm ministrinë dhe përfaqësitë diplomatike me militantë partiakë, ku kriter i vlerësimit të performancës u bë nepotizmi, përkatësia partiake dhe korrupsioni. E përveç këtyre, filloi të dominojë mungesa e llogaridhënies, sidomos për pjesët më të mëdha të shërbimit të jashtëm diplomatik të Republikës së Kosovës. Ndërrimet e shpeshta politike në këtë dikaster të rëndësishëm të shtetit lëre që nuk kanë përmirësuar gjendjen e këtij shërbimi, por fatkeqësisht e kanë degraduar në vazhdimësi.

Është një fakt i ditur, por jo edhe i thënë, se shërbimi i jashtëm, diplomacia, sidomos ajo e nivelit të lartë, ka qenë shumë më mirë dhe më profesionale në fillim se sa që është tani. Plejada e ambasadorëve të zgjedhur me konkurs dhe atyre të emëruar me kalimin e kohës ka shkuar duke u degraduar, sepse apetitet private në pushtet për të rehatuar grupe të caktuar njerëzisht dhe bashkëpartiakësh, pa përfillur minimumin e kriteve të përcaktuara me ligj, ka shkaktuar dëme të pariparueshme në këtë shërbim. Për fat të keq, politika joparimore dhe me premisa korruptive nuk është mjaftuar në ndërhyrje vetëm në nivelin e lartë të përfaqësimit, por ka vazhduar të caktojë njerëz në shërbimin e jashtëm pa asnjë kriter, madje duke shkelur kriteret bazike. Për rrjedhojë, nuk mund të priten rezultate nga njerëz të caktuar në misionet diplomatike që marrin ato përgjegjësi si formë shpërblimi për ndonjë angazhim partiak apo për fushata elektorale. Derisa gradat diplomatike ndahen mbi baza të aftësive partiake e grupe, e derisa misionet llogariten si një mundësi për të rehatuar dikë në një vend pune, nuk ka çka të pritët më tepër nga ky shërbim, përveç kësaj që po shohim çdo ditë, pra dështime të njëpasnjëshme.

Dështimet e diplomacisë në përfaqësim dhe shtrirja e ndikimit për njohje të reja lidhen kryekëput me politikat e mbrapshta dhe të pastrukturuara për diplomatët gjithandej nëpër botë. Edhe pse ekzistojnë disa udhëzime të përgjithshme, diplomatët tanë nuk përgatiten për agjenda shtetërore dhe të fokusuara, sepse mungon koordinimi i brendshëm ndërmjet Qeverisë dhe institucioneve të tjera. Shpeshherë diplomatët tanë gjenden para sfidave të caktuara për tema që përçojnë mesazhe të ndryshme. Për shembull, ndryshe thotë dhe vepron Qeveria, e ndryshe presidenti, si përfaqësuesi i politikës së jashtme. Këto situata, që mjerisht kohëve të fundit janë të përditshme, reflektojnë një qasje joserioze dhe konfuze me pasoja për imazhin e Kosovës. Në anën tjetër,

ekziston edhe një joseriozitet dhe sjellje tërësisht e papranueshme e politikës së jashtme ndaj disa vendeve që e kanë njohur Kosovën, por që në momente të caktuara dalin dhe votojnë kundër, apo të paktën abstenojnë.

Shembulli i Japonisë, si një shtet që e ka njohur Kosovën dhe i cili ka kontribuar shumë për vendin tonë me ndihma dhe projekte të ndryshme zhvillimore, asnjëherë nuk është analizuar pse ky vend në momente të ndryshme nuk e përkrah Kosovën, shembulli më i freskët mund të jetë edhe ky për anëtarësimin në Interpol.

Të nderuar deputetë,

Fyerja që i është bërë shtetit duke dërguar nivelin më të ulët diplomatik si përfaqësues të shtetit, sekretar i parë apo i dytë për tre vjet rresht, medoemos që ka reflektuar edhe në pozicionin e këtij shteti karshi interesave të Kosovës. Në diplomaci është rregull, nuk mund të presësh seriozitet dhe trajtim të duhur kur ti sillësh me injorancë dhe fodullëk. Nuk po ndalem te kualiteti, që në këtë rast edhe mund të ishte i tillë, por po flasim për praktikën e përfaqësimit dhe respektimit. Ne nuk kemi as luks që për një shtet siç është Japonia të dërgojmë për tre vjet si përfaqësues kryesor një diplomat apo diplomate me gradën e sekretarit, kur i njëjti shtet na respekton dhe dërgon përfaqësim diplomatik të nivelit të duhur përfaqësues. Aspekti tjetër i përfaqësimit të diplomacisë ushtarake dhe policore që bëhet përmes dërgimit të atashëve është një risi e mirë që ka filluar të aplikohet në disa vende të ndryshme, mirëpo edhe këtu mungojnë koordinimi brendainstitucional dhe, për rrjedhojë, reflekton edhe në mision. Mungojnë udhëzimet e përbashkëta, format e funksionimit dhe raportimit, mbledhja e informacioneve dhe menaxhimit të buxhetit. Është paradoksale situata kur një atashë të dërguar në mision nuk i lejohet menaxhimi i buxhetit të planifikuar për mision, edhe pse ato mjete janë të paplanifikuara nga ministria në linjë. Mungojnë udhëzime dhe bashkëpunimi me institucionet e sigurisë së vendit, duke e lënë atashëun si një aset jo të shfrytëzuar mirë.

Mungesa e llogaridhënies në misione është fenomen në vete, i cili jo që është trajtuar ndonjëherë, por po vazhdon me ritëm të njëjtë me premisa të përkeqësimit. E gjitha kjo e ka bazën aty ku e nisëm, pra emërimi i diplomatëve dhe përzgjedhja e tyre në baza partiake dhe nepotizmi politik e familjar. Ambasadorët dhe udhëheqësit e misioneve, edhe nëse kanë vullnet të zbatojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore, hasin në pengesa serioze, sepse është politika ajo që interferon në stopimin e dukurive të ndryshme abuzive. Ambasadori shpeshherë ndihet i pafuqishëm në vendimet e tij, sepse jo rrallë ndodh që vartësit të kenë krahun më të fortë. Kjo dukuri nuk është risi dhe e paditur, mirëpo nuk thuhet edhe atëherë kur plasin skandalet të përmasave dhe përleshjeve fizike. Të mos harrojmë, një diplomat në buxhetin e Kosovës mesatarisht merr 4 500 deri në 5 000 euro në muaj dhe është dashur që të trajtohet shumë më me përgjegjësi rekrutimi i tij në diplomaci. Fatbardhësisht, ne kemi shumë djem dhe vajza të përgatitura mjaftë mirë për të kryer detyra të rëndësishme në shërbime të jashtme, të cilët do të përmirësonin imazhin, edhe ashtu të dobët, por deri më tani këto kadro janë eliminuar për shkak të ndërhyrjeve politike.

Të nderuar deputetë,

Diplomacia është përfaqësim politik, por edhe është ekonomi, tregti, arsim, shkencë, kulturë dhe sport, është gjeopolitikë e gjeostrategji. Përfaqësimi i jashtëm diplomatik është pasqyra e shtetit, prandaj duhen kuadro të përzgjedhura profesionalisht, e jo militantë politikë që nuk e dinë as historinë e kombit që përfaqësojnë. Duhet një angazhim shumë i madh që Kosova të prezantohet e përfaqësohet si shtet serioz duke ndërtuar edhe raporte e aleanca me shtete të caktuara nëpër botë. Nuk ka kohë më Amerika si deri më tani të kryejë punët tona, e ne të shkojmë prapa saj. Duhet ta kuptojmë se diplomacia nuk funksionon me të njohshëm, por mbi bazën e interesave dhe raporteve reciproke. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetes Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Në shkresën për debat të thirrur nga partitë opozitare LDK dhe VV, në qoftë se e shohim për çka është thirrur seanca dhe në qoftë se e shohim rezolutën e propozuar, së pari e shohim seriozitetin e krejt debatit që u mbajt sot, edhe për çka është thirrur vetë seanca.

Pa dashur të heq përgjegjësinë e ministrit të Punëve të Jashtme që për mua mendoj është e pajustificueshme pse nuk është këtu dhe arsyes pse ka treguar që nuk është këtu. Pra, mospjesëmarrja e këtij ministri vërtet është e pajustificueshme, sepse do të duhej të ishte të diskutojmë, të debatojmë edhe për diplomacinë e jashtme, edhe për dështimet tri herë radhazi, pra dy herë nga Qeveria Mustafa, një herë e dështuar në votim, herën tjetër të tërhequr, për mua mendoj edhe më keq dhe normalisht tani kur Kosova nuk u anëtarësua në Interpol. Kjo nuk është në interesin e askujt, por ne sot si Kuvend do të duhej të diskutojmë shumë më thellë për të dalë edhe me objektiva se cila është agjenda e Kuvendit në mbikëqyrjen e Qeverisë, por njëkohësisht edhe për të dhënë alternativa se cili është roli i Kuvendit dhe cila është, të mos them, ana pozitive që ka bërë Kuvendi në këtë drejtim, që unë mendoj që fare jo.

Në qoftë se shihet pra edhe ajo pjesëmarrje e VV-së që unë mendoj që ka qenë pozitive në qoftë se ka pasur përfaqësues, sepse po shihet që ka qenë edhe pjesëmarrja e tyre në konferencën e Asamblesë së Përgjithshme në Dubai, është mirë dhe ka qenë mirë të ishin edhe përfaqësues të subjekteve të tjera politike, sepse kur prezantohemi me të gjithë së bashku është shumë mirë dhe shumë më fort, në qoftë se vërtet do të kishim rezultate, por edhe meritat, edhe dështimet, pa i ikur përgjegjësisë së secilit, nuk duhet të na bëjnë të ndihemi mirë përballë një shteti serb, pra përballë Qeverisë së Serbisë, e cila po bën 'luftën e shtrigave' kundër lobimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, por më e dhimbshme për mua është që ne shumë herë pra si deputetë të subjekteve politike po e bëjmë ndoshta kundër vetë Republikës së Kosovës gjatë prezantimeve që po i kemi jashtë vendit. Kjo do të duhej të ishte shqetësuese për të gjithë neve. Në këtë vend

ku ne jetojmë, ku jetojnë fëmijët tanë, ku jeton qytetari i Republikës së Kosovës, por ku nuk jetojnë shumica e fëmijëve të deputetëve që shkollohen dhe jetojnë jashtë vendit.

Pra, të punojmë dhe të kemi edhe rezultate, por në interes të gjithë vendit, pra po flas kundër një shteti serb, ku edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës e kemi Listën serbe, e cila ka ardhur si parachutë dhe kjo Listë ka ardhur edhe si kontribut i shumicës që ka ndikuar, për shkak se nuk ka punuar, e them çdo herë, po flas në emrin tim personal, e kam thënë edhe e them, nuk i përfaqësojnë interesat e serbëve në Kosovë.

Por, kjo Listë është po e njëjta, po qe se do të bëhet me cilindo subjekt politik që tashmë është e gatshme LDK-ja për ta pranuar, sepse janë të njëjtit për të rrëzuar Qeverinë. Unë mendoj që nuk do të bëhen më të mirë. Pra, gjithçka çka po flitet sot, po flitet për dorëheqjen e Qeverisë. Po ju i keni mekanizmat, shfrytëzoni, e kemi thënë sa herë dhe, në fund të fundit, qeveritë nuk janë të përjetshme, por flitet për një qeveri, ish-Qeverinë Mustafa që ka qenë qeveri e fjetur që ka pasur legjitimitet, sepse unë konsideroj që secila qeveri ka legjitimitet derisa t'i merret nga Kuvendi, por një qeveri që ka pasur mbi 80 vota, e cila ka dështuar komplet dhe tani kemi përballë qeverinë Haradinaj, me ata numra që janë, askush nuk e konteston, Listën serbe dhe ministrat e Listës serbe unë mendoj që me rëndësi do të ishte, po të ishte e mundshme si ministër të përfaqësonte komunitetin serb deputeti i pavarur Petroviq.

Mirëpo, tani jemi këtu ku jemi, Kuvendi çdoherë duhet të ngre zërin edhe për dështimet, pse jo, por të flitet edhe për të mirat dhe vendimet e guximshme që ka marrë Qeveria Haradinaj, pra për të treguar seriozitetin e shtetit me vendimin e fundit, por edhe të parafundit, por sidomos të fundit, që ka vendosur 100% taksën për produktet serbe. Mirëpo, mos harroni, nuk është folur shumë për një vendim që qytetarët e Republikës së Kosovës me Qeverinë Haradinaj që në muajin dhjetor të vitit të kaluar nuk paguajnë më buxhet që kanë paguar deri në vitin 2016, rreth 50 milionë euro për rrymën që u është faturuar qytetarëve, pra që ka ardhur nga pjesa Veriore. Pra, Qeveria Haradinaj që nga dhjetori i vitit të kaluar buxheti i Kosovës më nuk paguan, këtë e them, pra për të treguar edhe një herë seriozitetin, sepse në 2016-tën Avokati i Popullit pati ngritur një shqetësim, mirëpo Qeveria Mustafa absolutisht nuk e pati guximin të përballë bash me asnjë vendim të guximshëm, në interes të vendit, pra në raport me shtetin serb.

Në këtë rast, edhe një herë po them që po, është e drejtë e opozitës të kërkojë dorëheqjen e Qeverisë dhe këtë e kemi bërë edhe ne, është demokratike, mirëpo të shfrytëzohen mekanizmat, të cilët dikush mendon që i di mirë, e që mendoj që nuk i di fare, sepse gjithë brumi ose sot ajo çka u diskutua është komplet një bashkësi boshe, me përjashtim të diskutimit të zotit Topalli, për të treguar seriozitetin e Kuvendit. Pra, nëse duam të jemi seriozë, po, kemi shumëçka për të diskutuar, por flisni për vendimet e mëdha të Qeverisë dhe, të paktën, në qoftë se nuk i duartroktoni, pranoni që janë marrë vendime të kësaj Qeverie, të kryeministrit Haradinaj, që askush nuk e ka guximin për t'u përballur, e aq më tepër që po kërkon një konsensus të gjitha

subjekte politike përballë Serbisë sa i përket dialogut. Vendosni objektivat e qarta sot të gjithë, si Kuvend, edhe nesër, edhe me rezoluta që kanë mbetur peng, pra në këto dy raporte të dy shteteve të jemi seriozë dhe ejani të diskutojmë për shumë tema të tjera që kanë nevojë qytetarët e vendit. Pra, serioziteti nuk tregohet duke kërkuar dorëheqjen e Qeverisë, sepse ju e dini se cilët janë mekanizmat dhe nuk e keni këtë fuqi dhe nuk mund ta bëni asnjëherë, sepse e keni pafuqinë brenda juve dhe nuk jeni seriozë, por mos na maltretoni neve si deputetë, mos i maltretoni as qytetarët e Kosovës, po tregoni fytyrën e vërtetë edhe një herë se kush e ka guximin për të marrë vendime të mëdha në interes të vendit.

Atëherë mund të flasim edhe për të tjera çështje që janë me interes, edhe për arsimin, shëndetësinë, edhe pse ka një rritje prej 12% për sektorin e arsimit, mirëpo ka shumë nevojë arsimit, shëndetësia dhe shumë faktorë të tjerë, pra fusha të tjera për t'u rregulluar dhe për t'u investuar shumë më shumë. Në këto raporte, pra, edhe një herë, mund të thërrasim debate për cilindo fushë, mirëpo ky debat me gjitha këto diskutime edhe një herë po them nuk sjell asgjë tjetër vetëm se kësaj rezolute të propozuar sot mund t'ia shtoj vetëm edhe një fjali, pra rezoluta e propozuar me kërkesën e të dy subjekteve politike, por megjithatë unë konsideroj se i shkon për shtati vetëm LDK-së si një fushatë parazgjedhore për zgjedhjet e brendshme të kandidatëve pretendentë për të parin e partisë që unë i uroj zgjedhje demokratike të mira, cilido që të zgjidhet kryetar i LDK-së.

KRYESUESI: Tani fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne të gjithë jemi dëshmitarë të dështimeve të njëpasnjëshme të Kosovës në raport me Serbinë, duke filluar nga decentralizimi në baza etnike (në Kosovën e shpallur multietnike, ku 92% e qytetarëve janë shqiptarë), shumicën e dyfishtë të votës në Kuvendin e Kosovës, formimin e komunave me shumicë serbe, të cilave u janë dhënë kompetenca shtesë. Dialogu për asociacionin e komunave me shumicë serbe që çon drejt realizimit të projektit serb për ndarjen e Kosovës, që kohëve të fundit po na prezantohet si korigjim i kufirit.

Është detyrë e Kuvendit që me gjakftohtësi t'i analizojë efektet e marrëveshjeve me Serbinë dhe në bazë të analizave, të nxjerrë edhe përfundimet e duhura. Bazuar në fushën njohuritë që kam në fushën e politikës së jashtme, jam i bindur se segmentet që merren me politikë të jashtme në vend nuk koordinohen në mes vete, se presidenti, ministri për Punë të Jashtme, ministrja e Integritimit Evropian, kryeparlamentari dhe disa të tjerë e kanë privatizuar politikën e jashtme të vendit. Këta përgjegjës të institucioneve as nuk kanë ndonjë strategji dhe as plan se si t'i realizojnë interesat e vendit karshi Serbisë. Dhe, as nuk e njoftojnë opinionin në lidhje me atë çka po bisedojnë, por rezultatet po i sheh i tërë opinionin. Se të njëjtit politikën e jashtme e

konsiderojnë pronë të tyre dëshmojnë faktet si në vijim: ministri i Punëve të Jashtme në vazhdimësi po refuzon të raportojë në Komisionin Parlamentar të Punëve të Jashtme, Komisionin e Integriteteve Evropiane e së fundi edhe në Kuvendin e Kosovës, kurse presidenti i vendit i ka dhënë vetes të drejtë të hapë çështje më të rëndësishme për një vend, siç është ndryshimi i kufijve, pa mandatin e Kuvendit, derisa në këtë situatë shumë të rëndë e serioze për vendin kryeministri është dorëhequr nga angazhimi në politikën e jashtme, bazuar në këtë që u tha del se gjatë viteve të pasluftës në tavolinën e bisedimeve Serbia na ka mundur dhe po ashtu dihen arsyet pse na ka mundur.

Nëse pajtohemi se me strategjinë, angazhimin dhe përfaqësimin tonë në fushën e politikës së jashtme jemi palë humbëse, e kjo dëshkohet me faktorizimin e Serbisë brenda Kosovës, me dështimin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, si UNESCO, INTERPOL, me vonesën e liberalizimit të vizave, zvogëlimin e njohjeve ndërkombëtare dhe shumë argumente të tjera. Por, dështime ka edhe në fushat e tjera, si që është arsimi, pasi që diplomat e universiteteve tona nuk njihen jashtë vendit, edhe për shkak të politikës së gabuar të Kosovës, siç është edhe rasti me diplomat e rinjve nga Lugina e Preshevës. Por, nuk mjafton vetëm të pajtohemi me këto fakte të pakontestueshme, por patjetër duhet ta ndryshojmë strategjinë, ta institucionalizojmë politikën e jashtme, ta shumëfishojmë punën, angazhimin dhe t'i ndërrojmë përfaqësuesit që konstatohet se kanë dështuar në politikë të jashtme.

Pasi ta kemi analizuar situatën në të cilën jemi, ta hartojmë një strategji që do të na nxjerrë fitimtarë karshi Serbisë. Ta rrisim vëllimin dhe kualitetin e punës dhe ta zgjedhim ekipin më të mirë të mundshëm që e kemi dhe t'i obligojmë të njëjtit që në vazhdimësi të koordinohen mes veti dhe të raportojnë para këtij Kuvendi e qytetarëve për punën që po e bëjnë. Ky Kuvend, po ashtu duhet të vendosë nëse ia vlen të zhvillohet dialogu me Serbinë, derisa Serbia nuk heq dorë nga politika armiqësore që po e udhëheq kundër Republikës së Kosovës, jo vetëm me propagandën kundër pranimin në institucionet ndërkombëtare, por në të gjitha fushat. Këtë mund ta arrijmë vetëm nëse me gjakftohtësi e pa anime partiake e analizojmë situatën dhe pajtohemi që vendimi i djeshëm i Qeverisë së Kosovës ka qenë i drejtë, edhe pse i vonuar, po ashtu edhe vendimi i mëhershëm në lidhje me ushtrinë ka qenë i drejtë dhe ky ligj duhet të vijë për herë të dytë dhe të kalojë në Kuvend të Kosovës, por duhet të pajtohemi edhe për dështimet në politikën e jashtme dhe të propozojmë masa të duhura që e nxjerrin vendin nga kjo situatë. Në këtë situatë, pozita do të duhej ta shqyrtojë seriozisht edhe rezolutën e propozuar nëse pajtohemi se interesi i vendit është mbi interesat tona partiake, mbi interesat tona personale dhe që të gjithë seriozisht jemi të interesuar të dalim nga kjo gjendje dhe të mos dalim përherë humbës e ta arsyetojmë humbjen, por të fitojmë karshi Serbisë, sepse edhe ashtu jemi në anën e drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë!

Të nderuar qytetarë,

Fitorja gjithmonë ka shumë baballarë e humbja gjithmonë është jetime. Liderët gjithmonë marrin edhe meritat në rast fitoreje, por marrin dhe përgjegjësitë. Kjo qeveri e tanishme nuk ka lider që e merr përgjegjësinë edhe në rast të dështimeve, por gjithmonë kemi liderë të vegjël, të cilët ngarendin që të mundohen të marrin merita dhe të projektojnë veten para kamerave, para qytetarëve, si kinse ata ishin ata vendimmarrësit kryesorë për të marrë anëtarësimin në organizatat e ndryshme, siç është Interpoli. Në të shumtën e rasteve, e dimë që anëtarësimet në këto organizata varen edhe nga faktorët gjeopolitikë e gjeostrategjik në botë, por gjithmonë i kemi liderët, të cilët në momentet kur ka dështim shtiren sikur janë jetimë, sikur s'kanë përgjegjësi dhe prandaj, kur nuk ka liderë, nuk presim edhe përgjegjësi.

Prandaj, edhe këtu në këtë Kuvend, shumë nga deputetët tanë kërkuan përgjegjësi, por kjo nuk do të ndodhë, sepse nuk kemi aq liderë të pjekur që të japin dorëheqje, e cila është një akt shumë moral për raste të tilla, siç është ky dështim dhe të tregojnë që nëse ishin të gatshëm t'i marrin meritat, ta marrin edhe përgjegjësinë. Prandaj, unë jam shumë skeptik që do të ketë përgjegjësi, por së paku kërkoj nga instancat më të larta të kësaj Qeverie që të iniciojnë përgjegjësi për disa ambasadorë. Unë kërkoj përgjegjësi nga ambasadorët e vendeve, të cilat e kanë njohur Kosovën dhe dje nuk votuan pro Kosovës, si është e mundur që një shtet mik, një mik historik i Kosovës, si Hungaria, nuk voton pro anëtarësimin në Interpol, pastaj si Japonia, e cila ka dhënë shumë për Kosovën si në aspektin e ndihmave, edhe në aspektin politik dhe këtu përgjegjësia kryesore duhet nisur nga ambasadorët e atyre vendeve. Çka janë duke bërë ata ambasadorë atje? A kanë njohuri? A kanë kontakte? A e kanë informuar Qeverinë e Kosovës se ky shtet është duke votuar kundër, por unë, siç po e shoh, se çfarë komunikimi ka këtu brenda kësaj qeverie, e di që edhe komunikimi brenda institucioneve diplomatike të ndryshme nëpër botë është zero dhe nuk pres që ka një lloj komunikimi të tillë, apo një lloj diplomacie të vërtetë. Dhe, të shumtën e rasteve, të gjitha ato shpenzime enorme që jemi duke bërë nëpër ambasada janë shpenzime të pajustificueshme dhe nuk po i arsyetojnë gjithë ato shpenzime që bëhen për shumë ambasada në botë.

Prandaj, unë si propozim këtu para kohës së votimit të buxhetit, të cilin e kemi në ditët në vijim, unë propozoj që ne të iniciojmë zvogëlimin e buxhetit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe ta ridestinojmë buxhetin në vend të ambasadave, ta ridestinojmë në drejtim të ambasadorëve të vërtetë të Kosovës dhe ambasadorët e vërtetë të Kosovës sot i kemi sportistët dhe mendoj që nëse një pjesë të buxhetit do ta harxhonim, siç jemi duke e harxhuar për diplomaci të dështuar, ta ridestinojmë në sport, besoj që edhe emri i Kosovës do të lartësohet më lart edhe në diplomaci. Dhe, pse jo ndoshta ne të iniciojmë që Ministria e Punëve të Jashtme të bashkohet ndoshta edhe me një ministri tjetër, ndërsa Ministrinë e Sportit ta kemi ministri të veçantë, ku do të përkrahej edhe më shumë, sepse ata janë dhe po mbesin të vetmit ambasadorë që po ia zbritin fytyrën Kosovës, të cilën shumë politikanë e shumë diplomatë nuk po arrijnë dot ta bëjnë. Ne kemi

shumë për të folur dhe shumë për të diskutuar, por mendoj që ky dështim është edhe një mësim për të ardhmen dhe për ta rishikuar tërë politikën e jashtme tonën, të cilën e kemi në botë dhe ta shikojmë se ku janë ngecjet tona. E mira do të ishte që ne të mësonim nga mësimet e të tjerëve, por në këtë rast edhe të mësojmë edhe nga mësimet tona, ta ndryshojmë dhe ta përmirësojmë këtë diplomaci, këtë politikë të jashtme, të cilën deri më tani veçanërisht në Qeverinë e tanishme Haradinaj është një politikë e jashtme tërësisht e dështuar dhe politika e jashtme ka ardhur në nivelin më të ulët të mundshëm në historinë më të re, mund të them se politika e jashtme e Kosovës ka ardhur në nivelin edhe më të ulët sesa që ishte edhe në kohën e apartheidit serb, që ishte në vitet e nëntëdhjeta. Dyert e Kosovës në kohën e viteve të '90-ta në kohën e presidentit Rugova kanë qenë të hapura anekënd, deri edhe te Mbreti i Spanjës, i cili edhe sot e kësaj dite nuk e njih Kosovën, ndërsa dyert e Kosovës në një shtet ku ekzistojnë ambasada, ku ekzistojnë diplomatë të cilët marrin paga enorme janë të mbyllura dhe sukseset e tyre jo që janë suksese, por janë veprimtari të dështimit dhe dështimit që jemi në vazhdimësi, por që do të përcillet edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Fatmir Kollçaku. Regjia, Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Po çfarë të themi sot më tepër këtu për diplomacinë e haviarit dhe të kazinove, çfarë të themi për delegacionet e shumta të pajustificueshme në numër që shkojnë dhe rezultati i lobimit është zero. Çfarë të themi për dështimin e anëtarësimit në Interpol, çfarë të themi për dështimin e sigurt sa i përket liberalizimit të vizave së paku deri në vitin 2020? Çfarë të themi për perspektivën e munguar evropiane?

Shumëçka u tha sot dhe u tha se ne po i maltretojmë qytetarët me këtë temë. Po si është e mundur të mos debatohet në institucionin më të lartë vendimmarrës në vend për situatën në të cilën ndodhet aktualisht shteti ynë.

Çfarë mund të themi më tepër ku një Qeveri merr një masë ad hoc përderisa me vite e ka përkëdhelur pikërisht këtë partnerin më të ledhatuar deri tani dhe krejt monopolin e tregut dhe biznesit në Kosovë e kanë pasur pikërisht bizneset që kanë tregtuar me Serbinë dhe e kanë pasur monopolin mall i Serbisë në shtetin tonë. Dhe sot këshilltarët e kryeministrit deklarojnë se ne kemi menduar se Serbia do ta ndërrojë qasje, do të thotë kanë pritur dhe tanimë janë bindur, pa pikërisht pas dështimit, debaklit në Interpol, ata u bindën që vërtet Serbia nuk do të ndryshojë qasje dhe tashmë na kanë sjellë në një gjendje ku me vite e kanë diskriminuar pikërisht prodhuesin vendor, i cili gjatë viteve ka qenë e mundur të përgatitet dhe të përkrahet që sot të jetë i gatshëm që ta plasojë mallin në treg dhe mos ta ndiejmë ne kurrfarë krize këtu në vend, bile së paku për produktet më të rëndësishme. E ne si shtet që është dashur kryesisht të subvenciojmë bujqësinë e kemi anashkaluar plotësisht.

Mirëpo, unë sot këtu nuk do të flas gjerë e gjatë për diplomacinë, sepse po e theksoj veç një çështje, me diplomatët tanë anemikë anekënd botës, d.m.th. ambasadat dhe konsullatat të cilat edhe në kërkesën e vetme të Komisionit për Integritim Evropian, i cili aspak ose fare nuk është i angazhuar në çështjen e lobimit, kur tenton që ta aranzhojë qoftë edhe një takim të vetëm në ndonjë prej shteteve që kanë rol të rëndësishëm sa i përket lobimit për çështjen për shembull të liberalizimit të vizave nuk arrin të aranzhojë qoftë edhe një takim. Do të thotë në kërkesën e parë, përgjigje kemi çuar shkresë me shkrim dhe nuk kemi marrë përgjigje. Ja cilat janë kontaktet e diplomatëve tanë me përfaqësuesit e lartë të BE-së, me institucione të ndryshme dhe çfarë bëjnë ata atje, në përfaqësim, në lobim.

Do të thotë thjesht në shopping këtu kanë shkuar këtu shumë deputetë, por Komisioni, se këtu iu përgjigja dikujt që foli, do të thotë Komisioni për Integritim Evropian edhe një herë po e ritheksoj nuk është angazhuar fare. Nëse ju mendoni që këtij komisioni nuk i takon, e përsëritet këtë vendim. Kush, kush foli.

Do të flas për një çështje tepër të rëndësishme që është moskoordinimi Kosovë-Shqipëri në politikën e jashtme. Ju e dini që tashmë do të ndodhë një takim si vazhdimësi i takimeve të dy qeverive dhe unë shtroj pyetjen, edhe pse tashmë është fakt i njohur publikisht që Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës nuk konsultohet e as nuk bashkërendohet me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

Së fundmi pamë përmes rrjeteve sociale shkëmbehen vërejtjet dhe opinionet me zyrtarët e Shqipërisë, ndërsa si duket nuk ka takime të drejtpërdrejta ku nuk është dashur për shembull t'i jepet vërejtja ambasadores së Shqipërisë në OKB lidhur me votën e Libisë në Interpol, po po shfrytëzohen rrjetet sociale.

Do të thotë ky është një shembull i plotë se në çfarë gjendje kemi ardhur. Nuk ka pasur fare koordinim në dialogun në Bruksel për shtatë vjet me radhë. Nuk ka pasur koordinim në Këshillin e Evropës me përjashtime të pakta. Nuk ka pra as koordinim në ambasada e konsullata. Nuk përdoret as infrastruktura e as burimet njerëzore të shërbimit diplomatik të Shqipërisë në vendet që s'e njohën Kosovën deri tani, edhe pse prej vitit 2011-2012 ka marrëveshje për të bashkuar forcat në shërbimin diplomatik, ende ka pak raste të tilla, shumë pak. Nuk shfrytëzohen delegacionet e Shqipërisë në organizata ndërkombëtare për të ngritur çështje të Kosovës, por edhe të Preshevës, nuk ka fushatë të koordinuar lobimi, mund të përfundojmë këtu.

Nuk ka qoftë edhe një tekst të përbashkët si strategji për politikën e jashtme. Do të thotë, ne do ta shiqojmë edhe do të jemi dëshmitarë edhe të një takimi të radhës të dy qeverive dhe atë çfarë presin qytetarët e Republikës së Kosovës kur ne kemi folur këtu për bashkim kombëtar, kanë thënë se nuk është e nevojshme në këtë fazë të ndodhë sepse ne vetë mund t'i fshijmë këta kufij

dhe t'i bëjmë të parëndësishëm. Çfarë po ndodh në realitet? Po mbahen takime, po përshëndeten me fjalë të mira dhe pastaj secili e shikon punën e vet.

A thua që diplomacia e jonë që e konsideron veten aq të zgjuar dhe nuk e sheh të nevojshme të konsultohet me zyrtarë të Shqipërisë të cilët kanë shumë më tepër përvojë në politikën e jashtme, në çështjet e lobimit dhe shtrohet pyetja por nuk kemi kujt t'ia shtrojmë sot këtu sepse për momentin ajo që është plotësisht e pakuptueshme në këtë debat, nuk ndodhet në këto momente Kryeministri e aq më pak nuk ndodhet ministri i Punëve të Jashtme, ku këtu është një vërejtje publike, që në Komision për Integritet Evropian ministri nuk e ka parë të udhës asnjëherë të vijë e të raportojë përkundër ftesave të shumta që i janë adresuar dhe ne si Komision patëm marrë edhe qëndrim që të dalim publikisht me vërejtje i cili si duket është aq i zënë në lobim, i cili po shihet çfarë po rezulton. Jo që nuk ka njohje, po fatkeqësisht ka degradim, tërheqje të njohjeve të cilat po bëhen përpjekje të fshihen, por është e pamundur të ndodhë kjo dhe po e ritheksoj diplomacia jonë është e orientuar duke i nënçmuar të vegjlit, e duke vrapuar pas të mëdhenjve nëpër korridoret e institucioneve të larta dhe duke u kënaqur me shtrëngim duarsh, ndera pastaj kur pësojnë humbje kërkojnë ta ndajmë së bashku humbjen.

Ne ftojnë këtu për njëfarë konsensusi, për njëfarë mirëkuptimi, për një situatë ku ndodhemi, por jo ne nuk mund ta ndajmë fajin, sepse faji nuk është i përbashkët. Faji ka adresë dhe kërkesa për këtë debat me një pikë të vetme që ne e dimë që së paku si akt moral kjo qeveri duhet të dorëhiqet, përndryshe është e qartë se qytetarët e Republikës së Kosovës tashmë po e shohin që derisa kjo pre ende ka mundësi të gllabërohet, apo ky shtet derisa ka ende mundësi të gjymtohet, me siguri se nuk do të dorëhiqet kjo qeveri, por me siguri do të gjejnë edhe mundësi edhe zgjidhje të tjera, sepse vërtet ka ardhur koha që të vjen një qeveri me e përgjegjshme, një qeveri që në fakt do të japë dëshmi që ia do të mirën qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe e cila nuk do të thirret vetëm në sukseset e së kaluarës, por do t'i kthehet edhe së ardhmes, sepse ne në këtë mënyrë nëse degradojmë me siguri do të vazhdojmë të kthehemi 20-30 vjet në të kaluarën, se asnjë rezultat pozitiv nuk jemi duke e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës ia jap fjalën deputetit Korab Sejdiu.

KORAB SJEDIU: Të dashur qytetarë!

Të nderuar kolegë, kryesues,

Faleminderit që edhe pse po na merr malli, sot je duke e udhëhequr seancën ashtu si duhet pra duke filluar me kohë dhe duke e trajtuar rregulloren si diçka që vërtet meriton respekt. Faleminderit!

Unë të tregoj të drejtën, unë isha në dyshim a të flas apo jo, sepse qëllimi i kësaj seance ka qenë që të gjithë ne këtu që jemi përfaqësues të qytetarëve të Republikës së Kosovës të kemi mundësi t'i japim kritikën tona konstruktive lidhur me një çështje shumë të rëndësishme që është ajo e

punëve të jashtme edhe eventualisht ndonjë këshillë apo propozim sesi të përmirësohet gjendja një këtë sektor.

Fatkeqësisht, me përjashtim të Kryeministrit që erdhi sot një kohë të shkurtër sot në mëngjes dhe na mbajti ligjëratë, nuk po e shoh askënd këtu gjatë tërë ditës që është, qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi përgjegjës për punët e jashtme, së paku në sektorin e ekzekutivit dhe kjo më bën të dyshoj se a ia vlen të diskutohet për këtë çështje kur ata nuk janë prezentë pasi që edhe me gjasë nuk i dëgjojnë edhe fjalimet që i bëjnë.

Sidoqoftë po vazhdoj me disa pika dhe kam dëgjuar me vëmendje fjalimet e kolegëve këtu dhe është pak për t'u befasuar me tonalitetin befasues që e kemi sa i përket dështimeve dhe mungesës së suksesit në këtë sektor. E them këtë sepse punët e jashtme si çështje në vete nuk ekzistojnë si ishull, pra janë një nga sferat e shoqërisë sonë me të cilat ballafaqohemi.

Kur flasim për punë të jashtme po flasim për një produkt të cilin përfaqësuesit tanë tentojnë t'ia përfaqësojnë botës, qoftë për pranim politik, ekonomik, kulturor, sportiv e kështu me radhë. Në këtë aspekt duhet të analizojmë pra çfarë produkti po tentojmë t'ia prezantojmë botës dhe kush po ia prezanton atë produkt. Produkti që ne po e prezantojmë është vendi ynë, një vend i cili është ndërtuar deri më tani në atë që e përfaqëson Presidenti ynë, që e përfaqëson kjo Qeveri, krerët e shtetit tonë e kështu me radhë. Ajo që ata përfaqësojnë është një shëndetësi e sëmur, një arsim i degraduar, një qeveri që bashkëjeton me krimin, edhe besoj lista është shumë e gjatë. Pra, pavarësisht kush e prezanton këtë produkt, me gjasë do të ishte shumë e vështirë ta bindim botën që të na pranojë në rangun e shteteve të civilizuarra dhe të zhvilluara.

Në anën tjetër të flasim pak për atë që do duhej të ishte një ekip i koordinuar mirë, pra ata të cilët na përfaqësojnë neve karshi homologëve në botën e huaj. Në mungesë të kësaj, ne i kemi disa njerëz të çakorduar. Kemi një President i cili ka dalë tërësisht prej binarëve dhe i cili në vend që të lavdërojë produktin, vendin e vet, ai në fakt argumenton te të tjerët se nuk ka fare produkt, se ai nuk ekziston, pra e cenon rrënjësisht vetë shtetësinë e Kosovës. Kemi edhe persona të tjerë të cilët udhëtojnë nëpër botë pa ndonjë koordinim, pa ndonjë akordancë, me ndonjë strategji gjithëpërfshirëse. Duke i shtuar tërë kësaj lobimin personal për të cilin shpenzohen miliona nga buxheti i shtetit për të rikuperuar imazhin e disa personave që kot shpenzohen të holla, sepse imazhet e tyre janë aq të degraduara para syve të homologëve të tyre nëpër botë që as një miliard euro nuk do t'i kthente në sy pozitiv.

Në vend të investimit në organizma siç ishte dikur NAKU, i cili u shpërbë për favore të investimeve në lobim personal, ne sot shpenzojmë të holla në agjenda të cilat as vetë deputetët nuk e dinë se nga po shkojnë këto të holla. As qytetarët nuk e dinë dhe në fakt nuk vjen as vetë Presidenti të raportojë para Komisionit Hetimor lidhur me këto shpenzime marramendëse. Shtoj

kësaj edhe agresionin e jashtëzakonshëm dhe kohëve të fundit të intensifikuar nga Serbia kundër Kosovës që synim e ka rrënimin e Kosovës edhe nga brenda edhe nga jashtë.

Nisma jonë javën e kaluar ishte që të kërkohej një debat parlamentar për një embargo të përgjithshme edhe në nivel ekonomik, por edhe politik. Është mirë që Kryeministri ka marrë një vendim për këtë taksën prej 100 për qind në produktet serbe, mirëpo fatkeqësisht nuk e di se a është menduar për dhënien e lehtësirave për produktet zëvendësuese që do t'i nevojiten Kosovës me qëllim që konsumatori dhe qytetari jonë të mos bart barrën e këtyre shpenzimeve shtesë.

Ku shkojmë tash duke pasur parasysht që kemi këtë gjendje aktuale?

Unë kisha propozuar që sa më parë që është e mundur të mbajmë një seancë në të cilën do të kalojmë së paku pakon e ligjeve për ushtrinë. Menjëherë pas asaj të bëjmë një mocion mosbesimi ose të tërhiqet kjo Qeveri, me qëllim që njerëz shumë më meritorë të vijnë, jo vetëm në Qeveri, por edhe në këto ulëse që të na zëvendësojnë neve që jemi këtu, dhe natyrisht ata që janë pasardhësit tanë të bëjnë një strategji të mirëfilltë, jo vetëm për punët e jashtme, por për zhvillimin e vendit në tërësi, sepse ankesat që kemi duke i bërë thjesht janë që edhe fëmijët 6-7 vjeçar i kanë mësuar përmendësh, por qëllimi ynë duhet që të japim zgjidhje dhe pikërisht këtë besoj që nuk ka mundësi ta bëjë ky konstelacion qeveritar dhe shpresoj që i ardhmi do ta ketë këtë. Së paku, më keq se tash nuk besoj që do të jetë.

Prandaj, ju lus që sa më parë që është e mundur të vazhdojmë në këtë drejtim dhe të arrijmë në një stad ku mund të mendojmë për një Kosovë pak më të mirë dhe për një Kosovë që e meritojnë qytetarët e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ndërsa tani radhën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Dështimi në Interpol dhe dështimet me njohje dhe prapakthimi i procesit të njohjeve dot të duhej që të përkthehej me përgjegjësi nga dikush. Do të duhej të kishim dorëheqje dhe do të duhej të kishim llogaridhënie konkrete në lidhje me këtë çështje. Në mungesë të dorëheqjes nga ministri i Jashtëm, është normale që t'ia kërkojmë së paku shkarkimin e tij. Në mungesë të vullnetit të shkarkimit të ministrit të jashtëm, e kemi shumë të logjikshme që të kërkojmë nga Kryeministri që të dorëhiqet vetë.

Nëse kemi hyrë në njëfarë qorrsoaku, dikush duhet të japë llogari. Në qoftë se Qeveria konsideron që pse nuk i paskemi tash numrat për ta rrëzuar, dhe ata tash meqenëse ne nuk i kemi numrat, ata e kanë të drejtën të bëjnë çka të duan, atëherë është normale nga ana jonë që ne ta kërkojmë dorëheqjen e tyre dhe të përpiqemi në vazhdimësi t'i bëjmë këta numra.

Por çka ndodhi tash pas dështimit në Interpol? Dështimi në Interpol i solli në një situatë të rëndë. Të gjithë janë të vetëdijshëm që në çfarë pozicioni është sot Kosova kudo. Jemi të vetëdijshëm se nuk ka as liberalizim të vizave, edhe pse dhamë territor për këtë punë. Premtimet u bënë, por nuk ka asnjë rezultat dhe Qeveria në këtë situatë e mori vendimin që produkteve nga Serbia t'ua ngritë taksën nga 10 për qind në 100 për qind, pikërisht në momentin kur e patëm dështimin në Interpol, si kundërpërgjigje tash ndaj Serbisë, thua se tash e kuptuam Serbinë se cila na qenka. Ne e dimë Serbinë cila ka qenë. Lëvizja Vetëvendosje që nga viti 2006 kërkon bojkotim të mallrave të Serbisë kërkon dhënie të reciprocitetit karshi Serbisë dhe pikërisht mbi parim do të duhej të bëhej të vendosje edhe kjo taksë. Kur taksa vendoset sepse Serbia na pengoi tash neve në Interpol, i bie që një sinjal më të voglin Serbia po ta japë ne paskemi për ta hequr atë taksë, se u bë edhe pa plan edhe brenda natës kështu. Kjo taksë do të duhej të vendosje shumë më herët, do të duhej të vendosej marrëdhënie reciprociteti me Serbinë shumë më herët, dhe jo kështu brenda natës, pa i pasur parasysh madje as pasojat.

Tash nga Qeveria ne kërkojmë të jenë të vendosur. E ka mbështetjen tonë. Ne që moti kemi menduar se është dashur të bëhet një gjë e tillë. Që moti kemi thënë dhe kur ne kemi thënë, të gjithë na kanë quajtur pak si anakronikë, por ja që tash erdhën të gjithë në ato qëndrimet e njëjta që i pati Lëvizja Vetëvendosje shumë vite më parë. Po shumë mirë, mirë u bë që e morët së paku pra këtë vendim. Çka u shtyu nuk po e dimë, mbase po e dimë sepse keni qenë në siklet pas Interpolit, por sidoqoftë ne ju mbështesim në këtë punë, por kërkojmë nga ju që të jeni këmbëngulës. Të jeni këmbëngulës dhe të vendosur dhe vërtet ta mbani tash këtë taksën qind për qind.

Unë kam qenë i mahnitur nga Kryeministri dhe përgjithësisht ndaj çështjes së demarkacionit atëherë. Këmbëngulja asokohe e Kryeministrit për çështjen e demarkacionit, jo vetëm mua, por shumë aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje i pat mahnitur. Të gjithë e kemi çmuar dhe e kemi respektuar jashtëzakonisht shumë për qëndresën e tij, por ja që në fund u votua demarkacioni, me premtimin se do të bëhet edhe liberalizimi i vizave. Dhe liberalizimi i vizave nuk u bë.

Prandaj ne kërkojmë nga ju të Qeverisë që të jeni këmbëngulës dhe të mos na e bëni prapë si për demarkacion. Qëndroni në këtë pikë dhe mbajeni deri në fund, edhe pse do të donim që ky reciprocitet të vendosej mbi një parim dhe parimi duhet të jetë reciprociteti. Jo thjesht një masë si të them njëfarë refleksi ndaj një veprimi, dhe kur diçka është reflexive, ti nuk i mendon as pasojat pastaj. Këto pasoja janë ngritja e çmimit të bukës. Nëse kemi një shtet që për vite të tëra ka ndërtuar një varësi ekonomike nga Serbia nga mallrat e Serbisë dhe përnjëherë e merr këtë masë, duhet ta kemi të qartë se kjo do të ketë pasoja te qytetarët.

Prandaj Qeveria duhet tash të marrë menjëherë masa paralele me këtë, që ta subvencionojë çmimin e bukës, dhe mos të na vjen puna që qytetarët e varfër, komplet këtë trimëri e këtë guxim të Qeverisë ta bartin ata vetë mbi supe, sepse të gjithë të tjerët kanë pare për ta përjetuar këtë

bllokim, prandaj është detyrë e Qeverisë sot që ata për të gjitha produktet elementar të cila kanë për ta rënduar shportën e konsumatorit, të marrin masa dhe të subvencionojnë këto produkte dhe të subvencionojnë çmimin e bukës e të vajit e kështu me radhë.

Paralel me këtë mendoj që do të duhej të kihet parasysh edhe një element tjetër. Meqenëse sot Kryeministri nuk është këtu tash momentalisht, unë mendoj që do të duhej mbase t'ia kërkonte edhe kryeministrit shqiptar Edi Ramës që ta shqyrtojë edhe ai mundësinë e masave ndaj Serbisë. Sepse të mos harrojmë që Serbia jo vetëm që na ka bllokuar neve, por po e bllokon edhe Shqipërinë. Është linja e interkonjeksionit, e cila nuk po mund të bëhet për shkak të Serbisë, në ndërkohë që Shqipëria ka hyrë në borxh për këtë, për ndërtimin e kësaj linje. Prandaj, e rendit do të ishte që ne të bashkëpunonim dhe të koordinoheshim bashkë edhe me Shqipërinë në këtë përpjekje të madhe tonën dhe jo të koordinohemi me të qysh t'i ndryshojmë kufijtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit nënkryetar!

Sot po debatojmë për një çështje në mesin e çështjeve të një rëndësie të veçantë. Që në fillim kanë thënë edhe disa kolegë, po e them edhe unë se nuk e besoj që gjen asnjë shqiptar, asnjë qytetar, edhe të komuniteteve të tjera, përjashtimisht besoj të komunitetit serb fatkeqësisht, së paku të përfaqësuesve të tyre, që i është gëzuar mosanëtarësimit të Kosovës në Interpol. Kushdo që tenton ndryshe ta interpretojë këtë vërtet e interpreton një diçka që s'është e vërtetë. Së këndejmi që të gjithë ne, jo vetëm në Interpol, po në asnjë organizatë tjetër nëse Kosova nuk është që kjo na bënë neve të ndihemi mirë. Pavarësisht që jemi opozitë për interesa të vendit si LDK e kemi dëshmuar sa e sa herë, se pse jo, edhe kemi paguar çmim vetëm e vetëm që interesat e vendit të mbrohen.

Këtu u dëgjuan shumë, gjatë diskutimit që është, e marr edhe normale, nganjëherë edhe diçka që është ose shpeshherë jo bazuar edhe nga disa diskutues. Flitet për unitet për qeveritë e mëhershme, njohjet.

Më lejoni t'i them vetëm disa gjëra; e para punë, nuk duhet të tentohet të shfajësohet nëse ka dikush këtë mendim, duke e akuzuar Serbinë se nuk na la të anëtarësohemi. Po a ka më absurde që të pritet që Serbia të përkrah të anëtarësohesh edhe lobon për anëtarësim, po ata e bëjnë të kundërtën. Dhe këtu nuk ka nevojë që askush të jetë i mençur, sepse këtë e dimë.

Prandaj, mos e thoni këtë, sepse kjo na bënë të dukemi qesharak kushdo që e thotë. Serbia ka lobuar shumë ka dhënë para etj., etj., që të mos pranohej në Interpol. Po normale është kjo punë, çfarë kemi pritur ne diçka tjetër nga Serbia që nuk na njeh si shtet.

Dhe ku e kemi hapur edhe ne derën. Një derë të kësaj gjendjeje që e kemi, e kemi hapur edhe ne nga vet kontestimi në një mënyrë i shtetësisë sonë, kufijve tanë, sovranitetit tonë. Kjo është e vërtetë. Dhe tash na shohin jashtë kështu siç jemi brenda. Po na shohin, dhe pasqyra jonë brenda me këto sjellje. Me këto vendime. Me këtë qëndrime. Po reflekton edhe në qëndrimet e të tjerëve edhe në hezitim e besa edhe në mospërkrahje për synimet tona reale të drejta për të qenë pjesë e mekanizmave ndërkombëtare.

Por, edhe njëherë duhet të bëjmë përpjekje t'i ikim njëfarë patriotizmit të rrejtshëm, false, tash duke tentuar që ta gjejmë fajin diku tjetër dhe t'i ikim përgjegjësisë që e kemi ne.

Një gjë është shumë e qartë që, nuk është për mendimin tim vetëm Pacolli, zoti Pacolli përgjegjës, sepse Kosova nuk pranohet, gjegjësisht Ministria e Punëve të Jashtme as e Punëve të Brendshme nuk pranohen në Interpol, por pranohemi si shtet ose s'pranohemi si shtet. Jo vetëm në Interpol po edhe shumë në mekanizma tjera ndërkombëtare. Prandaj, këtu kemi përgjegjësi edhe individuale, por nëse mund të themi edhe kolektive ose institucionale, pra tri institucioneve kryesore; një Kuvendi jofunksional. Një Qeverie të tillë çfarë është që të gjithë e dimë me veprime skandaloze për të cilat sot s'po i përmend, sepse janë thanë sa e sa herë. Dhe po ashtu me sjelljet e presidentit të vendit karshi të korrigjimit të ashtuquajturit të kufijve të vendit. Të gjitha këto na bëjnë përgjegjës, gjegjësisht i bëjnë këta përgjegjës për gjendjen në të cilën jemi.

Prandaj, të dashur kolegë edhe njëherë duhet ta kemi një gjë të qartë. Nuk mund të shfajësohemi duke tentuar ta hedhim fajin diku tjetër dhe diku i ikur përgjegjësisë tona. Sikur sukseset që do duhej me qenë barometër edhe nesër pse jo, marrje e votave nga qytetarët për sukseset që i ke si institucion është edhe kundërta. Duhet të vijë edhe ndëshkimi edhe largimi i të gjithë atyre që nuk e bëjnë punën ose bëjnë gabime çfarë aktualisht janë duke u bërë më të madhe në Republikën e Kosovës.

Këtu të nderuar kolegë, ndoshta kjo ishte edhe një ndër arsytet edhe pse e mora fjalën, jo vetëm për të thënë mendimin tim për gjendjen aktuale rreth problemit që e kemi me mos anëtarësimin në Interpol, dhe në përgjithësi për politikën tonë të jashtme, dhe në përgjithësi kur flasim për politikë të jashtme, flasim për të gjitha ata që edhe kur e kanë edhe kur nuk e kanë vendin merren me këtë punë.

Dëgjoni edhe akuza absurde karshi Lidhjes Demokratike të Kosovës. Flasin për qeverinë e kaluar. Flasin për kinse dështimet, por mos u merrni me atë punë, sepse tash nuk është më ajo qeveri që për ne është qeveria më e mirë që e ka pasur vendi. Por, që tash kemi tjetër qeveri. Tjera procese të ashtuquajtura siç po thuhet vendime të mëdha. Hajde tash t'i diskutojmë këto dhe jo duke u marrë me çfarë ka ndodhur më herët dhe të tentojmë t'i mbulojmë këto të tashmet.

Po ju them edhe po flitet fushata. Në momentin që përfundon një proces zgjedhor, çdonjëri subjekt politik, po besa ai që është i mençur edhe kur është pushtet bënë fushatë pozitive të aktivitetit e të punës për zgjedhje të lira. Atë ditë fillon fushata. Është normale kjo. Por, jo të tentohet të na thuhet siç po na thuhet LDK-ja po bënë fushatë se i paska garat brenda në parti. Kjo është vërtetë kur absurditeti nuk ka skaj.

Pse LDK-ja tregon se është për unitet për vendime të mëdha, qëndrime të mëdha, e kemi thënë dhe kemi vepruar disa herë. Po ua përmend vetëm tri-katër çështje. Se LDK-ja është për unitet dhe i ka kontribuar kësaj edhe të mirës së vendit, është vet votimi i demarkacionit në këtë mandat. Ama bash asnjë votë nuk e kanë merituar këta që janë aktualisht në qeverisje që tua japë Lidhja Demokratike e Kosovës, por e kanë merituar qytetarët. Dhe për këtë edhe e kemi përkrahur. Dhe kjo e ka hapur derën edhe për përkrahjen tonë që e kemi dhënë vazhdimisht për liberalizim të vizave, por nuk po ndodhë sepse kemi probleme të natyrave të tjera.

Po ashtu, votimi i tri projektligjeve për FSK-në është dëshmi që është parë interesi i vendit dhe është bërë kjo dhe do të bëhet edhe në leximin tjetër. Po ashtu, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare votohen nga deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. A duhet dëshmi më e madhe për të treguar se ne i përkrahim ato që janë në interes të vendit.

Po ashtu, edhe të gjitha atë që nesër mund të vijnë siç është pakoja po zëmë e ligjeve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane ose më mirë të themi me sundimin e ligjit, por mos prisni nga ne në të vërtetë që të jemi unik ose të na kërkon unitet për gjërat e këqija që po i ndodhin vendit. Këtë harrojeni, sepse këtë përkrahje nuk mund ta keni nga ne dhe mos prisni që edhe kur kemi dështime të na thonë se nuk bën të flasim se tash Lista serbe po kërkon rrëzimin e Qeverisë.

Kolegë të nderuar,

Po kjo Listë serbe, janë të njëjtit, ndonjë deputet është ndërruar, është ajo e cila e ka bërë argatin me të tjerët që të rrëzohet qeveria Mustafa. Po kjo Listë serbe është ajo që e ka ndihmuar formimin e kësaj qeverie. Po kjo Listë serbe për mendimin tonë, pavarësisht siç thonë, e mbanë ende Qeverinë në jetë. Prandaj, të gjitha këto po bëkan e nuk bën nesër me ardhur puna që të realizohet një rezolutë që e ka kërkuar LDK-ja dhe partitë tjera opozitare kaheër. Që nuk ka të bëjë fare me Listën Serbe kjo, tash nuk po bëka se votat e tyre janë vota të një komuniteti që s'e do Kosovën. Këtë e dimë ne, po duhet ta dini edhe ju që aktualisht qeverisni.

Dhe fare në fund, duke i ditur të gjitha këto, duke i pasur të gjitha këto veprime për një gjë jemi të sigurt; edhe ata që janë në pushtet e shohin dhe dinë këtë, nuk presim ta thonë publikisht, kështu nuk shkohet. Kështu nuk ecët. Dhe ose sot ose pa ndonjë vonesë të madhe vendin e pret një proces zgjedhor i ri. Një legjitimin i ri i institucioneve të cilat do të dalin vetëm nga vota e lirë e qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Teuta Haxhiu replikë, dy minuta!

TEUTA HAXHIU: Vetëm desha ta pyes ish-shëfin, a e ka votuar Hashim Thaçin për president?

KRYESUESI: Se di a do të përgjigjeni Ismet?

ISMET BEQIRI: Unë po i them koleges Teutë që, unë e kam thënë edhe para një kohe, të gjithë ju që keni qitur zjarr prej gojës kundër asaj seance edhe këtu po e them; ejani të bëhemi bashkë, pra edhe ta rrëzojmë me votë Hashim Thaçin, Qeverinë, gjegjësisht presidentin me mocion, edhe pse dihet sesi presidenti mund të shkarkohet në Kuvend.

Ajo që mund t'ju them, nëse zoti Thaçi është president vendi, nuk është president vendi që ta shkelë sovranitetin e vendit. Dhe këtë votë nuk e ka as nga LDK-ja e besoj nga askush tjetër për ta dëmtuar vendin. Këtu duhet bërë dallimi.

Prandaj, të tjerat janë bash ashtu siç e thashë, me i rënë çiftelisë pak, të shkoni në shtëpi edhe ti Teutë edhe të tjerët të kënaqeni. Si e bëra një pyetje shumë interesante për diçka që Lidhja Demokratike...

KRESUESI: Faleminderit! Sipas radhës fjalën e ka, deputeti Duat Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Unë i fundit e kam kërkuar fjalën. Nuk e di pse më erdhi radha, po si do që të jetë mendova në listë isha i fundit.

Nuk desha të zgjatem më shumë vetëm për kolegët e mi deputetë që flisnin rreth shërbimit diplomatik të cilët janë zgjedhur para 15 muajve. Vetëm 5% e shërbimit diplomatik është përzgjedh nga qeverisja aktuale. Të gjithë të tjerët janë të ish-përzgjedhur dhe në mesin e tyre ka edhe kolegë tonë deputetë edhe që unë mendoj që shërbyes tepër të devotshëm.

Sa i përket taksës që u fol për kufirin, shpresoj që nuk është vetëm reaksion. Duhet ta themi një të vërtetë që ne e kemi marrë një taksë 10% para një muaji. Ndërsa, unë e posedoj një letër që i është dërguar zyrtarisht Brukselit më 25 maj. Në të cilën letër refuzohet çdolloj takimi i dialogut teknik pa u implementuar të gjitha marrëveshjet. Dhe që dëshironi po i citoj. Duke filluar nga energjia, diplomave, dokumenteve zyrtare.

Por, edhe një fakt është mirë kolegë e mi të cilët e kanë thirr këtë seanca ta mbajnë në mend. Kemi marrë edhe fusnotë në emër të asaj që Serbia nuk do ta pengojë Kosovën në anëtarësimin në organizata të ndryshme botërore. Dhe sot, nuk mund ta kryqëzojmë një njëri i cili qenka përgjegjës që Behgjet Pacolli e paska dëmtuar Kosovën e nuk e ka lënë ai të anëtarësohet në Interpol. Nuk qëndron.

Ne e dimë shumë mirë, Serbia është shtet i vjetër. Serbia e ka Rusinë. E ka Kinën. Ka aleatë të ndryshëm nëpër botë. Lajmi më i keqi në këtë vit është që nuk jemi anëtarësuar. Duhet të punojmë të gjithë bashkërisht që vitin e ardhshëm të paktën të bëhemi anëtar. Por, edhe një tjetër detaj që këtu nuk po përmendet. Shumë prej kolegëve të mi që janë këtu, pjesë e atij buxheti që u citu ma herët kanë qenë anëtarë nëpër delegacione të ndryshme me para të buxhetit.

Edhe duhet ta pranojnë, domethënë nuk i ka harxhuar Behgjet Pacolli, por pikërisht kolegët tanë deputetë e zyrtarë nga shoqëria civile nga mediat e të gjithë kanë marrë pjesë edhe janë paguar pikërisht nga ky buxhet. Dhe duhet ta bartin përgjegjësinë bashkërisht. Përgjegjësia kryesore u shkon institucioneve, ajo dihet. Por, e vërtetë edhe është fakt se ne kemi humbur para tri viteve. Jemi tërhequr njëherë dhe kemi pasur mbështetje shumë të fuqishme, që u tha nga dikush se disa shtete aleate nuk na kanë ndihmuar. Nuk është ashtu.

Por, fatkeqësisht nuk e kemi arritur. Duhet të punojmë shumë seriozisht që ta arrijmë qëllimin. Taksa 100%, pres prej Qeverisë që t'i kthehet reciprocitet në targa. Në dokumente. Në diploma. Në të gjitha. Klubin e hendbollit, vajzat e Kosovës nuk i kanë lejuar që të shkojnë të luajnë. Kadastrat e Kosovës nuk janë lejuar që të shkojnë që të marrin pjesë. Delegacionet e deputetëve na u kanë kthyer në kufi. Në të njëjtën masë duhet tua kthejmë. Sa për patriotizëm Lista Serbe...Lista Serbe, njërit këtu do t'i thosha një kolegut tim, edhe Isa u zgjedh me Listën Serbe këto i mbajmë në mend. Edhe d dimë sesi u rrëzua Qeveria. Kur t'i sjellësh këtu në rresht, rrezoje Qeverinë, hiç mos keni dert pa patriotizëm hiç. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti i fundit i paraqitur për fjalë është Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, nënkryetar Shala!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt unë bëj pjesë në mesin e deputetëve të cilët, nuk mendoj që edhe sikur ta kishim një super diplomaci tonën do të kishim suksese shumë. Pse e them këtë? Sepse zakonisht shtet e vogla edhe nëse shpenzojnë miliona e miliona euro, suksesi i tyre nuk varet nga ajo.

Edhe po t'i kishim njerëzit më të mirë të zgjedhur në diplomacinë kosovare, unë mendoj që nuk do të arrinim suksese të caktuara të cilat sot po i dëgjoj këtu. Po, shtet e vogla në fakt si maten. Ata maten se çfarë qeverisje kanë përbrenda tyre. Si e kanë të ndërtuar sistemin politik. Sa funksionin rendi dhe ligji. Dhe çfarë në fakt janë të gatshëm të ofrojnë si një shtet serioz. E që përkthehet kështu shumë thjesht, se shumë kolegë deputetë që e thanë që politika e jashtme është refleksion i politikës së brendshme.

Dhe në fakt, çfarë i kemi ofruar ne botës demokratike deri sot? Po flas tash për Qeverinë e fundit. Dhe tashti kur e bëj një analizë të thjeshtë e shoh. Kemi një Qeveri me gjashtë ministra me aktakuzë dhe kemi një situatë politike që vazhdimisht prodhon krizë pas krize. Mos të harrojmë

edhe tri vitet e fundit pamjet të cilat kanë qenë ose të cilat i kemi bartur ne për të tjerët. Dhunë institucionale. Sulm kryeministrit. Gaz lotsjellës në institucione. E të gjitha këto. Nuk harrohen shpejt këto. Dhe si i tillë, ky është mesazhi që ne e kemi bartur deri më sot.

Cilat janë elementet tjera të cilat kanë ndikuar që ne t'i bindim të tjerët që jemi shtet pothuajse vërtetë në situatë të rëndë? Më 22 dhjetor morëm nismë për zhbërjen e Gjykatës Speciale. Dhe kjo normalisht që për ndërkombëtarët është një test serioz për qëndrueshmërinë e institucioneve të cilat ne i dëshmojmë. Vazhduam më pas, ia vendosëm them thesin në kokë disa shtetasve turq në Kosovë, i kam pata, i vendosëm në aeroplan dhe i depërtuam nga Kosova. Dhe kjo në fakt tregon për nivelin e sigurisë individuale dhe kolektive që Kosova ka. Duke mos u mjaftuar me kaq, filluam me lojën për kufijtë. Filluam të kontestojmë gjithçka që kishim arritur ne. Filluam me përmend, madje presidenti i vendit duke thënë që Kosova rrezikon të bëhet si Palestina. Kosova rrezikon të ngelet një konflikt i ngrirë nëse vazhdon edhe më tutje që me Serbinë të mos ketë marrëveshje.

Dhe si mendoni? Si mund të jetë vlerësimi i të tjerëve? Një vend që rrezikon të bëhet si Palestina. Një vend që rrezikon të mbetet konflikt i ngrirë. Dhe çka t'i hapë dyert për anëtarësim ose t'i hapë dyert për respektim të këtij shteti. Ndërkohë, ne së fundmi çka po dëgjojmë sidomos prej partisë politike e cila është më e madhe në pushtet PDK-së.

Kryetari i Kuvendit thotë: “Nëse BE-ja nuk i aprovon ose nuk na i liberalizon vizat atëherë ky është racizëm”. Ndërkohë, zëvendëskryeministri Hoxhaj thotë: “Kjo është albanofobi”.

Në çfarë gjendje jemi ne si shtet t'ju tregojmë të tjerëve që ata kanë qasje raciste ndaj neve. T'ju tregojmë të tjerëve që qenkan albanofobë. Pse? Pse ne s'po dimë dhe s'po mundemi ta organizojmë vetën dhe t'i bindim të tjerët që ne vërtetë vlejme. Prandaj, unë e shoh në këtë kontekst, ne përbrenda e kemi demoluar e kemi degraduar deri në skajshmëri funksionalitetin e shtetit tonë.

Dhe tashti po e shoh sikur jemi befasuar pse nuk jemi pranuar në Interpol. Dhe pse na ka ardhur kjo befasi unë mendoj? Tash unë po befasohem nga një arsye, ju paskëshit filluar t'i besoni Hashim Thaçit që Serbia nuk është vend problematik. Që Vuçiqi nuk është djalë problematik. Ju paskëshit filluar t'i besoni Behgjet Pacollit kur para disa ditëve tha: “Shqiptarët dhe serbët nuk kanë probleme me njëri-tjetrin”.

Dhe tashti në një moment ndodhi, çka tha ministri i Jashtëm, tha: “Qasja e Serbisë është agresive dhe e pamëshirshme”. Shihe ti! Shihe ti, e pamëshirshme Serbia?! Që një shekull. Mos të them që një shekull. Me shekuj e me shekuj. Çfarë konstatime banale janë këto.

Qasje agresive dhe të pamëshirshme ndaj neve. Ka mëshirës Serbia ndaj neve. Domethënë po presim mëshirë nga ata të cilët ditë e natë punojnë për zhbërjen e Kosovës. Dhe tashti unë po e shoh edhe një diskurs tjetër. Po provojmë me simplifiku këtë angazhimin e shtetit tonë që nëse anëtarësohet në organizma ndërkombëtar konsolidohet shtetësia e Kosovës. Po, jo kjo nuk është kështu.

Unë po ju them që në vitin 1990 Zvicra është bërë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara të OKB-së, po Zvicra feston 700-vjetorin e saj. Zvicra dhe Islanda nuk janë pjesë e BE-së, madje as që mëtojnë të jenë pjesë e BE-së, po janë vende të konsoliduara. Shtete të respektuara. Prandaj, Kosova nuk e ka problem vetëm anëtarësimin. Anëtarësimi vjen si problem për shkak të kontestimit nga Serbia. Unë e shoh problem serioz degradimin total që ne i kemi bërë shtetit tonë nga brenda.

Ne po themi, po sikur të kishim një diplomaci edhe më funksionale do të bindnim shumë shtete që do të ndikonin që ne të bëhemi pjesë e Interpolit. More kjo diplomaci e Kosovës edhe kjo Qeveri e Kosovës nuk ka arritur që ta bind Shqipërinë sesi të hiqet kufiri për pata dhe miell, e lerë më po e bindim një shtet të madh serioz sesi të na ndihmojë neve që të anëtarësohemi.

Krejt çka ne mund të bëjmë është ta konsolidojmë shtetin e Kosovës dhe më pas të tjerët të na ndihmojnë që ne të anëtarësohemi aty. Sjelljet tona, sidomos këto vitet e fundit i kanë vënë në situatë të rëndë edhe vet shtetet mike të Kosovës sesi të na ndihmojnë neve. Mënyra, aventurat tona me kufijtë të Kosovës. Qasja jonë në dialogun me Serbinë dhe sidomos degradimin e brendshëm institucional që ia kemi bërë Kosovës, ia kemi hequr edhe një instrument të rëndësishëm që bashkësia ndërkombëtare e ka pasur në dorë që të llojë për Kosovën, dhe anëtarësimin tonë në organizma të rëndësishme ndërkombëtare.

Dhe krejt kjo si po vjen, unë mendoj që përbrenda Qeverisë së Kosovës e me theks të veçantë në diplomaci sikur ka një deficit intelektual. Unë po e shoh nuk ka dije. Kjo Qeveri nuk ka dije të mjaftueshme për t'ia dresuar problemet e mëdha.

Nëse ne po flasim për një Ministri të Punëve të Jashtme, po e marrim edhe këtë si institucion, dy zëvendësministra të kësaj ministrie na tregonin disa herë në media që nuk flasin fare me ministrin e Jashtëm. Ata thoshin që nuk po na pret as në takim. Për të të ardhur edhe të më skandalozja, dy zëvendësministrat na patën thënë kështu, kur filloi tërheqja e disa shteteve të vogla nga njohja ndaj Kosovës thanë: “E kanë tërhequr njohjen disa shtete të parëndësishme s’ka problem për neve”.

Merre me mend deri ku shkon diskursi i diplomatëve ose njerëzve të cilët mëtojnë të bartin diplomacinë e Kosovës. Prandaj në këtë kontekst, normalisht që prodhimi final ose produkti final është ndalja e njohjeve, izolimi i Kosovës dhe më pas mungesa e investimeve të jashtme të cilat

janë elementi themelor që ne ta zhvillojmë ekonominë e vendit. Nëse këto nuk i kemi, çka po i sjellim Kosovës? Po u sjellim të rinjve dhe të rejave tona, zgjidhjen tjetër më të rëndë me ikë nga Kosova.

Unë po e shoh të nderuar kolegë deputetë, po e injorojmë një fakt, në Prishtinë nuk po vërehet shumë. Dilni nga Prishtina dhe e shihni, të rinjtë dhe të rejat e Kosovës po ikin masivisht. Fshatra të tëra kanë ngelur pa të rinj. Nuk sheh më njerëz të rinj as të punës, as edhe për punë krejtësisht fizike lerë më për punë të organizuar. Dhe ky është mesazhi që në e kemi bartur, sot si Qeveri po flas, sepse si qeverisje s'po arrimë ta kthejmë besimin e tyre. Prandaj, pa një konsolidim të brendshëm të shtetit të Kosovës, ne nuk mund të kemi respekt as për vetën tonë dhe aq më pak të kërkojmë respekt dhe dinjitet nga të tjerët.

Dhe nëse ne nuk e marrim seriozisht këtë mesazh tonin, e që bie kjo qeverisje e tillë e ka lënë vend pa respekt dhe pa dinjitet dhe e vetmja zgjidhje mbetën zgjedhjet, unë mendoj që vazhdimi i mëtutjeshëm është degradim i mëtutjeshëm. Shkatërrim i mëtutjeshëm dhe mbytje, definitivisht e shpresës së njerëzve që jetojnë Kosovë, për të jetuar në këtë vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selmanaj ishte deputeti i fundit i paraqitur për diskutim. Kështu që ne e kemi përmbyllur këtë pjesë të seancës. Tani unë pyes propozuesin nëse dëshiron të marrë fjalën përfundimtare. Meqë janë dy grupe parlamentare në dispozicion janë pesë minuta. Mund të marrë njëri pesë minuta ose t'i ndajnë përgjysmë. Vjosa Osmani, urdhëro!

VJOSA OSMANI: Besoj që debati i sotëm dhe kontributet e deputetëve nga të gjitha partitë i dëshmuar shumicën e çështjeve që i ngritëm qysh në fillim të këtij debati. Prandaj, kërkojmë nga grupet parlamentare që ta votojnë rezolutën të cilën e lexova në fillim të kësaj seance. Në qoftë se ka nevojë ta lexoj prapë zoti kryesues, mund ta lexoj, mirëpo materiali është shpërndarë i protokolluar të gjithë deputetëve të Kuvendit.

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Duhet të konstatoj kuorumin. Administrata ju lutem! Në sallë janë 60 deputetë, domethënë edhe një deputet që të mund të procedojmë. 61 janë sallë. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tani.

Në sallë janë 61 deputetë, por në votim kanë marrë pjesë vetëm 35. A dëshironi ta përsërisim edhe njëherë? 36 dhe një me dorë. Atëherë e përsëritim... Diskutimet i kemi mbyllur. Atëherë e përsërisim edhe njëherë. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tani.

Atëherë, në votimin elektronik kanë marrë pjesë 36 deputetë dhe 1 me dorë, 37. 36 janë për, 1 abstenim. Ky votim nuk është i vlefshëm. Kështu që në këto kushte unë jam i detyruar që ta ndërpres seancën.

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë